

**SHPREHJET FRAZEOLLOGJIKE
ME VLERË MBIEMËRORE NË GJUHËN SHQIPE DHE
PËRVETËSIMI I TYRE NGA NXËNËSIT**

Doktorante: MARGARITA DEDEJ

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat Sociale, me profil Pedagogji, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqësi shkencor: Prof. Dr. NONDA VARFI

Numri i fjalëve: 61.721

Tiranë, shtator 2015

**SHPREHJET FRAZEOLOGJIKE
ME VLERË MBIEMËRORE NË GJUHËN SHQIPE DHE
PËRVETËSIMI I TYRE NGA NXËNËSIT**

Doktorante: MARGARITA DEDEJ

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat Sociale, me profil Pedagogji, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqësi shkencor: Prof. Dr. NONDA VARFI

Numri i fjalëve: 61.721

Tiranë, shtator 2015

Disertacioni prezantohet para kësaj jurie të përbërë nga:

KRYETARI I JURISË

(Prof. Dr. EDI PUKA)

ANËTAR

(Prof. Dr. KOLEC TOPALLI)

ANËTARE

(Prof. Dr. DIANA KASTRATI)

ANËTAR

(Prof. Dr. YLLJET ALIÇKA)

ANËTAR

(Prof. Dr. ALEKSANDËR DHIMA)

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Autorja

Margarita Dedej

ABSTRAKTI

Mësimdhënia është një proces komunikimi dhe rëndësia e tij qëndron në mesazhet që përcjellim përmes këtij procesi tepër të domosdoshëm nëpërmjet pasurisë leksikore, larmisë frazeologjike, duke vënë në pah elemente kulturore dhe gjuhësore. Si pjesë e rëndësishme e leksikut, njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore ndihmojnë mësimdhënësin në shkëmbimin e mesazheve, në krijimin e leksikut individual, në përvetësimin e imazheve, të vlerave, të modeleve etj.

Ky studim mbështetet në metoda analitiko-semanticë induktive të plotësuara pjesërisht edhe me metodën përqasëse. Këto metoda lidhen me natyrën e përzgjedhjes së temës dhe siç dihet metoda që prevalon është metoda e analizës së fakteve konkrete gjuhësore për të arritur përgjithësime. Përgjatë temës metoda induktive-deduktive gërsheton natyrshëm faktin që kjo temë mbi studimin e frazeologjisë me vlerë mbiemërore, ashtu si frazeologjia në përgjithësi ngërthen një koncept të rrallë ndër gjuhëtarë të huaj apo shqiptarë.

Nga ana teorike ndërmorëm këtë studim për t'i trajtuar njësitë frazeologjike mbiemërore si një grup i larmishëm brenda njësisë gjuhësore nga ana formale dhe ajo semanticë, si elemente që luajnë rol të rëndësishëm në përdorimin e tyre në ligjërim ashtu edhe në përdorimin në tekstet shkollore (Gjuhë shqipe dhe Letërsi), nga nxënësit e klasave 6^{-të} - 12^{-të}.

Studimi arriti në përfundimin se njësitë frazeologjike janë pasqyruar në tekstet mësimore në nivel të ulët, duke pasur parasysh se ato janë një element i rëndësishëm në pasurimin e gjuhës dhe provoi se njësitë frazeologjike duke qenë se janë objekt i

frazeologjisë, si fushë studimi brenda shkencës së leksikologjisë, dhe pjesë e social pedagogjisë ato duhet të mësohen edhe në shkollën e mesme.

Fjalët kyçe: *frazeologji, leksikologji, mësimdhënie, njësi frazeologjike, njësiive frazeologjike me vlerë mbiemërore.*

ABSTRACT

Teaching is a process of communication and its importance lies in the messages to convey through this process very necessary through lexical wealth, diversity idioms, highlighting cultural and linguistic elements. As an important part of vocabulary, idioms units worth adjectives the teacher help in the exchange of messages, the creation of individual vocabulary, the acquisition of images, values, models etc.

This study is based on inductive semantic analytical methods that meets comparative partly method. These methods are related to the nature of the selection of the theme and it is known that the method that prevails is the method of linguistic analysis of concrete facts to reach generalizations. Along theme inductive-deductive method combines naturally the fact that this topic on the study of phraseology worth adjectives, like phraseology generally involves a concept rarely among foreign or Albanian linguists.

Theoretically we undertook this study to address the adjectival phraseological units as a diversified group within the unit language by formal and semantic elements that play an important role in their use in teaching and in use in textbooks (Albanian Language and Literature) by students in grades 6- to - 12th.

The study concluded that local idioms are reflected in textbooks at a low level, given that they are an important element in enriching the language and idioms units proved as subject phraseology, as a field of study within science of lexicology, and part of the social pedagogy they should be taught in middle school.

Keywords: *phraseology, lexicology, teaching, idioms units, units worth adjectival idioms.*

DEDIKIMI

Skënderit,

Eduartit

dhe

Gjergjit

FALENDERIME

- Së pari dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për udhëheqësin tim shkencor, **Prof.Dr. Nonda Varfi** për sugjerimin e kësaj teme interesante në fushën e frazeologjisë gjuhësore si edhe për ndihmën dhe përkujdesjen shkencore si dhe për durimin që ka treguar deri në përfundimin e këtij punimi shkencor dhe pedagogjik.
- Dëshiroj përzemërsisht, të shpreh falënderimin tim për stafin e **Shkollës Doktorale** në Universitetin European të Tiranës që me përkushtim dhe profesionalizëm më kanë ndihmuar në Studimet e Doktoraturës në Fushën e Pedagogjisë.
- Falënderoj, në mënyrë të veçantë familjarët e mi që nuk ngurruan të më jepnin mbështetjen, inkurajimin dhe dashamirësinë e tyre deri në realizimin e plotë të këtij projekti.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

I.	Njësitë frazeologjike dhe mësimdhënia	13
II.	Shtrimi i problemit	13
III.	Qëllimi dhe objektivat e temës e kërkimore	14
IV.	Hipoteza e punimit dhe pyetjet kërkimore.....	15
V.	Literatura bazë dhe metodologjia.....	16
VI.	Mundësitë dhe kufizimet	17
VII.	Ndërtimi i këtij punimi	18

KAPITULLI I. FRAZELOGJIA DHE NJËSITË FRAZELOGJIKE

1.1	HYRJE (koncepte të përgjithshme)	23
1.2	Frazeologjia në gjuhësinë shqiptare	26
1.3	Mbi përkufizimin e njësisë frazeologjike	28
1.4.	Rreth kufijve të frazeologjisë leksikore	33
1.4.1.	Proverbat dhe njësia frazeologjike	38
1.4.2.	Veçori të përgjithshme të njësive frazeologjike me vlerë leksikore	42
1.4.3.	Lidhjet mes figurshmërisë dhe idiomatikës	49
1.5.	Mbi klasifikimin e njësive frazeologjike	51

KAPITULLI II. NJËSITË FRAZELOGJIKE ME VLERË MBIEMËRORE

2. 1. Hyrje	57
2. 2. Idiomatika si tipar themelor i formësimit dhe figurshmëria (tropet)	58
2.2.1. Metafora dhe Krahasimi	60
2.2.2. Krahasimi	63
2.2.3. Metonimia	69
2.2.4. Hiperbola	71
2.2.5. Personifikimi	72
2.2.6. Eufemizmi	74
2. 3. Tipare të njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore	75
2.4. Njësia frazeologjike mbiemërore dhe togjet e lira	83
2.5. Njësitë frazeologjike dhe shumëkuptimësia e tyre	92
2.6. Njësitë frazeologjike mbiemërore dhe klasifikimi i tyre	93

KAPITULLI III. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1 Hyrje	104
3.2. Hipoteza e kërkimit.....	104
3.3. Planifikimi i kërkimit	105
3.4. Metodatat e studimit.....	107
3.5. Prezantimi i leksikologjisë dhe njësive frazeologjike në tekstet mësimore	107
3.6. Vëzhgime dhe anketime në shkollë	120
3.6.1. Modeli i pyetësorit dhe gjetjet.....	123

3.6.2. Përpunimi i të dhënave dhe pritshmëritë	130
3.6.3. Disa modele ushtrimesh rreth frazeologjizmave	131
3.7.1 Mallkime dhe urime me përdorim dialektor	137
3.7.2. Mallkime	137
3.7.3. Urime	138

KAPITULLI IV. ANALIZA DHE STRUKTURA E NJËSIVE FRAZELOGJIKE ME VLERË MBIEMËRORE NË GJUHËN SHQIPE

4.1. Tipologji strukturore	142
4.2. Disa veçori të formës në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore	147
4.2.1 Njësitë frazeologjike që formohen nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi	150
4.2.2. Ndërtime të njësive frazeologjike me elemente krahasuese	152
4.3. Ndërfutja e elementeve në njësinë frazeologjike mbiemërore	154
4.4. Kombinime të varianteve në njësitë frazeologjike mbiemërore	159
4.5 Variacione të mbiemrit	160
4.6 Variacione të emrit	161
4.7 Variacione të foljes	164
4.8 Variacione me fjalë joemërtuese	165
4.9 Variacione të kombinuara	167
4.10 Variacione sintaksore	168
4.11 Variacione të përdorura në dialekte	169

KAPITULLI V. FUSHA LEKSIKO – SEMANTIKE DHE PASQYRIME TË ETNO - KULTURËS NË NJËSITË FRAZELOGJIKE MBIEMËRORE

5. 1. Fusha leksikore dhe semantike në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore.....	171
5.2 Lidhja etnokuturore me njësitë frazeologjike	174
5.3. Etnologji e përdorimit të frazeologjisë në varësi të grupeve shoqërore	176
5.3.1 Etnologji e përdorimit të njësive frazeologjike nga burrat	181
5.4. Disa njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore nga zona e Rrogozhinës	184
5.5. Njësi frazeologjike nga bota bimore	185
5.6. Njësi frazeologjike nga bota shtazore	187
5.7. Njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore nga fusha të ndryshme	189
5.8. Përdorimi i njësive frazeologjike në disa fusha si modele në ngjyrat	192
5.9. Rezultatet dhe diskutimi	203
PËRFUNDIME	205
Rekomandime	210
FJALORË / BURIMEPARËSORE.....	211
BURIME DYTËSORE	219
APENDIX	220
Fjalorth i shprehjeve frazeologjike me vlerë mbiemërore të përdorura në punim	220
Fjalorth i njësive frazeologjike në gjuhën angleze	255
Fjalorth i njësive frazeologjike në gjuhën franceze	257

HYRJE

I. Njësitë frazeologjike dhe mësimdhënia

Gjuha është gjithnjë në lëvizje dhe në ndryshim, por krahas elementeve të rinj (neologjizmave), me interes shihen në ligjërimin tonë edhe shprehjet frazeologjike të cilat trashëgohen ndër breza. Ato vijnë të gatshme dhe pasurojnë komunikimin tonë të përditshëm (verbal). Në bisedat, diskutimet apo pikëpamjet dhe komentet tona për një veprim apo një ngjarje, ndjesitë i përcjellim me një fjalor të thjeshtë, të qartë e të kuptueshëm, në raste po kaq të zakonshme dhe kaq të natyrshme gjejnë përdorim edhe njësitë frazeologjike. Megjithëse mund të duket një fenomen pak i rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor proçesi i mësimdhënies është një mënyrë komunikimi shumë efikase për të realizuar përcimin e gjuhës amtare dhe njërive frazeologjike si pjesë e gjuhës, duke patur si pikëlidhje kryesore zhvillimet moshore të nxënësve.

II. Shtrimi i problemit

Gjithnjë e më tepër, në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë janë pëmirësuar arritjet në përvetësimin e gjuhës standarde, por ka edhe probleme të cilat lidhen sidomos me përbërësit e punës për zhvillimin e të folurit, me leksikun (fjalën dhe frazeologjinë). Në tekstet shkollore të klasave 6^{-të} deri në klasën e 9^{-të} përcillen njohuri të përgjithshme rreth njërive frazeologjike, ndërsa në tekstet e shkollës së mesme (klasat 10- të deri në klasën e 12^{-të}) tekstet shkollore nuk pasqyrojnë asnjë lloj informacioni për to. Problemi kështu shtrihet nga teksti, te mësuesi dhe te nxënësi, mirëpo aftësia për të kuptuar njësitë

frazeologjike lëviz paralelisht nga një aftësi e kufizuar gjuhësore e të shprehurit në të cilën shkon gjuha konkrete, e karakterizuar nga realizimi formal, në një aftësi të plotë gjuhësore, në të cilën përdorimi gjuhësor mbështetet në aftësi të tjera përtej atyre gjuhësore.

III. Qëllimi dhe objektivat e temës e kërkimore

Qëllimi kryesor i punimit është eksplorimi i pasqyrimit të njësive frazeologjike në tekstet shkollore të Gjuhës shqipe nga klasat e 6^{të} - 12^{të} dhe përvetësimi i tyre nga nxënësit. Për të kuptuar njësinë frazeologjike pasqyrojmë dallimet e saj me fjalën dhe proverbat, duke vlerësuar rolin e tyre në pasurimin e leksikut. Në studim do të sqarojmë se nga togfjalëshat frazeologjikë (e figurshëm) e kanë pikënisjen njësitë frazeologjike, të cilat klasifikohen në emërore, foljore, mbiemërore dhe ndajfoljore. Sipas strukturës së ndërtimit të njësive frazeologjike të shqipes dallojmë disa organizime të njësive frazeologjike në të cilën shumica e njësive, kanë strukturë togfjalëshi, por disa prej tyre janë me strukturë fjalie. Me qëllim që të vërehet pasqyrimi i njësive frazeologjike në disa fusha leksiko-semantike dhe pasqyrime të elementeve të etnokulturorë në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore, do të sjellim në vëmendje edhe shembuj që pasqyrojnë shfrytëzimin me mjeshtëri të pasurisë leksiko – semantike përmes fjalëve të reja ose të vjetra, sinonimeve, antonimeve, krahinorizmave etj. Duke pasqyruar edhe disa modele ushtrimesh rreth frazeologjizmave dëshirojmë të nxjerrim në pah aspekte të rëndësishme të njësive frazeologjike sidomos në orët mësimore në ciklin 9-vjeçar. Jemi përpjekur që të sjellim përmes anketimeve dhe vëzhgimeve edhe nivelin e përdorimit të njësive frazeologjike nga

nxënësit e shkollës së mesme, në tekstet mësimore të të cilëve mungojnë rimarrjet e njohurive rreth frazeologjizmave. Rëndësia e disa njësive frazeologjike qëndron në faktin se ato janë të përdorura si formula të urimeve dhe mallkimeve të mbledhura, po kështu disa gjetje janë sjellë edhe nga përdorime të zhargonit studentor i cili është mjaft i pasur me njësi frazeologjike. Në këtë studim që synon të radhitet si punim shkencor është propozuar një model përshkrues teorik ndërgjuhësor brenda fushës së frazeologjisë, si një disiplinë e përfshirë brenda lëmit të pedagogjisë dhe gjuhësisë. Ky studim është një pjesë e rëndësishme e punës hulumtuese, me qëllime studimore aplikative në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj.

IV. Hipoteza e punimit dhe pyetjet kërkimore

Hipoteza që shtrojmë lidhet me përvetësimin e leksikut dhe vlerën e frazeologjisë në tërësi si domosdoshmëri në mësimin e gjuhës shqipe dhe në pasqyrimin e tyre tekstet mësimore; Nga vëzhgimet e bëra njësitë frazeologjike pasqyrohen në nivel të ulët në tekstet e Gjuhës shqipe në klasat 6^{të} - 12^{të} dhe po kështu zbatohen në nivel të ulët në mësimdhënie në klasat 6^{të} - 12^{të}. Mirëpo me punimn tonë do t'i japim përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- Sa dhe si pasqyrohen njësitë frazeologjike në tekstet e Gjuhës shqipe 6^{të} - 12^{të}?
- Sa dhe si përvetësohen ato nga nxënësit në klasat 6^{të} - 12^{të}?
- A është e domosdoshme të rimerren njohuritë teorike rreth njësive frazeologjike? Pse?

Edhe vetë leksiku i përkufizuar si tërësia e fjalëve të një gjuhe, do të ishte i cunguar nëse nuk përfshihen këtu edhe njësitë frazeologjike si barasvlerëse të fjalës, si nga ana kuptimore edhe nga ana sintaksore me dallimet dhe veçoritë përkatëse. Natyra e njësive

frazeologjike na lejon të pranojmë shumëllojshmërinë e teorive që janë ofruar dhe shpjegojnë aspekte të ndryshme të frazeologjisë gjuhësore. Natyrisht edhe hipoteza e punës sonë lidhet me këtë natyrë të veçantë të shprehjeve frazeologjike me vlerë mbiemërore të shqipes. Përjasja dhe studimi i njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore është e rëndësishme për të zbuluar aspekte të perceptimit për lidhjet mes gjuhës dhe të të menduarit. Për këtë studim janë marrë në shqyrtim edhe anketime nga nxënës të shkollës së mesme. Po kështu kemi pasqyruar një larmi shembujsh të mbledhura nga vepra letrare në anglishte dhe në shqipe dhe shumëllojshmëri shembujsh nga fjalorë të ndryshëm frazeologjikë një ose dygjuhësh.

V. Literatura bazë dhe metodologjia

Ky studim mbështetet në metoda analitiko-semantike induktive të plotësuar pjesërisht edhe me metodën përjasëse. Këto metoda lidhen me natyrën e përzgjedhjes së temës dhe siç dihet metoda që prevalon është metoda e analizës së faktit (konkret gjuhësor) për të arritur përgjithësime. Përgjatë temës metoda induktive-deduktive gërsheton natyrshëm faktin që kjo temë mbi studimin e frazeologjisë me vlerë mbiemërore ashtu si frazeologjia në përgjithësi ngërthen një koncept të rrallë ndër gjuhëtarë të huaj apo shqiptarë.

Përjasja nuk përbën shtyllën kryesore të këtij studimi, sepse lënda kryesore është ajo gjuhësore, por aty këtu jemi munduar të sjellim edhe shembuj në gjuhë të huaj (kryesisht angleze). Gjithashtu duke e parë në planin e mësimdhënies dhe të metodikës së mësimdhënies kemi përdorur edhe anketime, vëzhgime, studime të dokumentacionit etj. Studimi mbështetet në analizën përjasëse ndërgjuhësore dhe në përvoja praktike anketimi

në nxënës, për të nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe të veçantat e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore në gjuhën të huaj dhe shqipe. Këto njësi frazeologjike janë objekt i frazeologjisë, si fushë studimi brenda shkencës së leksikologjisë, dhe pjesë e social pedagogjisë. Me studimin e frazeologjisë vihen re marrëdhëniet ndërdisiplinore në trajtimin e saj, ku ndërthuren çështje që u përkasin fonetikës, sintaksës, morfologjisë, sociolinguistikës, stilistikës, pedagogjisë, letërsisë dhe historisë së gjuhës. Njësitë frazeologjike paraqesin një natyrë të parregullt që reflektohet në transformimet semantike dhe formale që kanë pësuar ato me kalimin e kohës. Ky fakt e bën frazeologjinë një fushë studimi të bukur dhe mjaft të vështirë, të larmishme dhe tërheqëse. Për trajtimin e çështjeve teorike jemi mbështetur në një literaturë të gjerë, duke përfshirë autorë shqiptarë dhe të huaj. Përjasja dhe konceptet bazë teorike janë trajtuar përmes dy teorive: teorisë tradicionale dhe teorisë konjitive. Në këtë punim nuk do të merremi me secilën në veçanti por me lidhjen dhe ndarjen e tyre. Këtë studim do ta nisim me studimet më të hershme në fushën e frazeologjisë me studiues si; A. Xhuvani, I. D. Sheperi, J. Rrota, K. Cipo, M. Domi, S. Prifti, M. Çeliku, J. Thomaj etj. me autorë të huaj si; Charles Bally, Catherine Bolly, Christina Cacciari dhe Patrizia Tabossi, etj. në të cilën vëmendje e veçantë i kushtohet çështjeve të frazeologjisë gjuhësore, strukturës edhe gjatë procesit të mësimdhënies të gjuhës.

VI. Mundësitë dhe kufizimet

Mundësitë për të bërë një studim të tillë janë të mëdha edhe për shkak të studimeve paraardhëse dhe ka rëndësi në lëmin e leksikologjisë dhe mësimdhënies.

Për arsye të temës studimore subjekte të këtij punimi janë nxënësit e klasave 6 - 12 -të që ndoqën studimet në vitin shkollor 2013-2014 në shkollat 9-vjeçare "Xhorsh Sorros", "Qamil Gjuzi", Gjimnazi "Haxhi Qehaj në Rrogozhinë dhe Shkolla e Mesme e Bashkuar (9-vjeçare dhe gjimnaz) në Gosë .

Kufizimet e këtij studimi janë kampionimi jo rastësor (i volitshëm) dhe rezultatet nuk përgjithësohen për të gjithë shkollat, por vetëm për shkollat e zgjedhura për studim.

VII. Ndërtimi i këtij punimi

Ky studim shkencor është organizuar në pesë krerë dhe secili prej tyre përmban nënndarjet përkatëse dhe përfundimet e përgjithshme në lidhje me çështjet kryesore të trajtuara në punim.

Në **kapitullin e parë** që është një kapitull hyrës jemi përpjekur të trajtojmë konceptin e frazeologjisë në pikëpamjet e disa gjuhëtarëve të ndryshëm, si dhe objektin në këndvështrime të ndryshme historike. Kemi pasqyruar pikëpamjet e ndryshme rreth konceptimit të disa gjuhëtarëve për frazeologjinë në konceptin e ngushtë dhe të gjerë të saj, emërtimet dhe termat përkatës. Kjo pjesë hyrëse bën një paraqitje të studimeve të bëra rreth frazeologjisë për gjuhë të ndryshme edhe lidhjeve të frazeologjisë me fusha të tjera ku gjejnë përdorim njësitë frazeologjike ose anasjelltas. Jemi përqendruar në studime të larmishme për gjuhësinë shqiptare që nga studimet më të largëta në kohë e deri tek këto të viteve të fundit. Duke sjellë gjithnjë në vëmendje njësinë frazeologjike përpiqemi të sjellim edhe dallimet mes frazeologjisë gjuhësore dhe frazeologjisë leksikore. Trajtesa terminologjike të përdorura nga gjuhëtarë të ndryshëm përfshirë këtu edhe frazemën dhe

qëndrimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për të. Kemi marrë në konsideratë edhe qëndrime rreth teorisë konjitiviste dhe asaj tradicionale dhe pikëpamje të ndryshme për fjalët e urta, citatet, njësitë frazeologjike etj. Gjithashtu do të trajtojmë dallimet mes njërive frazeologjike dhe proverbave dhe rolin e tyre për të pasuruar leksikun. Jemi përpjekur të ndalemi në klasifikimin e njërive frazeologjike për ta ngushtuar temën te thelbi i punimit tonë në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore.

Në **kapitullin e dytë** dëshirojmë të trajtojmë gjerësisht objektin e temës, njësitë frazeologjike mbiemërore që kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe pasqyrohen gjerësisht në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh. Si të gjitha shprehjet frazeologjike, mjaft prej tyre e kanë pikënisjen nga togfjalëshi i lirë, por në dallim nga togfjalëshat e lirë, ku kuptimi është i drejtpërdrejtë, në togfjalëshat frazeologjikë kuptimi është i figurshëm. Në themel të këtij kalimi, pra nga togfjalësh i lirë në frazeologjik, qëndrojnë disa trope si metafora, krahasimi, hiperbola, eufemizmi, personifikimi, etj. Njësitë frazeologjike shqyrtohen edhe nga funksionimi i tyre si një njësi e vetme sintaksore, tipar ky që i bashkon me fjalën. Dëshirojmë të studiojmë tipare të njësisë frazeologjike me vlerë mbiemërore, dallimet dhe ngjashmëritë me fjalët. Do të trajtojmë njësinë frazeologjike mbiemërore dhe togjet e lira, ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre, ashtu si togjet e lira të fjalëve kanë lidhje të njëjta ose përbëhen nga dy a më shumë fjalë shënjuese. Shkurtimisht dëshirojmë të trajtojmë njësitë frazeologjike mbiemërore dhe klasifikimin e tyre sipas motivimit. Njësitë frazeologjike mbiemërore sipas motivimit grupohen në njësi frazeologjike të motivueshme dhe të pa motivueshme. Në rastet kur njësia frazeologjike

(togfjalëshi frazeologjik) krahas përdorimit të saj të figurshëm ka (ekziston) edhe togfjalëshin e lirë (kuptimin e parmë) atëherë themi se kemi të bëjmë me njësi frazeologjike të motivueshme. Do të marrim në konsideratë edhe klasifikimin sipas vlerës leksikore dhe formave të lidhjes së gjymtyrëve të njësive frazeologjike. Njësitë frazeologjike i grupojmë edhe sipas strukturës së ndërtimit të tyre, nëse ato funksionojnë si folje janë foljore, nëse përdorimi i tyre luan funksionin e emrit janë emërore dhe nëse ato funksionojnë si ndajfolje janë ndajfoljore, nëse janë njësi me kuptime mbiemërore janë mbiemërore. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë të ndërtuara sipas disa formave të lidhjes së gjymtyrëve. Jemi përpjekur që herë pas here të sjellim ndonjë shembuj për secilat raste edhe nga gjuha shqipe edhe nga gjuha angleze.

Metodologjinë dëshirojmë ta pasqyrojmë në **kapitullin e tretë** në të cilin do të reflektojmë pasqyrimin e frazeologjisë në tekstet mësimore të ciklit parauniversitar. Do të përpiqemi të paraqesim përmes fakteve se sa njohuri marrin nxënësit rreth njësive frazeologjike dhe fushave leksikore të veçanta. Duke pasqyruar edhe disa modele ushtrimesh rreth frazeologjizmave dëshirojmë të nxjerrim në pah aspekte të rëndësishme të njësive frazeologjike në orët mësimore në klasat 6 - 12^{-të}. Jemi përpjekur që të sjellim përmes anketimeve dhe vëzhgimeve edhe nivelin e përdorimit të njësive frazeologjike nga nxënësit e shkollës së mesme, në tekstet mësimore të të cilëve mungojnë rimarrjet e njohurive rreth frazeologjizmave.

Një vend të rëndësishëm në këtë punim do të kenë edhe disa njësi frazeologjike të përdorura si formula të urimeve dhe mallkimeve të mbledhura në zonat përreth qytetit. Po

kështu disa gjetje janë sjellë edhe nga përdorime të zhargonit studentor i cili është mjaft i pasur me njësi frazeologjike. Përgjatë anketave jemi përpjekur të zgjedhim shprehje të ndryshme, që secila grup moshë përdor në komunikim me moshatarët e vet.

Në **kapitullin e katërt** do të analizojmë njësinë frazeologjike, duke respektuar strukturën e ndërtimit të njësive frazeologjike të shqipes dallojmë disa organizime të njësive frazeologjike. Shumica e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë strukturë togfjalëshi, por disa prej tyre janë me strukturë fjalie. Gjithashtu njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore vijnë edhe prej tipit foljor dhe në vend të gjymtyrës foljore kanë një mbiemër prejpjesor, ose përbëhen nga dy gjymtyrë të shprehur me emra. Edhe këtu jemi përpjekur të argumentojmë me shembuj. Në përdorimin e tyre më të zakonshëm njësitë frazeologjike mbiemërore janë të organizuara me parafjalët; pa, me, si. Shembujt e ilustruar nga tekstet letrare dhe fjalorët do të ndihmojnë për argumentuar teoritë.

Disa veçori të formës në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore pasqyrohen në këtë kapitull prandaj edhe formimi i njësive frazeologjike lidhet me përdorimin e fjalëve të veçanta, me veçoritë emocionale dhe me veçoritë kuptimore. Në gjuhën shqipe ndeshen edhe njësitë frazeologjike që formohen nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi dhe shtjellohen edhe si njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore. Ndonjëherë njësitë frazeologjike varen edhe nga ndërfutja e elementeve në brendësi të një njësie frazeologjike mbiemërore që lejon edhe modifikimin nga ana semantike. Jo gjithmonë në njësitë frazeologjike mbiemërore është e pranishme gjymtyra e mbiemrit, por edhe kur mbiemri është i pranishëm ai mund të jetë i zëvendësueshëm me mbiemra të tjerë sinonime të tij.

Në **kapitullin e pestë** dëshirojmë të trajtojmë disa fusha leksiko-semantike dhe pasqyrime të elementeve të etnokulturorë në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore. Do të sjellim në vëmendje edhe shembuj që pasqyrojnë shfrytëzimin me mjeshtëri të pasurisë leksiko – semantike përmes fjalëve të reja ose të vjetra, sinonimeve, antonimeve, krahinorizmave etj. Paraqesim pikëpamjet e veçanta të pjesëtarëve të një grupi të cilat janë pasqyruar në kulturë dhe sigurisht edhe në gjuhë (këtu sjellim edhe shembuj nga qyteti i Rrogozhinës). Duke u bazuar në përjasje dhe etnologjinë e përdorimit të frazeologjisë në varësi të grupeve shoqërore (burra, gra), përcjellim edhe qëndrimet tona për këto vlera gjuhësore. Po kështu kemi paraqitur disa njësi frazeologjike nga bota bimore të mbledhura në zonat përreth qytetit ose njësi frazeologjike nga bota shtazore. Ligjërimi ynë ka një formë të caktuar dhe një përmbajtje të caktuar, në varësi të mendimeve që duam të përcjellim, në varësi të gjendjes emotive që duam të shfaqim apo në varësi të kontekstit që përshfaq njësia frazeologjike. Në më të shumtat e rasteve njësitë frazeologjike janë ndërtuar në funksion të rrethanave të ligjërimeve, familjare ose jashtëfamiljare, profesionale ose jashtëprofesionale. Disa njësi të tjera frazeologjike janë shkëputur nga arti i kuzhinës dhe shembuj të tjerë janë nxjerrë nga disa fusha ku merren si modele në ngjyrat, për të plotësuar dendurinë e përdorimit të njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore.

Kreu i fundit do të përmbajë përfundime për secilin kapitull, me mendimet dhe sugjerimet përkatëse për njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore. Për të plotësuar punimin në fund dëshiroj të pasqyroj një fjalorth të shprehjeve frazeologjike të përdorura në këtë studim.

KAPITULLI I.

FRAZEOLOGJIA DHE NJËSITË FRAZEOLOGJIKE (TRAJTESË TEORIKE)

1.1 HYRJE (koncepte të përgjithshme)

Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980 termin *frazeologji* e gjejmë të përkufizuar në këtë mënyrë: *Tërësia e togjeve dhe e thënieve a shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësisishëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme.*

Pra, në një kuptim të përgjithshëm, njësitë frazeologjike janë shprehje të ngurosurat ose gjysmë të ngurosurat, të cilat përdoren në ligjërimin e përditshëm dhe kryejnë funksionin e një fjale duke mbartur edhe ngjyrim emocional të veçantë.

Termi frazeologji me burim nga greqishtja shfaqet hershëm në gjuhësi, por meritat si nismëtar në studimin e njësive frazeologjike i takojnë gjuhëtarit zviceran Charles Bally, autor i *Précis de stylistique, Traité de stylistique et Linguistique générale et linguistique française*. Në *Traité de stylistique*, (Bally Ch,1909: 65–66) autori jep këtë përkufizim : « Nëse në një togfjalësh secila njësi grafike humbet një pjesë të kuptimit individual ose gjithë kuptimin, nëse kombinimi i këtyre njësive paraqitet vetëm me një kuptim tepër të qartë, mund të flitet për një lokucion të kompozuar. Tërësinë e këtyre fakteve ne e përfshijmë nën termin e përgjithshëm frazeologji».

Gjithsesi, termat që përdoren sot në Gjuhësi për shprehjet frazeologjike janë të shumta, mes tyre përmendim: idiomë¹, togfjalësh i qëndrueshëm² (Mehmet. Ç, 1962) shprehje, shprehje idiomatike, frazemë (Mel'čuk,1988), frazë, frazë e qëndrueshme, kombinim fjalësh³, (Cowie,1988; Howarth,1996) frazeologjizëm, lokucion⁴, (Xhuvani.A,1921) etj. Nga sa vërehet, perceptimi i këtyre njësive ndryshon nga një gjuhëtar te tjetri. Përkufizimet janë herë të ngushta, herë të gjera.

Para se të trajtojmë këtë çështje, do të dëshironim të sqaronim konceptin tonë lidhur frazeologjinë. Te përkufizimi i Bally, frazeologjia si term shënon ato njësi gjuhësore të ngurosurat që përkufizohen si njësi frazeologjike a frazeologjizma. Te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), në kuptimin e dytë, frazeologjia përkufizohet si pjesë e leksikologjisë që studion njësitë e tilla të një gjuhe a të një grupi gjuhësor.

Siç nënvizon H.Miçoni⁵, “*Autorë të ndryshëm e vendosin frazeologjinë nën varësinë e fushave të tjera. Kështu, refleksionet e para teorike mbi lokucionet u bënë në semantikë. Bréal (1897) Bally e përfshin frazeologjinë në një përfaqje stilistike të gjuhës.[...] Amosova (1963) dhe A. Kunin (1970) për anglishten. Gläser (1986) përcakton një nivel frazeo-stilistik në gji të stilistikës e cila, edhe ajo vetë, është një disiplinë më vete e gjuhësisë. Për F. J. Haussmann (1979) dhe G. Corpas Pastor (1996), frazeologjia rrjedh*

¹ Term që përdoret më shumë nga gjuhëtarët amerikanë dhe anglezë.

² Mehmet.Ç. (1962)përdor këtë term në artikullin e tij për herë të parë në gjuhën shqipe “Togfjalësia të qëndrueshëm foljorë në gjuhën shqipe”

³ Term i përdorur nga Cowie (1988), Howarth (1996)

⁴ Përdorur nga Xhuvani. A.(1921).

⁵ Miçoni, H, Rreth frazeologjisë së shqipes krahasuar me greqishten, punim doktrate, 2013.

nga leksikologjia: meqë këto njësi bëjnë pjesë në fjalor, depozitohen në memorie si njësi të thjeshta të leksikut. Së fundi, për një numër të caktuar frazeologësh, vendi i ndërmjetëm që zë frazeologjia midis shumë fushave i jep asaj një pozitë ndërdisiplinore. Frazeologjia mund të trajtohet jo vetëm nga pikëpamja e brendshme, nga përjasje të ndryshme (studime gjuhësore në diakroni, në sinkroni, në përkthim, në tipologji, në didaktikë etj.), por edhe nga pikëpamja e jashtme, nga fusha të tjera (nga psikolinguistika, nga sociolinguistika, nga informatika etj.).” (Miçoni, H. 2013:6)

Edhe pse frazeologjia ndodhet në kryqëzim me shkenca dhe me disiplina të tjera gjuhësore, për mendimin tonë ajo mund të konsiderohet si disiplinë gjuhësore më vete, e cila ka objektin e saj të studimit. Në gjuhësinë botërore, pas Bally, shumë gjuhëtarë të tjerë kanë lëvruar në këtë fushë në gjuhë të ndryshme si në rusishte, gjermanishte, anglishte, spanjishte por edhe shqipe, etj.

Në ditët e sotme, interesi për frazeologjinë vazhdon të rritet. Siç nënvizon Bolly⁶ “*frazeologjia, fillesat e të cilës lidhen me nocionin e grupeve frazeologjike të Bally (1909)*”, ka marrë një hov të konsiderueshëm që nga vitet 1980 dhe aktualisht gjen një *jehonë të madhe në gjuhësinë e zbatuar.*” Në vazhdim, ajo shton : “... në mënyrë të përgjithshme, studimet e bëra në frazeologji gjatë dekadave të fundit ndjekin dy prirje të

⁶ Catherine Bolly, *Flou phraséologique, quasi-grammaticalisation et pseudo marqueurs de discours : un no man’s land entre syntaxe et discours?*
http://www.uclouvain.be/cps/ucl/doc/valibel/documents/Bolly_LINX62_SyntaxeDiscours_PrePrintok.pdf, fq. 13.

⁷ Ch. Bally, *Traité de stylistique française*, Paris, Klincksieck, 1909.

mëdha ..., qasjen funksionale, që përqendrohet në studimin e njësive të karakterizuara nga një shkallë minimale nguroseje semantike ... dhe qasjen statistikore, që interesohet për njësitë polileksikore të karakterizuar nga një minimum atraksioni mes njësive”.
(Bolly, C. 2012 :13)

Rritja e interesit lidhet me problematikën e ndërlikuar të saj, e cila ngërthen një gamë të madhe çështjesh të karakterit teorik dhe praktik, duke nisur nga përkufizimi i njësive frazeologjike, klasifikimi i tyre, vëllimi i frazeologjisë, pasqyrimi në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh, përdorimi në mësimdhënie, në informatikë, etj.

1.2 Frazeologjia në gjuhësinë shqiptare

Edhe në gjuhësinë shqiptare interesimi për frazeologjinë ka lindur që herët nga vitet 30 të shekullit të shkuar duke vazhduar deri në ditët tona. Këtu mund të përmendim A. Xhuvani (1921), I. D. Sheperi (1927), J. Rrota (1942), K.Cipo, (1949), M. Domi (1985), S. Prifti (1962), M. Çeliku (1962), Stefi, (1970), Jani Thomaj (1981), etj.

Në fillesat e saj, frazeologjia dhe shprehjet frazeologjike janë trajtuar nga aspekte të veçanta dhe jo në një kuadër të plotë teorik. Në përgjithësi, ato janë përfshirë në studime gramatikore e veçanërisht në sintaksë, të para si togfjalësja të qëndrueshëm nga aspekti funksional. Terminologjia e përdorur ndryshon nga një autor te tjetri. I. D. Sheperi (1927) shprehjet frazeologjike i përfshin nën termin “lokusione”, J. Rrota (1942) flet për “verba frazeologjikë”, K. Cipo (1949) disa i quan “lokusione pavetore”, si p.sh., *bën vapë, u bë ditë, etj.* disa “folje në aorist që tregojnë fillimin e një pune a të një mënyre të qeni, me

idenë e aspektivitetit, si p.sh., *ra i sëmurë, më zunë ethet etj.* M. Domi (1985) trajton togfjalëshat e qëndrueshëm me funksionin e kallëzuesit foljor, të formuara nga një folje e një emër, të shoqëruara ose jo me parafjalë dhe i quan “shprehje”, si p.sh., *kam frikë, mbaj mend, ngul këmbë etj.* S. Prifti (1962) flet për “shprehje ndajfoljore”. M. Çeliku (1962) dallon togfjalëshat e qëndrueshëm të gramatikalizuar nga togfjalëshat e qëndrueshëm të leksikalizuar.

Pas viteve 80, ashtu si në gjuhësinë botërore, edhe në atë shqiptare, qoftë në Shqipëri apo në Kosovë, studimet për frazeologjinë marrin një hov të ri sidomos me punimet e J.Thomait “*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*” (1981), “*Fjalor i frazeologjik i gjuhës shqipe*” (1999). Frazeologjia nis të konceptohet si fushë studimore më vete. Nis të plotësohet dhe thellohet kuadri teorik lidhur me përkufizimin e njësive frazeologjike, klasifikimin, vëllimin, përdorimin e tyre, fushat leksiko-semantike burimore dhe, së fundi, me pasqyrimin e tyre në fjalorë dhe përdorimin në mësimdhënie.

Pa dashur të bëjmë një listë gjithëpërfshirëse të artikujve dhe studimeve të shumta në këtë fushë, nënvizojmë se arritjet janë të mëdha, çka pasqyrohet edhe në numrin e madh të fjalorëve të botuar si *fjalori i M.Gjevorit “Frazeologjizma të gjuhës shqipe”, Prishtinë (1988); fjalori i H. Bogajt “Frazeologjizmat popullore në Drenicë”, (1990); “Fjalor frazeologjik ballkanik”, Tiranë (1999) nga një grup autorësh; V. Nuhiu, “Fjalor i shprehjeve frazeologjike anglisht-shqip”, (1990); “Fjalor i shkurtër frazeologjik rusisht-shqip”, Z. Sadiku (1990); “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe”, Jani Thomaj; “Fjalor i frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999); “Fjalor*

Frazeologjik Anglisht-shqip”, Ilo Stefanllari, Vangjel Dheri (1981); “Fjalor shprehjesh frazeologjike: Anglisht-shqip”, Vesel Nuhiu, Kosovë, 1990; “Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore”, A. Sula, (2009); “Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore”, Sulejman Drini, Ibrahim Goci, Mehmet Halimi 1982, etj.

Gjithashtu, vitet e fundit janë ndërmarrë shumë punime doktorature mbi frazeologjinë e gjuhës shqipe. Janë bërë dhe po bëhen studime përfaqësuese edhe me gjuhët e tjera si edhe në lëmin e mësimdhënies. Në këtë kuadër përfshihet edhe studimi ynë në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave”.

1.3. Mbi përkufizimin e njësisë frazeologjike

Siç e përmendëm edhe në 1.1. terminologjia e përdorur nga gjuhëtarët për të shënuar njësitë frazeologjike është tepër e larmishme. Edhe pse termi në thelb lidhet me konceptin dhe ka vlerë nga pikëpamja e koherencës brenda tërësisë konceptuale dhe përdorimit të tij nga një autor në një studim a vepër, shumësia e termave të përdorur nga gjuhëtarët nuk e mbulojnë njëri-tjetrin konceptualisht, çka krijon edhe pështjellim.

Te “Leksikologjia e gjuhës shqipe” (2006), theksohet se “*njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme*”. Pra, njësia frazeologjike njihet si njësi gjuhësore me dy a më shumë fjalë shënjuese pa bërë dallimin midis togfjalëshit dhe fjalisë. Kjo nënkupton që struktura e saj mund të shkojë deri në strukturë fjalie me kusht që siç nënvizohet te “Fjalori frazeologjik i

gjuhës shqipe” (1999) “*në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim*”. Përmbledhtazi, nënvizojmë se frazeologjizmat duhet të përmbushin këto kritere :

- 1) *Qëndrueshmërinë e fjalëve ose e elementeve përbërëse;*
- 2) *Pandashmërinë e elementeve përbërëse;*
- 3) *Njësuueshmërinë tërësore, kuptimore e figurative të elementeve përbërëse;*
- 4) *Mosndërtimin ose mosformimin e tyre në momentin e ligjërimin, meqë janë të gatshme;*
- 5) *Brasvlerësinë e tyre me një fjalë të vetme, nga aspekti kuptimor (kjo fjalë e vetme mund të jetë sinonimike me togun frazeologjik, po jo krejtësisht identike me të), ndërsa nga aspekti gramatikor i tërë togu frazeologjik ka vlerën dhe kuptimin e fjalëve emërtuese (Fjalë emërtuese, sikundër dihet, konsiderohen; emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet), përkatësisht si një gjymtyrë fjalie (si gjymtyrë kryesore ose e dytë e fjalisë); (Shumëkuptimësinë tyre, varësisht nga konteksti i përdorimit); etj..⁸ (Spahiu, A. 2008:2).*

Mosdallimi midis strukturës së togfjalëshit dhe fjalisë në rastin e njësisë frazeologjike, si edhe konceptet që lidhen me ngushtësinë, gjerësinë dhe vëllimin e frazeologjisë, nga një këndvështrim vënë në pikëpyetje vetë konceptin e togfjalëshit edhe pse si më sipër

⁸ Spahiu, Agim, Vrojtme leksikologjike, Frazeologjizmat në FGJSSH të vitit 1980, 18 qershor 2008. fq.2.

theksohet se në rastin e njësisë frazeologjike togfjalëshi duhet të ketë minimalisht dy njësi me vlerë shënjuese.

Kjo ka bërë që disa gjuhëtarë, t'i kundërvihen konceptit të togfjalëshit duke përqafuar konceptin e sintagmës. H. Agani (1975) e kundërshton dygjymtyrësinë duke i hapur rrugë kështu teorisë së sintagmës për të cilën Th. Dhima (2007) thekson se “nuk ka sasi të caktuar fjalësh që përbëjnë vëllimin e saj”. Për rrjedhojë, sintagma mund të jetë një apo shumëgjymtyrëshe dhe në përbërjen e saj mund të përfshihen si përbërës edhe përemrat, numërorët dhe parafjalët edhe pse nuk janë fjalë shënjuese⁹.

Por a duhet zëvendësuar koncepti togfjalësh me termin sintagmë ?

Në tezën e doktoratës Miçoni (2013), duke iu referuar disa gjuhëtarëve, e mbron këtë tezë si më poshtë : *“Në këtë kuadër, përqafojmë teorinë e sintagmës së qëndrueshme për strukturën shumëfjalëshe mbi të cilën duhet të bazohet frazeologjia, meqenëse ajo është më përfshirëse se struktura togfjalëshore. Rëndësinë e sintagmës në hulumtimet tona frazeologjike e shohim në zbulimin e shumë rasteve të tjera njësisish shumëfjalëshe të qëndrueshme, si p.sh., në tym, me spec, me bisht etj. të shprehura me sintagmë parafjalore ose e piu, e qau, i dhashë një (në kokë) etj. Të shprehura me sintagma njëri përbërës i të cilave është përemër ose numëror dhe që duhen pranuar si njësi frazeologjike. Rëndësinë e sintagmës e shohim edhe në justifikimin e disa rasteve që pranoen si njësi frazeologjike, si p.sh., njësitë frazeologjike vret e pret, varg e vistër, zhyt e mbyt, keq e*

⁹ Miçoni, H.vep e cit, fq 11

keq, flakë e flakë etj. të cilat shprehen me marrëdhënie bashkërenditëse dhe të cilat, për rrjedhojë, nuk justifikohen me teorinë e togfjalëshit i cili përkufizohet si lidhje nënrenditëse fjalësh emërtuese. Edhe njësitë frazeologjike, si p.sh., me kuç e me maç, fol e qesh etj. nuk mund të justifikohen me teorinë e togfjalëshit, sepse ato shprehen jo vetëm me marrëdhënie bashkërenditëse, por edhe me sintagmë parafjalore, pra me dy sintagma paralele dhe jo me togfjalësh. Edhe rastet (u zhduk) sa hap a mbyll sytë, (bërtet) me sa ka në kokë etj., shpjegohen më saktë me teorinë e sintagmës (foljore) sesa si strukturë fjalie. Teoria e sintagmës kontribuon edhe në njohjen e lokucioneve gramatikore si njësi shumëfjalëshe me natyrë frazeologjike si rezultat i strukturës shumëfjalëshe sintagmore dhe i kufizimit leksikor, si p.sh., në drejtim të, duke qenë se, etj.”¹⁰

Nga më sipër, për mendimin tonë, koncepti i sintagmës, i përmendur edhe nga Bally (*Traité de stylistique française*, 1909), me gjithë dallimin mes sintagmës së lirë dhe asaj të qëndrueshme, referuar shembujve *në drejtim të, duke qenë se*, nuk bën ndarjen e qartë mes njërive frazeologjike me vlerë leksikore dhe atyre me vlerë gramatikore.

Një term tjetër që përdoret shpesh për të shënuar shprehjet frazeologjike është “frazema”¹¹. Frazema në përgjithësi përkufizohet si një kombinim polileksikor (së paku dy përbërës) i leksikalizuar (d.m.th. i riprodhueshëm si diçka e gatshme). Ajo përbën një

¹⁰ Miçoni, H, vep e cit, fq 11- 12

¹¹ Një studim të hollësishëm lidhur me frazemën e gjejmë te MÁRTON NÁRAY-SZABÓ: Quelques remarques sur la définition du phrasème *Revue d'Études Françaises*, No7 (2002), fq 71-81, dhe te BÁRDOSI, V., «Entre fild'Ariane et tonneau des Danaïdes. Problèmes de classification des phrasèmes français », in : *Revue d'Études Françaises*, no 4, 1999, fq. 23-33.

element koheziv shumë të rëndësishëm të operacioneve mendore dhe të « kulturës së ndarë»¹² të një gjuhe.

Sipas MÁRTON NÁRAY-SZABÓ (MÁRTON NÁRAY-SZABÓ 2002:80) tri janë kushtet e nevojshme : “polileksikaliteti”, “kuptimi tërësor” dhe “ngurosjë leksikore”. Ndërsa Mel’čuk et al¹³, propozon tri tipa frazemash;

- a) frazema të plota tërësisht të leksikalizuara,
- b) kuazi-frazema, pjesërisht të leksikalizuara
- c) gjysmë-frazema që i afrohen afrimitetit semantik të leksive sipas Cruse,¹⁴
(Cruse D.A., 1986:18)

Termi *frazemë* duket se është një term gjithëpërfshirës përjashtuar këtu kompozitat. Si i tillë ai “përfshin të gjitha shprehjet e qëndrueshme të një gjuhe, si p.sh., kolokacionet, idiomat, kuazi-idiomat, sentencat, shprehjet e rutinës, proverbat”.¹⁵ Kurse te Jani Thomaj (1999) termi *frazemë* na del si përdorim në frazeologji në vend të fjalës strukturë apo si njësi themelore e fjalorit frazeologjik.¹⁶

Në konceptin tonë, termi *frazemë*, si vazhdimësi e termave të tjerë *fonemë*, *monemë*, *leksemë*, krijuar kryesisht për të bërë dallimin mes *leksemës* dhe njësive më të mëdha se

¹² Term i përdorur shpesh nga Robert Galisson.

¹³ Mel’čuk Igor. Clas André dhe Polguère Alain, 1995, Introduction à la lexicologie explicative et combinatoire, Ed. Duculot.

¹⁴ Cruse D.A., (1986), Lexical semantics, Cambrige University Press

¹⁵ Burger et al. (2007), cituar nga Miçoni, po aty, fq. 22

¹⁶ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

ajo, edhe pse i pranueshëm si koncept operator në leksikografi, kur flitet për përcaktimin e kufijve të frazeologjisë leksikore, për vëllimin e frazeologjisë, krijon shumë probleme.

Një term tjetër i përdorur për shprehjet frazeologjike është termi *kolokacion* që vjen nga latinishtja (*collocare* që do të thotë “vendos bashkë”). Pra, termi shënon një situatë gjitonië (fquinjësie). Edhe pse flitet shpesh për kolokacione, në rastin e frazeologjisë mes njësive frazeologjike dhe kolokacioneve ka dallime. Dallimi kryesor qëndron në faktin që lidhja mes njësive që përbëjnë kolokacionet nuk shoqërohet me humbje motivimi.

Kuptimi i kolokacioneve rrjedh nga kuptimi i njësive përbërëse, pra është analitik. Gjithashtu, ngurosja sintaksore nuk është kriter përcaktues të kolokacionet siç ndodh në rastin e njësive frazeologjike, edhe pse tek këto të fundit ka raste të një ngurosjeje jo të theksuar. Prandaj edhe ky term, në konceptimin tonë, nuk do të mund të zëvendësonte dot termin njësi frazeologjike, kur flasim për ato njësi me vlerë leksikore

1.4. Rreth kufijve të frazeologjisë leksikore

Problemi që shtrohet ka të bëjë kryesisht me dallimin mes frazeologjisë në kuptimin e ngushtë dhe frazeologjisë në kuptimin e gjerë. Në varësi të këtyre dy koncepteve përcaktohet edhe kufiri i frazeologjisë leksikore. Sigurisht që gjuhëtarët nuk ndajnë të njëjtin qëndrim. Disa gjuhëtarë e ngushtojnë gamën e frazeologjizmave duke përfshirë disa fjalë me kuptim të figurshëm, ose shumë të ngushtë, vetëm për strukturat idiomatike (të pamotivueshme)¹⁷.

¹⁷ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Në strukturën gjuhësore çdo fjalë e përbërë apo e përngjitur që është e përbërë nga dy morfema do të trajtohej si njësi frazeologjike. Kështu, Makkai¹⁸(2000:19) ka një këndvështrim të vetin për njësinë frazeologjike, e cila, sipas tij, është njësi që realizohet nga të paktën dy fjalë. Njësitë frazeologjike përdoren kryesisht në kuptimin e figurshëm dhe ky kuptim nuk mund të përcillet nga gjymtyrët e veçuara, por vetëm duke i lidhur kuptimet e të gjitha gjymtyrëve përbërëse në një të vetëm, në kuptimin që ai të jetë përfaqësues për njësinë. Kjo lidhet me këndvështrimin dhe njohjen tonë si individë dhe me faktet gjuhësore që njohim.

Gjuhëtarë të tjerë kanë një koncept më të gjerë. Përveç bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve të formuara historikisht, të leksikalizuara dhe të barasvlershme nga kuptimi me një fjalë të vetme, ata përfshijnë edhe lëndën e folklorit, proverbat, fjalët e urta, gjëzat etj¹⁹. Kështu, me frazeologji në kuptimin e ngushtë Burger (2007) kupton studimin nga frazeologjia të njëjstëve “më të shkurtra se fjalja”.

Këtë qëndrim mbajnë edhe Thomai dhe Varfi²⁰ duke e kufizuar studimin vetëm te frazeologjia leksikore. Frazeologji në kuptimin e ngushtë, kësisoj, ka si objekt studimi vetëm strukturat e qëndrueshme shumëfjalëshe të barasvlershme me fjalën. J. Thomai (1981) frazeologjinë e përkufizon si “tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të

¹⁸ Bilkova, I. (2000): Czech and English Idioms of body part, vep.e cituar, fq.19

¹⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

²⁰ Varfi, N. (1999) Introduction a la lexicologie du francais, SHBLU.

fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me një fjalë të vetme”.

Kriteret që zbatohen janë si më poshtë :

1) kriteri i moskompozicionalitetit, Bally (1909); “Thuhet që një grup formon një njësi kur fjalët që e përbëjnë humbasin çdo kuptim dhe se vetëm tërësia ka kuptim; përveç kësaj duhet që ky kuptim të jetë i ri dhe të mos jetë thjesht i barasvlershëm me shumën e përbërësve”.

2) kriterin i figurshmërisë

3) kriterin i barasvlershmërisë me fjalën (shih Thomai, 1981; Smirnitsky, 1959)

Ndërsa frazeologjia në kuptimin e gjerë përcaktohet nga kriteri i përdorimit të rregullt në një formë të qëndrueshme, pavarësisht nga njësia semantike e togfjalëshit apo nga ndarja e togfjalëshit në kuptimet e fjalëve përbërëse. Në kuptimin e gjerë kuptojmë përfshirjen në frazeologji edhe të njësive me vlerë fjalie, si p.sh., proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit, kolokacionet e kufizuara frazeologjike, proverbat, fjalët e urta, gjëzat, citatet, madje edhe për binomet e pakthyeshme frazeologjike, lokucionet gramatikore, frazeotermat, si p.sh:

gënjeshtër i ka këmbët të shkurtra, qesh më mirë kush qesh i fundit, dyllë i verdhë, mjaltë i ëmbël, shëndoshë e mirë, mirë e bukur, në drejtim të, duke qenë se, dërrasë e zezë, zorrë e hollë, çelës anglez, thyej rekordin etj²¹.

²¹ Për më tepër shih, Miçoni, H. vep. e cit. fq. 8

Procesi i ligjërimimit është një proces që shkon sipas rregullave të caktuara gjuhësore. Ai është një strukturim i veçantë i gamës së gjerë të njohurive tona, qofshin këto njohuri gjuhësore apo njohuri rreth botës, jetës dhe realitetit. Sistemi frazeologjik është i pasur me shprehje frazeologjike dhe proverba, por shumë studiues mbrojnë mendimin se mjaft njësi frazeologjike nuk kanë gjithnjë gjegjëset e tyre letrare. Për këtë arsye edhe Moon²² edhe Jani Thomai²³, në studimet e tyre nuk i përfshijnë në frazeologjinë gjuhësore, njësitë e tjera si: proverbat, dhe fjalët e urta. Këto të fundit gjejnë vend të rëndësishëm në pikëpamjet e studiuesve konjativistë.

Njësia frazeologjike ka si karakteristikë të vetën subjektivitetin dhe emocionin dhe shpeshherë këto njësi janë të shprehura me metafora (emra, folje dhe mbiemra) ose shprehje metaforike. Denduria e përdorimit të njësive frazeologjike në stile të ndryshme gjen hapësirat e veta edhe në letërsinë artistike. Njësitë frazeologjike jo rrallë plotësojnë boshllëqet e leksikut sidomos për fjalë të veçanta si në ligjërimin e përditshëm (të zakonshëm) edhe në tekstet e shkruara artistike të cilat meritojnë vëmendje të posaçme.

Krahas teorive dhe pikëpamjeve të ndryshme për frazeologjinë gjuhësore ekziston një teori tjetër, ajo e gjuhësisë konjitive, e cila gjithnjë e më shumë po i kundërvihet gjuhësisë tradicionale në lidhje me frazeologjinë. Kjo teori është e bazuar në mënyrën sesi njerëzit e

²² Moon, R. (1998): Fixed expressions and idioms in English, Oxford:Clarendon Press, fq. 6 vep.e cit. shih: Vora, R.

²³ Thomai, J. (1981): Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, fq. 269.

perceptojnë botën rreth tyre dhe si e pasqyrojnë këtë në procesin e ligjërimit dhe në njësitë frazeologjike.

Sipas pikëpamjes tradicionale, njësitë frazeologjike janë fenomene të veçanta në gjuhë, të shkëputura nga koncepti që kanë njerëzit, ndërsa sipas pikëpamjes së gjuhësisë konjitive njësitë frazeologjike janë kryekëput produkt i njohurive tona për botën. Njësitë frazeologjike, janë pjesë e rëndësishme e stilit bisedor dhe si të tilla ato janë pjesë e mikrosistemeve konceptore dhe jogjuhësore. Nisur nga këto mund të themi se njësitë frazeologjike lindin dhe zhvillohen brenda sistemit gjuhësor. Këto njësi formojnë perceptime të figurshme të realitetit, prandaj për të vlerësuar karakteristikat, funksionin dhe për të përcaktuar tiparet e figurshmërisë dhe motivimin gjuhësor duhen parë edhe elementet përmbajtje dhe formë.

Nga pikëpamja e gjymtyrëve njësitë frazeologjike janë togfjalësha, sepse ato përbëhen nga dy a më shumë gjymtyrë dhe kanë karakter të figurshëm. Kuptimi tërësor i tyre del nga një lidhje kuptimore që është formuar në kohë dhe nga shndërrimi kuptimor deri në konceptin tonë, lidhur edhe me temën, për sa kohë që lëvrojmë në lëmin e leksikologjisë, proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit fjalët e urta, gjëzat, citatet, madje lokucionet gramatikore, frazeotermat, duhet të mos përfshihen në frazeologjinë leksikore. Në veprën e tij, “Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe”, I.D.Sheperi (1927:139) i emërton togfjalëshat frazeologjikë nën termin lokucion, duke i përkufizuar si dy a tri fjalë që, edhe pse të ndara, përbëjnë një kuptim të veçantë. Po kështu, ai bën edhe klasifikimin e tyre në emërorë, foljorë dhe mbiemërorë.

1.4.1. Proverbat dhe njësia frazeologjike

Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980, *proverbin* e gjejmë të përkufizuar në këtë mënyrë: *Fjali e shkurtër, që shpreh një mendim të plotë, të figurshëm e të mprehtë, i cili përgjithëson përvojën e shumë brezave dhe zakonisht përmban një mësim të urtësisë popullore për jetën e për dukuritë e ndryshme të saj.*

Proverbat janë thënie të cilat organizohen nga ana strukturore si fjali dhe kanë një pohim të mbyllur dhe të vërtetë. Disa studiues postvinogradovianë mendojnë se proverbat duhet të studiohen së bashku me njësitë frazeologjike. Disa të tjerë, midis të tjerëve edhe J. Casares (1950), N. N. Amosova (1963), J. Thomai (1981:269) etj. mendojnë se njësitë që nuk përbëjnë pjesë të fjalisë është e gabuar të përfshihen në sistemin e gjuhës, sepse janë njësi të pavarura të komunikimit. J.Thomai (1981;269) i përfshin ato në të ashtuquajturën ‘fazeologji letrare’. Qëndrueshmëria dhe kuptimi i figurshëm i afron njësitë frazeologjike me proverbat, por proverbat nuk duhen të përfshihen në frazeologjinë leksikore.

Shqetësimi kaloi gjoks me gjoks në të gjithë plazhin : “ Bubu!” Ç’i ndodhi shokut Zylo! Prandaj e pamë të mërzhitur dhe të pikëlluar! Si nuk u kujdesëm, xhanëm! Ta kishim sinjalizuar me kohë! T’i luteshim të mos dilte në diell! Këto fjalë të hidhura ishin në rend të ditës. Por nëpërmjet këtij zemërimi shprehej një dashuri e thellë për shokun Zylo. (Dritëro Agolli,Vepra letrare 6, fq.191) (njësi frazeologjike)

Nuk mbulohet (zihet), dielli me shoshë. (proverba)

“ ...Diell kërkon të bëhesh - a ? Edhe dielli që është diell, nuk e ngroh dot gjithë botën, se kjo botë ka shumë gryka e shpella. Vëri gishtin kokës...” Gjyshi ia kthente : “ Elbete,

njerëz jemi : vjen dita që edhe do vdesim, se vdekjen e kemi borxh, po buka është bukë .
Kur e ke, jepe, se ai që të kërkon e ka pisk, s'të zgjat dorën më kot. Kush mban furrë,
duhet ta bëjë zemrën sa furra... (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 121)
(njësi frazeologjike)

Bukë e kripë, e zemrën e bardhë. (proverba)

Proverbat kanë strukturë fjalie. Ato shprehin një këshillë ose përvojë popullore dhe gjymtyrët e tyre kanë kuptim të drejtpërdrejtë. Vërejmë se ato nuk e humbasin pavarësinë e vet dhe e ruajnë rrafshin kuptimor.

Psh: *Më mirë një mik se një thesar. – Better a friend than treasure.*

Dallimi i parë mes njësive frazeologjike dhe proverbave është ndryshimi në strukturë. Shembujt e mësipërm tregojnë se proverbat janë të ndryshme nga njësitë frazeologjike. Vumë re se njësitë frazeologjike janë njësi të gatshme që përshtaten me strukturën e një fjalie që ka një funksion të caktuar .

Agai e mori për dore, e kapërceu mbi një shteg edhe u bëri pastaj shenjë me dorë të tjerëve të afrohen. Me drojtje erdhë ata, po gjithë erdhë. Shtegun e kaptuan vetë.

- Ti - i tha agai të madhit, - ec e merr një shportë të ta mbush me rrush. Dhe ***djali këmbëlepur*** iu shtrua rrugës. Dum – dum – dum, bënë këmbët e tij të zbathura. Agai nxori thikën e zu të zgjedhë rrush të pjekur. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 60 – 61)

(njësi frazeologjike) *Këmbët e shpejta, faqebardhë.* (proverba)

Është nisur pastaj, ai në mes e trimat rreth e rrotull, e ka zhavuluar të piqet me njetë Moskov mjekërverdhë. **Me gaz të madh** ka shkuar, sikur ish dasmë e jo luftë ku derdhet gjak. Kush u kthye pastaj e kush jo, se u firos në luftë – se luftë pa vdekje, si tha ai, e bukë pa thërrime s'ka si bëhet. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 18) (njësi frazeologjike)

Dasmë pa mish dhe luftë pa gjak nuk bëhet. (proverba)

Dallimi midis proverbave dhe njësive frazeologjike në aspektin semantik është edhe më i qartë. Proverbat japin këshilla, moralizojnë, kritikojnë etj. Prandaj ato mund të krahasohen edhe me fabulat sepse përmbledhin eksperiencën e një grupi shoqëror.

*Po më e keqja nga të gjitha qenke kur s'paske xhephane. E ruanim plumbin **si sytë e ballit**, të mos vejë bosh. Kur na mbaroheshin fishekët, e vinim shpirtin në majë të thikës a në konak të dyfekut, edhe bjeri t'i biem **si me qent' e stanit**.* (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 16) (njësi frazeologjike)

Duaje atdhenë, si shqiponja folenë. (proverba)

... “ *More qerrata, po si dreqin vetë e rrokullisesh edhe ti kështu e na bëhesh **gur qosheje**?*” *Se si e thotë llafi, vete haku te i zoti dhe këtu ne i mbyllim hë për hë bëmat e Duro Malltezit.* (Teodor Laço, *Zemërimi i një njeriu të urtë*, fq. 187) (njësi frazeologjike)

Miku i mirë, (gjendet) në ditë të vështirë . (proverba)

Siç vërehet proverbat janë fjali, ndërsa njësitë frazeologjike nuk i kanë këto veti. Ato janë të barabarta me një koncept të vetëm dhe funksioni i tyre në ligjërim është shënues, ndërsa funksioni i proverbave në ligjërim është komunikues. Në mjaft raste proverbat shndërrohen lehtë në njësi frazeologjike. Ka raste kur një togfjalësh fillon të përdoret si

njësi frazeologjike edhe pse më parë ka qenë pjesë e një proverbi. Ky togfjalësh fillon e shndërrohet në njësi të pamotivuar dhe lidhja me proverbin nuk është e qartë.

Silence is golden. - Heshtja është flori. (7-th edition Oxford, Advanced Learner's Dictionary, fq. 1368)

These rich kids expect to have all handed to them on a silver platter. (7-th edition Oxford, Advanced Learner's Dictionary, fq. 1382)

Ka edhe raste kur njësia frazeologjike është zgjeruar me fjalë të tjera. P.sh:

*... E jo dasma sidokudo, sa për të shkuar radhën, po dasma nga ato që **ha qeni petulla** e kërcasin trarët e shtëpisë! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 115)*

Shpeshherë mjaft proverba kanë në përbërjen e tyre, njësinë frazeologjike si gjymtyrë:

Dardha bie nën dardhë.

Nuk do as mend as kalem, shih e shkruaj.

Pema që ka kokrra goditet me gur.

Kush ka frikë nga hija e tij, le të mos tundet nga vendi.

Kalliri fyl e mban kokën përpjetë, ai plot e mban kokën ulur.

A friend in need is a friend indeed.

Better late than never.

Dead men tell no lies.

Siç vërehet në përqasjen e njësive frazeologjike me proverbat ka mjaft raste të dyshimta ose kalimtare dhe mund të trajtohen edhe si elemente të frazeologjisë letrare edhe si elemente të frazeologjisë. Këtë e konstaton edhe prof. Thomai (1964:85) edhe pse i është

bërë një ndarje mes frazeologjisë letrare dhe asaj gjuhësore ende ka raste që duhen shqyrtuar.

1.4.2. Veçori të përgjithshme të njësive frazeologjike me vlerë leksikore

Meqenëse njësitë frazeologjike janë bashkime fjalësh, të cilat janë lidhur me kalimin e kohës, ato duhet të kenë patjetër tiparin idiomatik që të emërtohen si frazeologjikë. Si të tilla ato janë të ngurtësuar dhe përdoren lehtësisht në ligjërime, ashtu si një fjalë e vetme dhe e pa ndarë.

Kur u shpërndanë njerëzit, unë dhe ajo e zëmë për dore shokun Zylo dhe dolëm bashkë. Ai ende ishte i skuqur dhe i djersitur nga lodhja. Por në qenien e tij ndihej një kënaqësi e madhe dhe një lumturi e hapur.

- Rrija **me zemër të ngrirë**. Thosha me vete: “Si do të pritet raporti Zylos?” Por bukur, bukur,- i tha Adila burrit. (Dritëro Agolli, Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo fq.20)

Mora përsëri bukë e djathë e dola në Mburima,ku uji mburonte glu-glu-glu, me flluska të rrumbulla; ku ngriheshin e binin fije shuri. Atje ujin e pija **me gojë e hundë** brenda. Dhe së brendëshmi, në ujë,një tjetër djalë si vetë Theofili i afrohej fytyrës sime . (Mitrush Kuteli, Vepra letrare fq. 73)

Meshkujt e kësaj dere kanë qenë njëherë e njëkohë, veç botës, jo vetëm për punë shpate a hute, që i punonin, si punon bulku parmendën, e muratori çekanë e mistrinë, po edhe për mendjen e ndritur e për zemrën flori që kanë patur të gjithë, ashtu siç i ka hije burrit të vërtetë. Ata **s’e kishin vënë kurrë vdekjen në kandar**, s’i qenë drojtur kurrë.

(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.55)

*Ceni e dinte se ata që kërkonin në këtë orë të natës, zakonisht nuk e kishin mendjen te llogaria mos harxhonin më shumë nga ç'duhet. Ata pas disa gotave **bëheshin dorëshpuar**, llafazanë, të mallëngjyer nga njëri-tjetri, jashtëzakonisht të dashur, sentimentalë të kotë. Klientët e tillë ishin më të preferuarit e kamarierëve si Ceni. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit fq.161)*

*What concerned him most was all the talk about the nigger pleading insanity and getting off. It wasn't right. The nigger killed his brother **in cold blood**, planned the shooting. He hid in a closet and waited for his brother. (John Grisham, A time to kill, fq. 140)*

*Adam shifted uncomfortably. 'Uh, different reasons.' ' Let me guess. You want to serve humanity, give something back to your community, or, perhaps, you feel guilty because you spend so much time here in this sweatshop billing by the hour that you want to cleanse your soul, **get your hands dirty**, do some honest work, and help other people.' (John Grisham, The chamber, fq. 31)*

*Adam shifted uncomfortably. 'Uh, different reasons.' ' Let me guess. You want to serve humanity, give something back to your community, or, perhaps, you feel guilty because you spend so much time here in this sweatshop billing by the hour that you want to cleanse your soul, get your hands dirty, **do some honest work**, and help other people.' (John Grisham, The chamber, fq. 31)*

Njësitë frazeologjike janë togje fjalësh të cilat janë më dy fjalë shënjtuese si : *to be correct*,

have a beautiful day, out of the question ose me një fjalë shënjuese si: *black heart, redfaced.*

Këto njësi janë të përbëra nga një folje dhe një mbiemër dhe ndonjëherë mbartin edhe kuptim foljor edhe kuptim mbiemëror.

“What do you suggest, Mr. Childers?”

“ Half a million apiece!” Childers announced proudly and sat down. Half a million ! Out of the question, though Bullard. He sipped fusiosly and glared at the prosecutor. Half a million! Double –crossed in open court. He sent Mr. Pate after more ice water. (John Grisham, A time to kill, fq.68)

Kuptimi i njësisë frazeologjike është tërësisht një shndërrim i figurshëm që zbulon dhe reflekton konceptimin dhe marrëdhëniet e njeriut me botën dhe realitetin. Njësitë frazeologjike me një togfjalësh të lirë kanë të pranishëm kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm. Kuptimi themelor i njësive frazeologjike del nga shkrirja kuptimore e fjalëve dhe i kombinimit të tyre në tërësi. Njësitë frazeologjike janë togfjalësha që mbartin një koncept të vetëm që lidhet me parimin e arbitraritetit²⁴ (shenjën dhe të shënuarin), sipas të cilit njësitë frazeologjike e përcjellin kuptimin e tyre nga shkrirja e kuptimit të gjymtyrëve përbërëse. Gjuha është pasqyrë e kulturës së një shoqërie të caktuar, ajo përbën

²⁴ Parimi i arbitraritetit u studiua nga De Soussure, i cili, në “Cours de Linguistik Generale” (1915), e përkufizoi shenjën gjuhësore të përbërë nga koncepti (the signified) dhe një togfjalësh tingujsh (the signifier) lidhja e të cilave është arbitrare. Studiuesit e përdorin këtë parim në lidhje me frazeologjinë për të identifikuar si arbitrare lidhjen ndërmjet gjymtyrëve të një njësie frazeologjike dhe kuptimit të saj tërësor. Vep. e cituar shih. Vora.R. fq. 7

pasurinë e leksikut që trashëgohet ndër brezni. Në gjuhë pasqyrohen përvojat njerëzore të shoqërive të ndryshme dhe sidomos pasqyrimin më të plotë të këtyre përvojave njerëzore e gjejmë tek njësitë frazeologjike. Këto janë togfjalësha të ngurosurat dhe përdoren në ligjërim si njësi të gatshme, ndryshe njihen si togfjalësha të pandryshueshëm, ndërsa togfjalëshat e ndryshueshëm emërtohen togfjalësha të lirë, sepse gjymtyrët e tyre përbërëse mund të ndryshojnë gjatë ligjëritimit.

P.sh: “me buzët varur” dhe “me buzë plasur” (i mërzitur, i zemëruar) ose “e bardhë” me “e zezë”, *me zemër të bardhë dhe e kishte zemrën e zezë (blozë), për të qitur sytë dhe për të nxjerrë sytë...* (i shkathët, çapkën), *e prishi zemrën dhe e prishi gojën..*

*Atëherë ishte djalë dhe të gjitha këto i dukeshin të huaja, sikur i përkisnin një tjetri, një njeriu të largët, që në fund të fundit, mirë t’i bëhej, se i atij “zanati ish”. Por s’paskësh qenë kështu. “**Dita ime më e bardhë** ishte dita kur pela më polli një mëz. Dita ime më e zezë kur gruaja me polli vajzën e dytë...Të kisha një djalë...”Sa herë i vinte në mend kjo dëshirë, i këputej në mes, se tashmë i plakur, e kuptonte kotësinë dhe trazirën që i sillte ky mendim. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit. fq.63.)*

*Gaz si atëherë s’ka pasur kurrë në shtëpinë tonë. E mora vesh më vonë, se këto të gjitha m’i kish kurdisur vetë xhaxhai – hej, zot që je një – që të **mos e prish zemrën** se nuk më mori në luftë... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.23)*

Togfjalëshi frazeologjik është i qëndrueshëm. Qëndrueshmëria dhe motivimi (idiomatika) mund të konsiderohen si aspekte të ndryshme të togfjalëshave frazeologjike . Motivimi

është tipari dallues i njësive frazeologjike që përfshijnë togfjalësja të qëndrueshëm dhe jo të qëndrueshëm.

Në disa njësi frazeologjike parashikueshmëria e gjymtyrëve të tyre përcakton edhe qëndrueshmërinë p.sh: në rastin e njësive frazeologjike “*fol e qesh*” ose “*qesh e ngjesh*”. Nëse të paktën njëri nga elementet e njësisë frazeologjike nuk përdoret jashtë saj me të njëjtën vlerë, qëndrueshmëria është e plotë. Në njësi të ndryshme frazeologjike shkalla e parashikueshmërisë është e ndryshme. P.sh. “*i bërë bishë*”, “*i bërë vrer*”, “*i bërë pulë*”, “*i bërë xurxull*”, “*i bërë esëll*” etj.

*Larg oborrit të shtëpisë së Abedinit filluan të vinin të qeshura të tjera. Ata që qeshnin duhet të ishin rreth dy-tri veta. Havaja dhe Xhelo Mara e kuptuan që qeshte Bamja me shokë. Me siguri që ata e kishin ndërsyer Zakën e krisur. Në fillim kishin dërguar Zekirjanë e gjorë, pastaj edhe të birin. Abedini erdhi **pikë e vrer**. U ul në sofër pa fjalë dhe piu njëra pas tjetrës shtatë gota. (Dritëro Agolli, Dështaku, fq.91.)*

*Lotët zunë të rridhnin nga sytë e mi kur dëgjova lutjen e saj. Nuk kisha qarë më parë, se natyra e ushtarit është **të qëndrojnë zemërgurtë**. Tek po fjalosesha shqip me vajzën, koloneli i mahnitur hodhi duart që të pushtonte vajzën. Ia hoqa me rrëmbim nga duart.*

(Foqion Postoli, Vepra letrare 2, fq. 150-151)

Ndonjëherë qëndrueshmëria mund të jetë edhe e ulët, sepse gjymtyrët përbërëse mund të lejojnë fjalë të tjera të futen ose të hiqen në strukturën e njësisë frazeologjike. P.sh:

*Dorina e kuptonte me atë mendjen e saj gjashtëmbëdhjetëvjeçare se zoti Rust, siç kishin nisur t’i flisnin njëri-tjetrit triumfin e jetës së tij e shihte te rrezimi i Kristo Franjës. **Nuk i***

dukej më vetja mizë para Kristo Franjës. Nuk ishte më Lej Fen që shpëtonte stallat (jo, ju lutem, sallat) nga zjarri, por demokrat që shpëtonte kombin nga gangrenat si Kristo Franja e kompani. (Diana Çuli, *Dhe nata u nda në mes...*fq. 205)

E thosh vete me gojën e tij, po më fort e thosh pa fjalë fytyra e çelur që i shndriste. Po ky **na qenkej një gojëmjalte** e na paska pasur një të folur, që ta ftonte zemrën si ujthi i maleve tanë. Ai vetë na u lut të mos e presim kuvendin e këngën po t'ia buçasim si më parë. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 38-39)

Në qenka puna kaq trashë, haj! Edhe ne, dyfeqet mbi sup e oburra! Për në Kozicë, ku janë qypat rëngë me florinj. Kjo ka qenë, që thua ti, **një natë me hënë po e bardhë**, sikur të paskej rënë dëborë. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 24)

Në shembujt e mësipërm vihet re futja e elementeve që nuk janë pjesë e njësisë frazeologjike duke treguar një qëndrueshmëri jo të lartë, pra qëndrueshmëri të ulët .

...Edhe si foli këto, burri ndër të bardha u ngrit përpjetë, lart e lart, edhe u tret **si një re e bardhë**. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 58)

U guros agai nga dhembja, kur e sollën të birë nga lëmi, në tirë. U guros më fort kur i pa fytyrën **si qiri i bardhë**, që s'i ngjante asfare njeriut të gjallë – po tjetër bote. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 53)

Kjo më ngushëlloi pak. Po jo së gjithash, se kasha pasur natën **një grusht me pare të bardha** nëpër duar e m'i kish tretur mëngjesi.(Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare* , fq.73)
Asohere në kohën e foshnjërisë sime, perëndia ish një plak i lashtë, i plotë nga shtati, që

rrinte diku, atje lart këmbëkryq, **e qepte me gjilpërë e shajak të bardhë**, për të veshur botën. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 74)

Ne rrinim këtej, me të mëdhenjtë. Edhe Marina ish atje tej: **më e bardhë se niseshteja e turkave e se pëlhura e kaurkave**. Këtë ma panë sytë e mi! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 173)

Në ka ndonjë hidhërim në shpirt ky Tërfili i vogël që e përkëdhelje me duart e tua të punuara, ky hidhërim është se s'gjendet në botë një qiri kaq i madh për t'u ndezur **atij shpirtit tënd të bardhë**, që bënte qymyr të zi... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.185)

...Bridhte era nëpër qiell edhe çonte e përçonte larg ret' **e bardhëza si vela lundre**. Aq shumë e desh Kirolloi Katerinëzën, sa desh ta bënte mollë e ta mbante në gji.

(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 208)

Edhe sa për verë, gjer aty sa e ktheu prapë, se butet ishin në dera edhe plloskat në goja: me trëndelinë, me borzilok – e lehtë a e rëndë – **si të ta desh e bardha zemër**. E sa për të ngrënë s'ka si bëhet më mirë...(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 227-228)

Balli i Marinës sime rrihte të ngrysej e nuk ngrysej dot. Ishte i sheshtë, **i bardhë si mermeri**. Tamam si Mali ynë i Thatë kur vishet me dëborë, që e bën të shndritë dielli i janarit të mirë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 247)

Shpirtrat e lumtur që silleshin mbi të ishin **të bardhë si argjendi i larë**, e gjithë të bardhë ishin edhe ata që shkuan nëpër ujë. Qëndruan që të dy anës e vështuan bukurinë që buronte atje ku zoti ka stisur fronë e tij.(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 233)

*Zgjata kryet ne oxhaku dhe pashë **qiellin e kthjellët si pikë loti**. Hëna ndriçonte flokët e dëborës që zbrisnin poshtë duke luar valle. U vështolla me gunën e tharë e bëra si gjithë shokët: rashë të flë. Fjeta e u zgjova, fjeta e u zgjova, sepse më dukej sikur dëgjoja të thirrura e të lebetitura. A mos thërrisnin njerëzit e gozhduar të gjallë në ato kamaret e avllisë së hanit të Olloman Beut? Kushedi...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 138)*

Siç vëmë re nga shembujt e mësipërm, njësitë frazeologjike janë përdorur për të shënuar sende, veprime apo mjedise, duke përçuar edhe një ngjyrim emocional përkatës, dhe, në këtë mënyrë, fjalja ose gjithë paragrafi pasurohet nga ana leksikore.

1.4.3. Lidhjet mes figurshmërisë dhe idiomatikës

Në lidhje me idiomatikën e njësive frazeologjike hasim dy teori;

1) atë tradicionale, sipas së cilës njësitë frazeologjike janë njësi të veçanta në gjuhë dhe vetëm çështje të gjuhës të shkëputura nga sistemi konceptor që kanë njerëzit, për dukuritë, për jetën, botën etj.

2) teorinë e gjuhësisë konjitive e cila i trajton njësitë frazeologjike si konceptore dhe pjesë të imazheve mendore të njerëzve për botën rreth tyre, në varësi të kulturave të cilave ata u përkasin.

Njësitë frazeologjike njihen ndryshe edhe me termin idioma, në rastet kur ato kanë lidhje të drejtpërdrejta me kuptimin e figurshëm ose nëpërmjet mekanizmave konjitivë si metonimia dhe metafora. Njësitë frazeologjike reflektojnë imazhe të botës që na rrethon. Imazhet formohen mbi bazën e përvojave tona dhe janë imazhe të pandërgjegjshme. Në

lidhje me idiomatikën mendojmë se kuptimet e figurshme të njësive frazeologjike motivohen nga njohuritë e ligjëruesve në lidhje me metaforat konceptore. Metaforat konceptore janë ato që formojnë pjesë të lidhjes midis një njësie frazeologjike dhe kuptimit të saj të figurshëm. Ato shpalosin mënyrën sesi njerëzit formojnë imazhet konceptore dhe mendore të tyre. Po sjellim disa shembuj për ta bërë të qartë. P.sh. njësia frazeologjike “*daulle e shpuar*” mund të jetë e motivueshme vetëm nëse arrijmë të zbulojmë një lidhje midis gjymtyrëve “*daulle*” dhe “*e shpuar*” me gjegjëset e tyre të figurshëm “*shumë*” dhe “*llafazan*”. Lidhja mes gjymtyrëve të njësisë frazeologjike dhe gjegjëseve të tyre të figurshme është e bazuar tek imazhet metaforike që lidhen me përvojat njerëzore.

Edhe në gjuhën angleze njësitë frazeologjike motivohen nga të njëjtat metafora konceptore, “*daulle e shpuar*” dhe “*perforated drum*” përbëhen nga gjymtyrë që i përkasin të njëjtës fushë semantike: ‘*daulle*’ dhe ‘*drum*’ po kështu edhe ‘*e shpuar*’ dhe ‘*perforated*’. Lidhja ndërmjet gjymtyrëve të njësive frazeologjike “*daulle*” dhe “*drum*” me referentin e figurshëm “*llafazan*” si fjalë e së njëjtës fushë semantike, ku referenti ‘*llafazan*’ mund të kuptohet vetëm metaforikisht si ‘*zhurmë e madhe dhe e panevojshme*’.

Metonimia ashtu si edhe metafora përkufizohet si një mjet që vendos lidhjen mes njësive që ekzistojnë në një strukturë të dhënë konceptore. Këtu mund t’u referohemi përvojave tona, për të gjetur lidhjen mes gjymtyrëve të njësisë frazeologjike dhe referentëve të saj të figurshëm. Veprimet dhe ndjenjat tregojnë shumë për individin p.sh: (shumë e shtrenjtë dhe tepër e pastër) ‘*pikë loti*’ dhe ‘*tear point*’. Shpeshherë bazohemi në

kalimet metonimike për të zbuluar kuptimet e dy njësive ku: ‘loti’ lidhet me pastërtinë, dëlirësinë dhe ‘pika’ është njësi matjeje ose referimi për të vlerësuar sa e shtrenjtë është ajo. Në këtë rast përdoret i njëjti mekanizëm konjitiv për njësitë frazeologjike.

*Ja, tani më duket se zutë ta merrni vesh pyetkën time: po ju shoh se qysh shtypi e përshtypi, vrisni mendjen, varni vetullat e nuk më jepni dot përgjigje. Pa në doni të dini të vërtetën, ju them se vrisni mendjen e varni vetullat kot më kot. Unë, ore, ju flas me të drejtën e Zotit, **me dorë në zemër**, se ja, u thinja e sot jam nesër s’jam, e s’dua të shkoj me një gur mulliri varur në qafë. Se kështu është gënjeshtër: gur mulliri varur në qafë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 54)*

*...Atje ku je sot s’mund të drejtosh domethënë. Shpërndarja e bagëtive, dashuria me atë femrën...dhe këtë radhë i lëpiu buzët, - dashuria me atë femrën, vonesa e të mbjellave, krimbi në farën e misrit, influencojnë ...Në Dëllinjas është kryetar Nexhmedin Gyzeli. **Ka hije të rëndë**, por është burrë i sjellshëm...Mund të qëndrosh në Kallamgjatë, por si brigadë rose si bujk i thjeshtë. Si kuadër në Kallamgjatë nuk mund të punosh...(Dritëro Agolli, Dështaku, fq 142)*

1.5 Mbi klasifikimin e njësive frazeologjike

Klasifikimi i njësive frazeologjike nuk është një ndërmarrje e thjeshtë. Megjithatë, në kuptimin e ngushtë njësitë frazeologjike me vlerë leksikore nga pikëpamja e gjuhësisë tradicionale dhe bashkëkohore i nënshtrohen disa kritereve përzgjedhëse dhe mund të klasifikohen si më poshtë :

1. Sipas kriterit sintaksor: Shumica e gjuhëtarë, nisur nga struktura dhe funksioni sintaksor që paraqesin njësitë frazeologjike, dallojnë “njësi me strukturë togfjalëshi dhe me vlerë fjale” si; *thyej qafën, e bardhe si bora*, të cilat funksionojnë nën nivelin e fjalisë dhe “njësive me vlerë fjalie”, *zihem për mustaqet e Çelo Picarit, ia mbath me të katra, rrobat e palara lahen brenda katër mureve*, etj, të cilat funksionojnë në nivel fjalie. Siç e theksuam, këtë qëndrim e ndajnë shumë gjuhëtarë të huaj por edhe gjuhëtarë shqiptarë mes të cilëve mund të përmendim Thomai (2006), Varfi (1999), Stefanllari (2011)²⁵.

2. Sipas motivimit : Kriteri i shkallës së motivimit bën që shprehjet frazeologjike me strukturë togfjalëshi dhe me vlerë fjale të klasifikohen në disa grupe. Vinogradov-it (1947) dallon shkrirjet frazeologjike, bashkimet frazeologjike dhe kombinimet frazeologjike. “Shkrirjeve frazeologjike” (të quajtura gjithashtu idioma, term i huazuar nga Bally), janë të pamotivueshme dhe të ngurosurë strukturalisht, ndërsa “bashkimet frazeologjike” përbëjnë një tip pjesërisht të motivueshëm, ku kuptimi rrjedh nga transpozimi metaforik i gjithë togfjalëshit, si p.sh; *thyej qafën*. Nënkatëgoria e tretë e Vinogradov-it, kombinimet frazeologjike, është grupi më interesant, sepse në praktikë përbën grupin më të vështirë për t’u përcaktuar. Kombinimet frazeologjike kanë një përbërës të përdorur në kuptim literal, ndërsa përbërësi tjetër përdoret figurativisht. Cowie (1988) dallon :

a) Idioma të pastra të cilat janë plotësisht opake dhe të pandryshueshme.

²⁵ Stefanllari, I, A course in english lexicology, Geer, 2011.

b) Idioma të figurshme të cilat janë pak të ndryshueshme dhe kanë një interpretim të figurshëm dhe një interpretim literal.

c) Kolokacione të kufizuara, të cilat kanë një përbërës literal dhe një përbërës të figurshëm i cili është i kufizuar brenda kësaj lidhjeje. Edhe Bardosi Vilimos²⁶, në artikullin e tij ku shtjellon klasifikimet e ndryshme të frazeologjizmave në frëngjishte, dallon tre grupe të ndryshëm sipas shkallës së motivimit. Grupi i parë përmbledh shprehjet frazeologjike arbitrare (të pamotivueshme) si *avoir maille à partir avec qqn/qqch, mettre la puce à l'oreille de qqn, faire d'une mouche un éléphant*. Grupi i dytë përfshin shprehjet frazeologjike pjesërisht të motivuara, të quajtura *kombinime bicefale* si *tomber comme à Gravelotte, triste comme un bonnet de nuit*, ndërsa grupi i tretë përbëhet nga shprehje frazeologjike të motivuara si *dire des bêtises, perdre la tête*, kuptimi i të cilave mund të nxirret drejtpërdrejt nga kuptimi i njësive përbërëse.

Pothuajse të njëjtin qëndrim me pak dallime kanë zgjedhur edhe gjuhëtarët shqiptarë si Thomai (2006), Varfi (1999). Thomaj dallon;

a) njësitë frazeologjike të pamotivueshme

b) njësitë frazeologjike të motivueshme

c) njësitë frazeologjike të përbëra nga një fjalë me kuptim literal dhe një fjalë me kuptim të figurshëm, nëngrup që i afrohet nënkategorisë së “kombinimeve frazeologjike” vinogradoviane. Varfi nënvizon idiomat (idiomes), njësitë frazeologjike (unité

²⁶. Bardosi Vilimos [www.tintakiado.hu/bardosivilmos/Entre fil d'Ariane et tonneau des Danaïdes, Problèmes de classification des phrasèmes français](http://www.tintakiado.hu/bardosivilmos/Entre_fil_d'Ariane_et_tonneau_des_Danaïdes_Problèmes_de_classification_des_phrasèmes_français).

fraséologiques) dhe bashkimet frazeologjike (ensembles fraséologiques). J. Thomai (1981) termin njësi frazeologjike e përdor si term të përgjithshëm për shprehjet frazeologjike të gjuhës shqipe Ai dallon dy grupe: njësitë frazeologjike të pamotivueshme, si p.sh., *i jap dum, vë re, i bëj ballë, i bën bisht*, dhe njësitë frazeologjike të motivueshme, si p.sh., *i hedh baltë, i kthej krahët, s'e mbyll gojën, vajti si cjapi te kasapi* etj.

Sipas J. Thomait (2006), “njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme”. Duke i mëshuar kriterit të barasvlershmërisë me fjalën, autori (Thomai, 1981) e ngushton disi vëllimin frazeologjik të njësive frazeologjike të zgjeruar nga Vinogradov.

Kategorinë e tretë vinogradoviane ku një përbërës është folje e përdorur figurativisht, J. Thomai e kufizon te foljet e figurshme të cilat kuptimi shkon drejt desemantizimit, si p.sh., *bëj durim, raste* të cilat i përfshin në nëngrupin e dytë të njësive frazeologjike të motivueshme. Pa dashur të zgjatemi shumë, theksojmë se një parashtrësë të plotë të kësaj çështjeje e ka bërë H. Miçoni në punimin e tij të doktoratës, ku shtjellon gjerë e gjatë mendimet e shumë gjuhëtarëve të huaj dhe shqiptarë, kryesisht për idiomat.

1. Sipas vlerës leksiko-gramatikore referuar Bardosi Vilimos, Thomait J. (2006), Varfit, N. (1999), shprehjet frazeologjike ndahen në shprehje me vlerë mbiemërore *i lagur deri në palcë, i kuq si lulëkuqe*, emërore *A-ja dhe Zh-ja, thes i shpuar, kokë e madhe*,

ndajfoljore *me sytë ulur, mirë e bukur, me hundën përpetë, me kokën bosh*, foljore *bëj qejf, mbyll sytë, ha veten me dhëmbë, kthej fletën*.

2. Sipas kriterit të strukturës në shqipe ashtu si në gjuhët e tjera dallohen modele të larmishme si folje + emër *thyej qafën*, parafjalë+ emër + mbiemër *me duar të pastra*, përemër + folje+ parafjalë+emër + mbiemër *e pres me këmbët e para*, etj.

Këtë çështje do ta shtjellojmë më gjerë në krerët që pasojnë ku do të trajtomë më nga afër shprehjet frazeologjike me vlerë mbiemërore.

3. Sipas qasjes retorike referuar gjithnjë artikullit të Bardosi Vilimos mund të dallojmë shprehje frazeologjike që mbështeten te;

amplifikimi (*en dire des vertes et des pas mûre*), jeshil dhe i papjekur ;

antifraza; *si shala gomarit, si budalla me brirë, si dhi shytë*;

antiteza; *as mish as peshk, (ni chair ni poisson)*,

krahasimi; *e bardhë si bora, i fortë si graniti, trim si luani*;

elipsi; *ma hodhe mirë, ma bëre mirë, bëj ballë*;

eufemizmi; (*dévisser son billard*);

eksklamacioni; *këput qafën!, më plasi!, hiqmu sysh!*;

figura etimologjike; *si e ëma e Zeqos majë thanës*;

hiperbola; *sa nuk e lan dot lumë e përrua, e pres qimen më katërsh*;

litota; *nuk është keq, metafora thyej qafën*,

metonimia; (*être soupe au lait*), lufton për kafshatën e gojës, me djersën e ballit;

sinekdoka; *është kokë e madhe*,

aliteracioni; (*copains comme cochons*), *kali i kuq e ka një huq, kashtë e kokrra* etj.

3. Sipas qasjes kulturore, referuar gjithnjë artikullit të Bardosi Vilimos, shprehjet frazeologjike ndahen në;

- a) endogjene, të krijuara brenda gjuhës dhe që kanë si burim jetën e përditshme, traditën gojore dhe vlera të ndryshme etnografike
- b) shprehje të huazuara dhe të kalkuara nga gjuhë dhe kultura të tjera ose nga vepra letrare, mitologjia, bibla si; *i hedh vaj zjarrit, pres nyjën gordiane me shpatë, veza e Kristofor Kolombit, si qershia mbi tortë*, etj.

KAPITULLI I DYTË.

NJËSITË FRAZEOLIGJIKE ME VLERË MBIEMËRORE

2. 1. Hyrje

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë njësi frazeologjike që zëvendësojnë një mbiemër dhe shprehin një vlerë predikative (Thomai, J.1981:84). Edhe gjuha shqipe si gjuhët e tjera është e pasur me këtë tip njësisht frazeologjike. Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe pasqyrohen gjerësisht në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh. Si të gjitha shprehjet frazeologjike, mjaft prej tyre e kanë pikënisjen nga togfjalëshi i lirë, që nëpërmjet tropeve të ndryshme dhe leksikalizimit shndërrohet në togfjalësh frazeologjik.

Për këtë arsye, ato trashëgojnë nga togfjalëshi i lirë elemente si: gjymtyrët, llojet e marrëdhënieve ndërmjet gjymtyrëve, lidhjet sintaksore të tyre, etj. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore, për shkak të semantikës dhe ngjyritit emocional të veçantë, pavarësisht se nga pikëpamja gjuhësore dhe funksionale barazvlerësohen me mbiemrin, përbëjnë një lëndë me rëndësi të veçantë si në ligjërime ashtu edhe në rrafshin stilistik.

Siç e thesuam më lart, njësitë frazeologjike nga këndvështrimi i përgjithshëm janë togfjalësha të përbërë nga dy a më shumë fjalë psh: *ka lakra në kokë, me buzët varur, ha bukën e përmbys kupën, e mban hundën përjetë, e ka kokën bosh, ku di dhija ç'është tagjia, rri me zemër të ngrirë*, etj. Por, në dallim nga togfjalëshat e lirë, ku kuptimi është i drejtpërdrejtë, në togfjalëshat frazeologjikë kuptimi është i figurshëm. Mjaft njësi frazeologjike kanë edhe ekuivalente letrare; ato kanë edhe kuptim figurativ edhe kuptim të

drejtëpërdrejtë psh: *'baltë e dobët'* – mund t'i referohet *'një toke të butë që kur e shkel të zhytetet këmba'* ose *'një njeriu të paqëndrueshëm, të dobët, zemërlur'*.

Togfjalësha frazeologjike me gjymtyrë të përdorura në kuptimin e tyre të parmit nuk mund të gjejmë, ndërsa shprehjet frazeologjike me gjymtyrë të njëjtë në fjali të ndryshme mund të qëndrojnë dhe të funksionojnë së bashku dhe secila gjymtyrë ka rolin e saj sintaksor. Njësitë frazeologjike shqyrtohen edhe nga funksionimi i tyre si një njësi e vetme sintaksore, tipar ky që i bashkon me fjalën.

Na paska qënë një i pasur.

*Ama i pasur nga ata të mëdhenjtë, sa s'ta pret mendja as ty, as mua. **I kalbur në të mira e jo tjetër!** E ç'nuk na kish ky në botë! Qese me aspra sa t'i bëjë kalldrëm edhe prapë mos t'i sosen; ara vreshta e ullishta, sa s'ia shkelte dot këmba dy ditë bashkë; gjë të gjallë si zgjoi i bletës. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.216)*

*Ajo shikonte Asimin që hynte e dilte dhe e dashuroi. E si të mos e dashuronte Asimin? Syzi e vetullzi, flokëzi, me dhëmbë të bardhë dhe **me fjalë të ëmbël** si tërë ëmbëlsia e fytyrës së tij, e cila shprehte po atë besim, guxim e njerëzi që shprehin fytyrat e revolucionarëve të përvuajtur. Gori e njihte mirë Asimin. Ishte shumë i mbyllur. Nuk para fliste. **E çelte gojën shumë rrallë**, si malësorët tanë. Sanija e shkretë, pak herë kishte folur me Asimin. (Petro Marko, Vepra letrare 3, fq 21)*

2. 2. Idiomatika si tipar themelor i formësimit dhe figurshmëria (tropet)

Idiomatika është tipari themelor që dallon togfjalëshat e lirë nga togfjalëshat frazeologjike.

Në themel të këtij kalimi, pra nga togfjalësh i lirë në frazeologjik, qëndrojnë disa trope si

metafora, krahasimi, hiperbola, eufemizmi, personifikimi, etj. të cilat na ndihmojnë të krijojmë një ide, mendim a imazh konceptor në lidhje me shprehjet frazeologjike të dhëna me të zeza në shembujt e mëposhtëm të shkëputura nga letërsia artistike. (*Tropos* nga greqishtja dhe *tropus* nga latinishtja do të thotë drejtim. Drejtimi ose shmangia e një shprehjeje nga kuptimi i saj i parë drejt një kuptimi tjetër)

Si mund të shpjegohej mungesa e tet në një rast të tillë? Mos vallë njeriu me mushama ishte vëllai, kunati apo ndonjë nga ata njerëz të afërm, të rrahur me vaj e me uthull që janë të vetmit për të përballuar me gjakftohtësi ato çaste të brishta kur të tjerët humbin mendjen? Jo, s' duhej të qe njeri i afërt, përndryshe, llafazan siç ishte, do t'ia kishte thënë. Ishte një hamendje që përhapte një cipë misteri në tërë atë që po ndodhte, por tani ishte tepër vonë për ta shkoqitur. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq.237)

Afër mendsh! As qeveria s'ka kohë të merret me ty e me mua, se ka halle e telashe të mëdha...Kështu duket po ta shohësh nga larg, s'them jo! Po Ceni sheh hollë e vret mendjen e s'e ha bukën kot. Pse, budalla isha unë që dorëzova çelësat e mejhanes e s'bëra naze fare? (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq.104)

I kunati i Xhelos u drodh i tëri. Ai e kujtoi edhe këtë radhë fallin që i kishte hedhur Zylfija. “Do të vrasësh një njeri. Po s'e vrave atë, nuk do të kesh qetësi në shpirt.” Sytë i lëshuan miza dhe veshët i buçitën si të qëndronte përballë një përroi të madh. (Dritëro Agolli, Dështaku, fq.201)

Në të vërtetë, kryetari vazhdonte të sillej me të njëjtën prirje të mirë, madje, meqë punët... i drejtonte Nuroja kishin mbetur ashtu në mes as mish as peshk, kjo sjellje mund

të quhej dashamirëse. Ajo i përngjiste butësisë së mësuesit ndaj nxënësit të dikurshëm kanakar, të i cili nuk i humbiste besimi asnjëherë. Prisni, një ditë ai do ta tregojë veten...
(Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 280)

*Atëherë, i hodhi një sy kasolles, sikur të kërkonte të kapej gjëkundi për të hapur muhabet e pastaj duke parë nga djeparaku që e kishte pritur i pari në shtëpi e që e kishte habitur **me atë gojën** e tij **brisk** , pyeti:*

- Tek na, oj nanë, as shtojzovalleve, që lindin me gojë, s'iu vjen gjuha aqi herët sa i ka ardhë ktij çunit tuej... (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, fq.159)

2.2.1 Metafora dhe Krahاسimi

Metafora

Metafora përftohet duke e përdorur një fjalë ose një togfjalësh në një lidhje të re, nëpërmjet të cilit fitojmë kuptim të figurshëm ose një informacion më të madh kuptimor. Madje metafora është vlerësuar si një krahasim i shkurtuar që tregon gjendje a objekt dhe ka raport ngjashmërie me të parin psh; me këmbët si lepur (krahasim) dhe këmbë- lepur (metaforë). “Mjaft prej njësive frazeologjike kanë edhe histori që mund të shpjegojë origjinën e kuptimit dhe të përdorimit të tyre dhe të gjejmë kuptimin metaforik të një njësie frazeologjike nuk e kemi të vështirë po të njohim ecurinë e zhvillimit të saj”²⁷. (Në tekstet e letërsisë metafora përkufizohet si krahasim pa lidhëzën si). Ndër figurat letrare më të

²⁷ Vora. R. “Njësitë frazeologjike me vlerë foljore në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze” fq. 14

përmendura në gjetjen e origjinës së njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore janë krahasimi dhe metafora. Metafora përkufizohet si mjet me anë të të cilit fushat më abstrakte të përvojës mund të konceptohen me anë të atyre konkrete. Jo në të gjitha rastet realizohet motivimi i njësive frazeologjike me anë të metaforave konceptore. Shumë prej koncepteve tona lidhen me ndjenjat ose vlerësimet tona. Ato mund të mos përcaktohen nga një metaforë e vetme, por organizohen në skica metaforike lidhur me përvojat apo këndvështrimet e gjithsecilit psh; “*e ka zemrën flori*”, “*e ka zemrën det*”, “*e ka zemrën hazine*”, “*e ka zemrën hambar*”, “*e ka zemrën e bardhë*”, “*ka zemër të artë*”, “*e ka zemrën e gjerë*”, “*është zemërkatran*”, “*e ka zemrën e zezë*”, “*është zemrërpulë*” etj.

Kuptimet e figurshme të njësive frazeologjike mund të motivohen nga njohuritë konceptore që kanë në bazë metaforën. Në themel të njësive frazeologjike mbiemërore qëndron kuptimi metaforik i cili realizohet në bazë të ngjashmërisë në njësitë frazeologjike psh. “*na ish bërë zemra mal*” ose sjellim këtu edhe një shembull në gjuhën angleze “*cut and mouse game*”.

Neve si t'ju them, na ish bërë zemra mal nga gazi, si vetëm ata që kanë ngrënë kurbet mund ta dinë. Kështuthi janë këto çastet e sajaxhiut: të vjen të qash e të këndosh nga gazi e pastaj ta puthesh nga malli i zemrës. E asaj mbrëmjeje ky usta Vani, që kish marrë lajmin se i dha zoti nip, e çdodhi qesen e vuri një mish në hell e bëri emër t'ia ziejmë gazit si në gosti të parë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 37-38)

*Oh, God! How had she ever lived without these gorgeous red dolls! She played the **cat-and-mouse game** with Tony for two more days. (Jacqueline Susann, Valley of the Dolls, fq. 211)*

*Ata krerët e tjerë si Blumi me shokët e tij, me këtë politike që ndjekin nuk tradhëtojnë vetëm popullin spanjoll, që mbron këtu liritë demokratike, po tradhëtojnë edhe popullin frëng dhe popujt e tjerë të botës. Fashizmi, që është lufta , do të mbetet **si peshku pa ujë**. Po duhet të kemi parasysh këtë: borgjezia , që i mban iso fashizmit , është burimi që ushqen fashizmin, kurse klasa punëtore dhe fshatarësia po të bashkohen dhe të sqarohen mirë, do të vijë koha që do të thonë: “ Të gjithë ata që s’duan paqen dhe lirinë janë armiq të njerëzisë”. (Petro Marko, Vepra letrare 3, fq. 104)*

*The was enraged. ‘Where have you been!’ ‘I want to a movie between shows’. She deliberately **made it sound like a lie**. ‘Oh sure! And tonight? You sure must have lit out of there fast!’ ‘ I was there. The doorman must have made a mistake’ (Jacqueline Susann, Valley of the Dolls, fq.210)*

Njësitë frazeologjike motivohen edhe nga metafora të ndryshme konceptore, prandaj, një mënyrë për të zbuluar njohuritë metaforike është nëpërmjet studimit të ngushtë të imazheve mendore që krijojnë njerëzit për njësitë frazeologjike. Mund të formohen imazhe për një njësi të caktuar frazeologjike, kuptimi i së cilës ka bazë metaforike. Kështu, njësia frazeologjike “ *chicken as the wet* ” - “*si pulë e lagur*” është një prej tyre. Për të krijuar një imazh mendor të saj u përgjigjemi disa pyetjeve:

- *Përse e krahason me pulën?*
- *Ku ishte pula?*
- *Kush e lagu pulën?*
- *Si rri pula kur laget?*

- *A rri fajtori si pula e lagur?*

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve arrijmë të kuptojmë lidhjen e shprehjes frazeologjike me vlerë mbiemërore, me trajtën krahasimore dhe me bazë metaforike, pra kuptimin e figurshëm të njësisë frazeologjike. Ka edhe raste kur është e vështirë të përcaktojmë *fushat burimore* ose *fushat objektore*²⁸ (*bota konkrete, reale dhe bota e imagjinare, ireale*) të njësisë frazeologjike ose edhe metaforën konceptore që bën të mundur lidhjen mes tyre. Në rastet kur nuk mund të njihet origjina e njësisë frazeologjike, kjo mund të konsiderohet si pikë e dobët e teorisë konjitive, si në këtë njësi frazeologjike; *“i rrahur me vaj e me uthull”*. Ndonjëherë njësitë frazeologjike mund të lidhen edhe mes krahasimit të gjymtyrëve të njësisë frazeologjike.

2.2.2 Krahasimi

Krahasimi është tepër i zakonshëm në përdorimet e shprehjeve frazeologjike me vlerë mbiemërore në gjuhën dhe letërsinë shqipe. Përmes tij jepet përqasja ose përafrimi mes dy imazheve, gjendjeve, veprimeve ose objekteve me ndihmën e pjesëzave; *si, njëlloj si, ashtu si, sikur* etj. Madje nëpërmjet krahasimit realizohen më tepër njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore se në njësitë e tjera frazeologjike.

Ideja e krahasimit për formimin e njësive frazeologjike të tilla është baza semantike. Njësitë frazeologjike që shprehen me anë të krahasimit janë të lehta për t’u kuptuar,

²⁸ Shih Cacciari, C. (1993): The place of idioms in a literal and memorphorical word, tek C. Cacciari & P. Tabossi, “Idioms: Processing, structure and interpretation” Hillsdale, Nj: Lawrence Erlbaum, fq. 32, vep. e cituar nga Vora, R.

sepse ideja e krahasimit është më e qartë për shkak se ngrihet mbi bazën e ngjashmërisë psh: “ *si telajo e vjetër*”, “*si shi me breshër*”, “ *si ujku plak*”, “*si qengj manar*”, “ *si minë me sahat*”, “*si peshku pa ujë*” etj.

J.Thomai (1981: 34) pohon se: “*Prania ose mungesa e lidhëzës krahasuese “si” është shenjë dalluese për trajtimin e një togu fjalësh si njësi frazeologjike apo si togfjalësh i lirë*” në gjuhën shqipe.

Njësia frazeologjike që mbështetet në idenë e krahasimit, nuk parakupton që në gjuhë të ketë qënë patjetër më parë një strukturë me lidhëzën krahasuese të shprehur materialisht. Në togfjalëshat e tillë që janë shtyrë më tepër si frazeologjizma dhe janë ngurosur, kanë fituar një karakter idiomatik dhe kanë si pikënisje të temës së tyre një tipar edhe më të abstraguar të sendit, që shërben për të bërë krahasimin.

*Ata krerët e tjerë si Blumi me shokët e tij, me këtë politike që ndjekin nuk tradhëtojnë vetëm popullin spanjoll, që mbron këtu liritë demokratike, po tradhëtojnë edhe popullin frëng dhe popujt e tjerë të botës. Fashizmi, që është lufta, do të mbetet **si peshku pa ujë** . Po duhet të kemi parasysh këtë: borgjezia, që i mban iso fashizmit, është burimi që ushqen fashizmin, kurse klasa punëtore dhe fshatarësia po të bashkohen dhe të sqarohen mirë, do të vijë koha që do të thonë: “ Të gjithë ata që s’duan paqen dhe lirinë janë armiq të njerëzisë”. (Petro Marko, Vepra letrare 3, fq. 104)*

*Pastaj kriza kaloi dhe ne u bëmë me qejf. Qejfi vjen **si lumi kur bien shira të mëdha** në male. Lumi atëherë hipën mbi brigje dhe merr tatëpjetën fushore. Shiu-konjak ra në*

stomakët tanë dhe qejfi doli nga brigjet-gjokse e vërshoi. (Dritëro Agolli, Vepra letrare 3, fq.234)

... Ai po kalonte një gjendje midis frikës dhe turbullimit që të jep puthja e një qënieje që pikërisht kur je pranë saj je më larg se kurrë. Gruaja e largoi vështrimin dhe tundi flokët e gjatë. Kjo frazë kishte mbetur në trurin e tij e vetme, **si një kaktus në shkretëtirë**. Simoni ndjeu një zbrazëti të bëftë në tërë qënien e tij. (Nasi Lera, Nata e Premierës, fq.47)

Angjo Beshoja hyri duke bredhur shikimin tek të gjithë. Ishte hera e parë që po i ndodhte një gjë e tillë dhe, sado që **njihej si kokëderr**, prapë provonte një hutim si para provimeve. Duroja u ngrit prapë me atë pozën konferenciale që e trulloste skulptorin... (Teodor Laço , Zemërimi i një njeriu të urtë , fq. 178)

Megjithatë, plaka i futej në sy, zëri i saj i fliste në vesh , ai harronte e këmbente me të ndonjë fjalë majë pajtonit, apo para se ta mbërthente gjumi në shtrat: “ Koli, për vete njeriu bën si bën! Por mendo për fëmijët! Hyr në punë të qeverisë, mos u bëj **i egër si ariu**, që jeton vetëm në pyll...” (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 171)

Ata u afruan e ndenjën në këmbë **si pesë qiparisa**. Jerma nuk lëvizi nga vendi. U hodhi një sy dhe i pa si kapadainj; njëri me duar në xhepa, tjetri me xhaketën në krah, tjetri me duart pas e tjetri **me festën mbi sy**. (Petro Marko, Vepra letrare, 3 fq. 446)

Përdorimin e lidhëzës krahasuese si e vëmë re edhe në gjuhën angleze. Edhe në njësitë frazeologjike në gjuhën angleze ashtu si në shqipe është e pranishme lidhëza krahasuese. Zakonisht njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore me lidhëza janë të formuara kështu:

Like + as + NP (*like* (lidhëza krahasuese ‘si’ + as) + emër

Like + P + as + NP (like (lidhëza krahasuese ‘si’ + përemër + as) + emër

*They hadn’t tampered with her natural beauty, yet somehow they had succeeded in heightening it. Before, it used to creep up on you. Now you noticed it immediately. She wore eye makeup and her hair was fuller, **like a lion’s** mane. (Jacqueline Susann, Valley of the Dolls, fq.261)*

*She stood on the bow, looking into the distance, holding Garret’s hand. “Will we ever go?” she asked him gently, and it was that vision of her he always remembered: her hair billowing in the wind, her expression radiant and hopeful, **like that of an angel**. “Yes”, he promised her, “as soon as we have the time”. (Nicholas Sparks, Message in a Bottle, fq.343)*

Në gjuhën shqipe jo gjithmonë është e pranishme lidhëza krahasuese në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore dhe në rastet kur mungon funksionin e saj e luan një gjymtyrë krahasimi që i shërben gjymtyrës së parë. Në këtë mënyrë togfjalëshi kthehet në një tog të lirë fjalësh. Psh:

...kurrë nuk lejonte të hidheshin fjalët në erë. Nuk lejonte as hallakatje, as kotësi, as mburrje nën emrin e një tjetri...

*- Jo ,- tha Kleopatra. – Araniti **është shumë i zoti** dhe ka personalitet...Unë desha të thosha...*

- Ai është burrë! – e ndërpreu Zaim Avazi.

Unë e kuptoja përse bëheshin këto ndërhyrje. Ata ia kishin frikën Aranitit dhe donin të flisnin fjalë të mira për të. (Dritëro Agolli, Vepra letrare 6 , fq. 215)

është shumë i zoti

V (elementi foljor) + N (elementi jofoljor - përemër i pacaktuar + mbiemër) = Kf
(kuptimin frazeologjik) (njësimi semantik është i brendshëm)

*Sytë i qenë tharë tanimë. Edhe **zemra i qe bërë eshkë** . As që deshi ta lexonte edhe një herë atë letër. I hodhi një sy dhe përshtypja se po shikonte një letër të shkruajtur me hieroglife, siç i qe dukur aty me parë, nga mizëllimet e syve, i qe zhdukur bashkë me lotët.*
(Jakov Xoxa, *Juga e bardhë*, fq. 193)

zemra i qe bërë (si) eshkë :

(emri + elementi foljor) + lidhëza + emri (elementi jofoljor) = kuptimi i togfjalëshit

(në këtë rast njësimi semantik është i jashtëm)

Në disa njësi frazeologjike kuptimi përforcohet më shumë me idenë e krahasimit duke qenë të pranishme lidhëzat krahasuese, si në shembujt e mëposhtëm.

*Kur kishte dalë nga vatha , gjithë fshati ishte rrudhur aty. E kishin parë me kërrabë në dorë dhe kokëulur, **si doreza e kërrabës**, dhe e kishin kuptuar. Dhe të gjithë kishin ulur kryet, **si dorezat e kërrabave** që mbanin nër duar dhe asnjëri nuk i kishte thënë gjysmë fjale.* (Jakov Xoxa, *Juga e bardhë*, fq. 112)

*Të grynjtat e Dynjasë, Kedhit, Marinit i ndante nga ato të Shpiragajve dhe kosovarëve një rrip are, kallameja e xha Llazit, që shtrihej në mes të tyre **si brez geqe**. Atje rrëzë një ftoi , ishin mbledhur të hanin darkë, pas pune , e re e vjehërr. Nusja po konte çunin, që të hante pastaj vetë një kafshatë bukë rehat, ndërsa të vjehërrit nuk i pritej dhe po thërmonte një thembër misërnike mbi kupën e dhallës.*(Jakov Xoxa, *Lumi i vdekur*, fq. 519)

- *Më falni, po si t'ia bëj? Të mbyllësh zyrën e të hash jashtë , fillojnë e gumëzhijnë si bleta kur roit. Dhe me të drejtë! Ja ashtu m'u bë zakon, e thyej urinë me një byrek. E dini ditët e para sikur më zinte në kurriz, po tani u mësova. Mësohet njeriu apo jo? (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 192)*

*Këndoi: “Këtë krua e ka hapur ago Jakupi. Edhe zoti ia shkrojti ndër të mira”. Kish frikë se mos ish ëndërr, prandaj zgjati dorën në ujë – rridhte një ujë i ftohtë e i kulluar, edhe piu për së dyti e së treti. Pastaj u zgjua. Endërr pat qenë , po ëndërr e mirë, **sa i rrihte zemra nga gazi.** (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 64)*

*Nuk...nuk mund të thyhet një urdhër vetëm sepse ty vazhdimisht të shkrepin në kokë dyshime. Sidoqë të jetë, ai Azem Shkoza qenka përlyer keq në këtë histori **sa nuk e lan dot lumë e përrua.***

- Do të bëj çmos të kthehem. Po edhe në mos ardhç dot... shkarkojë mbi mua gjithë barrën! – tha Roland Rali. (Teodor Laço , Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 262)

*Një e dy dhe e shante **si zemërpulë** , si të pazotin për të rritur çifliqet, siç i kishin rritur dy të parët. Ajo vrau, me egërsinë e saj, të birin, jo pastaj djalin e bujkut, djalin tim, hyzmeqarin. Njëpër duart e saj u lashtua ai, i vogli i nënës. Dhe si u lashtua pa!... Që maherë djali më mbeti ulok. I doli ana, nga puna e rëndë, në arë, në konakët. Zemra iu lashtua shpejt, trupi i mbeti kërthi, si ai mistri bitërr.(Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq. 405)*

2.2.3. Metonimia

Jo në pak raste ndeshim edhe njësi frazeologjike me bazë metoniminë të tipit: “*me djersën e ballit*”, “*të merr gjak në vetull*”, “*më mbajnë shpatullat (krahët e mi) e mia*”, “*lufton për kafshatën e gojës*”, etj. Metonimia është zëvendësimi i një i një termi që ka lidhje vazhdimësie me të parin.

*E pushtoi ai dyshim që e pati edhe në zyrë. Bëri mbledhjen e asamblesë për ta shkarkuar. Nuroja bëri autokritikë. “Do t’i laj gabimet **me djersën e ballit**”- tha. Murat Stojkut i erdhi t’i vërviste ndonjë nga ato shprehjet që i mbante në majë të gjuhës...(Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 301)*

Metonimia vendos lidhjet midis elementeve të një strukture të dhënë konceptore që zakonisht lidhet me pjesë të trupit të njeriut: sy, vesh, **ballë**, krahë, zemër, mendje, faqe, kokë etj. Karakteri i njësisë frazeologjike mund të lidhet edhe mes krahasimit të gjymtyrëve të njësisë frazeologjike.

*Po të deshim, mund të shkonim edhe në Amerikë të Zezë apo në Vllahi, se për ne, atëkohë, të gjitha mërgimet ishin aty afër, pothuaj në der’ e shtëpisë, mbi mulli a nën mulli ose shumë - shumë buzë liqerit: këtu Vllahia, atje Amerika (e Bardha , e Zeza), po neve **na qe mbushur mendja** për në Amerikë. “Vllahia e vllahinkave u bë batall që kur doli Amerika, se i ra parja e iu bë kartë me lule, me gogozhelë” kish thënë Trifun Kasapi, dhe ne e kishim vënë në xhep ligjëratën e tij. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 238)*

*...Petrika Kaleshi këtej nga Komiteti Ekzekutiv më shkruante një pusullkë se ti **ke qënë pa qejf**. Pastaj edhe Pandi më tregoi për ty. Ishte shumë i shqetësuar. Më tha se kishte rënë në një gropë me baltë . Më tregoi edhe për një ngjarje me bagëtitë e fshatit. Në rrethin tuaj ai ndjek një çështje të ngatërruar.(Dritëro Agolli, Dështaku, fq.129)*

*Rrugës Xhelo Mara nuk priti makinë dhe shkoi në qytet me kalë. E zbriti në kopshtin e ndërtesës së Komitetit Ekzekutiv, e lidhi pas një peme, e përkëdheli me dorë në qafë dhe u ngjiti në zyrën e Feti Kalasë. Me ta parë **nuk u besoi syve** të tij. (Dritëro Agolli, Dështaku, fq. 65)*

*Një sallë që po e shqyente tani si ulkonja drerin e kapur në befasi. Më thirrën të dilja në skenë i rrëfeu ai, se aty qenë vendosur tryezat e presidiumit. Tamara e përfytyroi tek rrinte më këmbë, i gjatë, **me krenarinë që i buronte dhe nga rrobat**, gjysëm i kthyer nga salla e gjysëm nga presidiumi. Dritat e projektorëve e ndriçuan përnjëherësh dhe ai u duk se po luante një rol. (Diana Çuli,...Dhe nata u nda në mes...fq.148)*

*Fytyra e kryetarit u bë fare shpërfillëse. I iku zemërimi, mllëfi, inati . Nuroja po i dilte ndyrësirë. U bind qëkurse e pa se me sa ngut gënjeu për atë çështjen e vjehrrit. Gënjeshtrën e nuhaste që atje tej. “Hm...**ma vuri zemrën në pëllëmbë**, pizevengu, po këtë pyetje nuk e priste dhe u trullos,s’pati kohë të sajonte taktikn”, mendoj. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 300)*

Në njësitë frazeologjike pasqyrohet lidhja që ekziston mes botës reale dhe ato shënojnë kuptimet që lidhen me botën që na rrethon. Përgjithësisht lidhja në metonimitë që përfshijnë sende dhe vende dhe janë të lidhura me kulturën e një vendi. Njësia frazeologjike në gjuhën shqipe “*frikë nga hija e tyre*” dhe në anglishte “*afraid of their shadows*” shpreh një lidhje të natyrshme si në anglishte edhe në gjuhën shqipe.

*‘... A couple of kids from up North. Just couldn’t wait to visit death row and flash their badges and meet a real live Klan terrorist. They were so damned scared they were **afraid of their shadows**. They asked me stupid questions for hour, then left. Never heard from anybody again’. (John Grisham, The Chamber, fq. 171)*

Edhe metonimia ashtu si metafora, është konsideruar nga mjaft gjuhëtarë si thyerje e rregullave gjuhësore dhe të dy mekanizmat janë studiuar të ndara. Zakonisht gjatë ligjërimit bëhet lidhja mes gjymtyrëve të njësisë frazeologjike dhe të kuptimit të tyre frazeologjik edhe kur origjina e njësisë frazeologjike është e paqartë.

2.2.4. Hiperbola

Jo rrallë njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë një karakter hiperbolik domethënë të zmadhimit me anë të fjalëve një veprim, një dukuri, një gjendje a një send psh:

*...Që atë ditë që më le vetëm, në derën e teknikumit, kam filluar të mendoj përgjigjen. Sot, me fjalën tënde troç, më lehtësove. Shpresa u nxi, **sikur ta kishte qëlluar rrufeja**.*

-Nga një çoban në bujk, nuk e pata aq të vështirë... (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq180)

*Ra një re nga qielli, e ngriti gjarprin dhe e hodhi në malin Bigë që çohet mbi orman. Si ra gjarpri atje, zuri e hante kafshë e njerëz e çdo gjë që gjente. Pastaj u mbloodhë gjithë Kallamgjata e gjithë krahina e thanë: “Si t’ia bëjmë kësaj lubie që s’na lë të rrojmë, që na ha kafshët edhe na i prish të mbjellat, që kur vërshëllen **na fut frikën në kockë?**” . Ashtu gjithkush tha fjalën e tij... (Dritëro Agolli, Dështaku, fq. 94)*

...Po gishti i tij tregues , shtrirë horizontalisht, i bëri Yllit përshtypje komike, sikur ja shtylla ishte me të rrëzuar dhe kryetari po përpiqej ta mbante. I erdhi për të qeshur.

*- **Si shiu me erë erdhi** dhe **si era me shi iku** dhe na la ne këtu, të mbajmë sehir shtyllën gjersa të bjerë...,- tha zha Trifoni , pa lëshuar belin nga duart. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq. 206)*

*Neve si t’ju them, **na ish bërë zemra mal** nga gazi, si vetëm ata që kanë ngrënë kurbet mund ta dinë. Kështuthi janë këto çastet e sajaxhiut: të vjen të qash e të këndosh nga gazi e pastaj ta puthesh nga malli i zemrës. E asaj mbrëmjeje ky usta Vani, që kish marrë lajmin se i dha zoti nip, e çdrodhi qesen e vuri një mish në hell e bëri emër t’ia ziejmë gazit si në gosti të parë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 37-38)*

Në këto njësi frazeologjike me karakter hiperbolik, shpesh përdoret edhe lidhëza krahasuese. Ato vërtetojnë se kuptimi i tyre nuk nxirret nga përbërësit, por nga konteksti ligjërimit.

Ai ishte ende i squllur dhe i djersitur nga lodhja. Por në qënien e tij ndiheshin një kënaqësi e madhe dhe një lumturi e hapur.

- Rrija me zemër (si) të ngrirë. Thosha me vete: “Si do të pritet raporti i Zylos?” Por bukur, bukur,- i tha Adila burrit.

Të tre ne ecnim në rrugë. Fliste vetëm ajo. Nga fjalët e saj më gumëzhinin veshët. (Dritëro Agolli, Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, fq. 20)

- Pusho ti bizbique, se s’është axhami si ti as zoti, as yt atë! – dhe rrëmbeu me dorë të mëngjër një vandak e ngriti lart, sikur donte t’i tregonte botës se “perëndia e di ç’bën”.

-Ha...ha...ha... me ç’ia paska bërë paq qerratait! – bërtiste me gjithë zemër Koz Dynjaja, atje tek u binte me majën e draprit kapëzave, për të vështruar mos ishte futur ndonjë nëpërkë. (Jakov Xoxa, Lumi i Vdekur, fq. 515.)

*Nuk...nuk mund të thyhet një urdhër vetëm sepse ty vazhdimisht të shkrepin në kokë dyshime. Sidoqë të jetë, ai Azem Shkoza qenka përlyer keq në këtë histori **sa nuk e lan dot lumë e përdua.***

- Do të bëj çmos të kthehem. Po edhe në mos ardhç dot... shkarkojë mbi mua gjithë barrën! – tha Roland Rali. (Teodor Laço , Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 262)

2.2.5. Personifikimi

Mjaft njësi frazeologjike përmbajnë edhe personifikimin si një figurë e rëndësishme, e cila gjen përdorim më të shpeshtë. Personifikimi dallohet lehtë se është një njësi frazeologjike e cila ka të pranishëm një emër që emërton kafshë, shpendë ose insekte. “Këto njësi

frazeologjike janë të lidhura ngushtësisht me kulturën e një vendi, prandaj mund të mos ketë përkime mes gjuhëve të ndryshme” (Vora. R. 2012 :21)

...Le që ne shqiptarët s’jemi fetarë.I kemi ndërruar fetë si sulltani gratë. Feja duhet.Si ka thënë Volteri...Universiteti vlonte **si koshere bletësh**. Studentët shkonin në leksion, por më tepër se me mësim merreshin me diskutime politike. (Diana Çuli, ...Dhe nata u nda në mes... fq.191)

E ç’nuk na kish ky në botë! Qese me aspra sa t’i bëjë kalldrëm edhe prapë mos t’i sosën; ara vreshta e ullishta, sa s’ia shkelte dot këmba dy ditë bashkë; gjë të gjallë **si zgjoi i bletës**. Veç asprave të shumta, veç arave e vreshtave e veç gjësë së gjallë, m’i kish hambarët gjithmonë rëngë me drithë (sa mend çaheshin); kadet me shkallë, plot (gjer në majë) butet si gra me barrë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.216)

Domethënë Spartak Papagjoni nuk i trembej së ardhmes se **kishte qënë peshk i vogël**... I pat shërbyer ca kohë maskarai, deri andej nga fundi i janarit, pastaj e drodhi e nuk dha informacione dhe Mentar Tyta nuk i kishte tanimë aq të sakta bisedat e brendshme e të fshehtat e udhëheqësve opozitarë. (Diana Çuli, ...Dhe nata u nda në mes... fq.277)

Me drojtje erdhë ata, po gjithë erdhë. Shtegun e kaptuan vetë.- Ti, - i tha agai atij të madhit, - ec e merr një shportë të ta mbush me rrush. Dhe djali **këmbë-lepur** iu shtrua rrugës. Dum-dum-dum, bënin këmbët e tij të zbathura. Agai nxori thikën e zu të zgjedhë rrush të pjekur. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.60-61)

Bëj hesap kur edhe në fshatin tim ca ftujakëve u është bërë goja kamare dhe kërcejnë nëpër mbledhje **si kërrja para gomarit** e më të japin mendje e më të mprehen me më të mëdhenjtë . Majë gjuhe e kanë fjalën “unë s’jam dakort...” (Teodor Laço , Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 122)

*...Katër u vranë në luftë, i pesti... Frëngu vari kokën, fshiu sytë. “Ç’u bë i pesti?, - pyeti Rrapua. – A mos i thoshin Bitri? Atëherë frëngu u hodh **si kaposh**, i vuri duart mbi sup Rrapos “Ku ma di ti Bitrin e Pjetrit?” Edhe Rrapua vuri duart mbi supet. U shikuan të dy sy në sy. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.138)*

2.2.6. Eufemizmi

Eufemizmi është ajo figurë letrare me anë të secilës zbutet një shprehje e vrazhdë ose tabu’. Mjaft njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë karakter eufimistik psh:

*Si e kish zënë të thënë, ashtu edhe të rrojturit : si mos o zot! Qeni rronte më mirë, sepse **qeni s’kish zemrën e të zot!***

*- Ah, un’ i mjeri , - thosh (se fliste vete, me zë) – ah, un’ i mjeri **do vdes për bukë!** Ja, shiko, grunjat e fqinjit sa të plota janë! Pa shiko gjën’ e gjallë...Edhe kështu mër-mër-mër nat’ e ditë qante sytë e këmbët, në vend që **të hajë me lugë floriri**. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.217)*

*Natën, kur gjithë bota flinte – qetë me bark, njerëzit me shpinë edhe gjarpri kutullaç – ngrihej e u binte rreth e përqark shtëpive, hambarëve, qilarëve...- të ruajë mos i vjedhin gjënë. Binte të flejë e s’e merrte gjumi, se **i rëndonte ari edhe argjendi në mendje e në zemër**. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 217)*

Edhe në gjuhën angleze eufemizmi është një figurë letrare që përdoret shpesh edhe në letërsinë artistike, psh;

*Friday Harbor in the San Juan Islands was a ninety-minute boat ride from Anacortes in Washington State. It may as well have been **the back side of the moon**. The small and the town was smaller.*

(Steve Martini, Critical mass, fq. 15)

2.3. Tipare të njësisë frazeologjike me vlerë mbiemërore

(dallimet dhe ngjashmëritë me fjalën)

Njësitë frazeologjike ashtu si fjalët përdoren si njësi të gatshme në ligjërim dhe shfaqin funksionin e tyre shënues. Tipari kryesor që dallon njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore nga fjala është struktura dhe semantika e saj e veçantë, ndërsa togfjalëshi i lirë duhet patjetër të jetë i përbërë të paktën nga dy fjalë emërtuese, që të bëhet (njësi frazeologjike) ose togfjalësh i qëndrueshëm.

Njësia frazeologjike dallohet nga sepse njësia frazeologjike është togfjalësh dhe si e tillë, ajo bashkohet me fjalën për nga kuptimi. Njësitë frazeologjike dallojnë nga fjalët që nga ndërtimi i tyre. Kështu e përmendëm më lart se njësia frazeologjike ngjason më tepër me togfjalëshin e lirë. Psh:

Dru i shtrembër – si togfjalësh i lirë këtu ka kuptimin e drejtpërdrejtë .

është dru i shtrembër – si njësi frazeologjike këtu ka kuptimin e njeriut të prapë, të pandreqshëm.

*Kasaphanë e shkuar kasaphane! Kudo që shkelje: gjak, armë e shapkë e gjallë. Kam parë me sytë e mi një bullgar sa një katallan, cingël i zi , i thatë **si i ushqyer me miza**, që na u lëshua syngjytak, nga e djathta, kur aty përpara yxhym! Të tjerë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.14)*

Në shembullin e mësipërm njësia frazeologjike “*si i ushqyer me miza*” mbart kuptim të figurshëm dhe do të thotë ‘shumë, shumë i dobët, hollak’. (Kjo njësi sjell një koncept të personalizuar në lidhje me personazhin). Gjymtyrët e kësaj njësie frazeologjike janë njësi të pavarura në leksikun e shqipes, por marrin vlerë vetëm kur lidhen me njëra – tjetrën.

Kur e panë ago Jakupin, të dy ikën si ik lepuri dhe qëndruan më tej të vështrojnë ç'bëhet. I treti nuk mundi të ikë se kish një gjemb në këmbët. Agai e **kish hijen e rëndë** dhe kjo hij' e tij ruante vreshtat. Fëmija zuri të lotojë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 60)

Zbritën pastaj krua më krua, ajazmë më ajazmë , hije më hije, ishin të lumtur fort edhe i **kishin zemrat të mbushura me aq gaz** , sa kurrë s'i shkonte ndër mend se do ketë ky njeri. I vajti mendja një grimë për bagëti e stane , si në botën e të gjallëve dhe, nameta u gjend në pyje të veshura e që atje në ca stane bukuri e madhe... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare , fq. 232)

Këndoi: "Këtë krua e ka hapur ago Jakupi. Edhe zoti ia shkrojti ndër të mira". Kish frikë se mos ish ëndërr, prandaj zgjati dorën në ujë – rridhte një ujë i ftohtë e i kulluar, edhe piu për së dyti e së treti. Pastaj u zgjua. Endërr pat qenë , po ëndërr e mirë, **sa i rrihte zemra nga gazi**. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 64)

Një e dy dhe e shante **si zemërpulë**, si të pazotin për të rritur çifliqet, siç i kishin rritur dy të parët. Ajo vrau, me egërsinë e saj, të birin, jo pastaj djalin e bujkut, djalin tim, hyzmeqarin. Njëpër duart e saj u lashtua ai, i vogli i nënës . Dhe si u lashtu pa!... Që maherë djali më mbeti ulok. I doli ana, nga puna e rëndë, në arë, në konakët. **Zemra iu lashtua** shpejt, trupi i mbeti kërthi, si ai mistri bitërr. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq. 405)

Njësitë frazeologjike dallojnë edhe nga theksi, sepse njësitë frazeologjike kanë aq thekse sa fjalë shënuese kanë, pra ato mund të jenë njësi frazeologjike njëgjymtyrëshe ose shumë gjymtyrëshe. Kriteri theksor afron njësinë frazeologjike me fjalën e përbërë. Edhe fjala e përbërë ka dy theksa, por dallimi qëndron tek intonacioni, sepse mund të jetë më i rrafshët tek fjalët e përbëra dhe më ngjites në njësinë frazeologjike. Edhe në njësitë frazeologjike

përcillet një koncept i vetëm ashtu si në fjalët e përngjitura edhe në ato të përbëra. Njësitë frazeologjike kanë strukturë të hapur si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe.

*Hi, i read your letters to Catherine, and knowing how much you loved her, I just thought you might be the man I've been looking for. No, that was **out of the question**, and the other option didn't seem much beter – Hi, I'm from the Boston Times and I found your letters. Could we do a story on you? That didn't seem right, either. Nor did any of the other ideas that filtered through her mind. (Nicholas Sparks, Message in a bottle, fq. 88)*

*...his hat held tight in his left hand which rested in his lip; his right arm, **with a rugged propriety and force of action** , very earnestly emphasizing what he said ; not least so when so when it always paused, a little bent , but not withdrawn, as he paused.*

(Charles Dickens , Hard Times , fq. 80)

*- Ta mbani ju gojën , se me ç'të drejtë m'i bëni këto pyetje? Kush jeni ju?- i tha Xhemali dhe s'foli më . Oficeri **i ndezur nga zemërimi** e nxori përjashta me të shara. Aty në një oborr të mbyllur, ku e shpunë, gjeti me dhjetëra luftëtarë të tjerë. Porsa e panë , e rrethuan dhe e pyetën se nga ç'front vinte. Po s'pati kohë të fliste me ta , se në oborr u fut oficeri me disa policë e me disa civile.(Petro Marko, Vepra letrare 3, fq. 429)*

*Megjithëse e kishte thirrur dhe e pati marrë me vete për të caktuar lëndinat më të mira për kuajt e për të zgjedhur sojin më të mirë nga kafshët e shalës që kishte shpërndarë andej – këndeje e megjithëse Xoxi pati mbetur **me gojë hapur** nga ky plan , beu vazhdonte ta pyeste duke e detyruar tjetrin , sa herë hapte gojën për të pirë kafënë, ta mbyllte prapë, për t'iu përgjigjur : “Po, po, o bej!...”(Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, fq. 446-447)*

Rustem Elezi nuk përfaqëson një dukuri, por një individ...Eshtë individ ...Pra ti do të vazhdosh me ta? Po, do të vazhdoj me ta! ...Nuk e kupton se të gjithë njësoj janë

ndryshojnë vetëm ngjyrat? Jo, s'ë kupton ti, por mbytesh në një pikë ujë, si një femër që nuk sheh më lart se hunda jote...Unë? Po ti! Dhe që futur në dhomë pa ngrënë darkë.
(Diana Çuli, *Dhe nata u nda në mes...* fq. 283)

Ajo qëndronte në mes, këtej plakut, andej plaka. Mbante në pehër një çantë të zezë shkolle. Mbi të një copë letër. Ia dha stilolapsin plakës. Ajo vuri një firmë. Pastaj ia dha plakut, po ai se pse kundërshtonte. Ishte plak i mirë, i zgjuar, fliste rrallë e për mall. Ti do të thuash si e mora vesh që ishte i zgjuar kur s'ë hapte gojën. Po njihet njeriu, njihet. Nga sytë, nga një fjalë.(Teodor Laço, *Zemërimi i një njeriu të urtë*, fq. 253)

Njësitë frazeologjike ashtu si fjalët, në rastin tonë, mbiemrat, krijojnë sinonimi dhe antonimi me njësi të tjera frazeologjike. Ashtu siç hasim në shprehjet frazeologjike me kuptime të përafërta gjejmë plot raste të përdorimit edhe të njësive me vlerë antonimike: psh është për të nxjerrë sytë dhe nuk e nxjerr qimen nga qulli, me mend në kokë dhe me një dërrasë mangët etj. Shpeshherë rastet e antonimive formohen edhe nga pjesëzat mohuese 's' dhe 'nuk'. Këto pjesëza tek të parat përdoren me shpesh, ndërsa tek të dytat ndeshen më rrallë.

(frazologji sinonimike)

Ditën e Shëngjergjit dilte bota në gështenja, burra, gra-e fëmijë bashkë togje- togje, e hidhte ndonjë litar në degë të njomë për t'u kolovitur. E kur kolovitej, mbante mbi krye një degë peme e një gur, që të ish gjithmonë i gjelbër si dega, i fortë si guri. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 89)

Qime s'kish me të vërtet Qose dhaskali, po më të më kish një shkop prej thane, të tharë në diell, të rëndë si plumbi, të fortë si hekuri, që në skoli binte e në Çezm' e Silkës

dëgjohej. Edhe pas shkopit, gjurma – gjurmës, një e angullirë e një e lebetitur, aman-aman! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 105)

*E hidhu e kërce këta, burrë e grua, gjer ja, i bie dylbeni nga koka e fëmijës e më t'na del Selimi i Shaqos, **me ato mustaqe si të preshit**, bojë përçi.*

- A, mre! - thirri Dajë Osmëni vetë, - a mre, ky qenka burrë, mre!

(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 22)

*Me të mbyllur sytë , vinte e na pllakoste një hije e zezë, si plane,plumb e rëndë. Kur e kur ikte hija e vinte një burrë i gjatë **me ca mustaqe si fshesë** e na rrihte me një topuz thane. Sa ikte ky, na bëhej sikur vinte një tufë dhish të egra, të zeza, me një përç të madh në krye, na shkelnin e na shtypnin me thundra, ktheheshin prapë, gjersa na bënë dërmajë fare. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.153)*

- Nuk duam , aga, se na dhe rrush edhe ne do ta ruajmë ...

*-Dum- dum- dum, bënë çape në udhë edhe pastaj djali më i madh –**i kuq si prushi** – me një shportë në dorë, kaloi shtegun. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 61)*

*Bukë morëm në furrë , se babagjyshi e kish derën e zemrën të hapur për të gjithë.Qielli kaltërosh, si i përzier me hi. Uji i gjolit, i valë. Dhe ne **të nxehur si prushi**. Edhe sepse ish aq i valë uji, gazin e asaj dite nuk e harroj, gjer të më vihet plloça mbi një varr... Bën të ngryset e s'ngryset dot. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 172)*

(frazologji antonimike)

“Ç’kërkon vallë këtej?” I hodha një fjalë përse zgripi i Dados, që e kish shtëpinë derë më derë me atë papafingon e Nastos: ç’njeri ishte ky e ç’kërkonte. Ama Dadon e kishim sërë krushqie e nuk e nxirrte fjalën. “ Eshtë një , - tha , - që vjen për gur grije.” “Po ç’njeri

është?” “ **Eshtë** , - tha – **gjuhëtrashë** që ka kënduar **në skoli të gjuhëhollit.**” (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 145)

Maçoku nuk ish maçok i vërtetë, po djalë, me dy këmbë nga të fqinjërisë, si unë e ti(pastë hijen e tij!). I thosha Maçok, si gjithë fshati, se ish i lig **e kish një maçok të zi në shpirt.** Ja kaq të madh! Mbolla unë edhe të tjera degë, po as ato nuk i la Maçoku. Dhe pastaj hoqa dorë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 93)

Hej, o Babale , hej! Në ka ndonjë hidhërim në shpirt ky Tërfili i vogël që e përkëdhelje me duart e tua të punuara, ky hidhërim është se s'gjendet në botë një qiri kaq i madh për t'u ndezur atij **shpirtit tënd të bardhë,** që bënte qymyr të zi... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 185)

E që kur shkeli në fshat ky kapeziu e zhurmëmadhi Latin, pushuan gazet e nisën vreret. Jo vetëm vreret, po edhe helmet e vdekjet. Se **e kish të zi shpirtin** ky pipingo. Më të zi se këmisha që kish veshur. Dësh të na marrë gjuhën e foshnjave , bukën e fëmijëve, nderë e kombit edhe besën e pleqve.(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 113)

Të nesërmen kur mori vesh fshati çudinë, erdhi, me qefalie në krye, t'i lutet që t'i shpëtojë të gjithë nga minjtë. Edhe djali , që **ish zemërbardhë** , i shpëtoi nga minjtë sa ment u çmend bota nga gëzimi. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 99)

Në mjaft raste njësitë frazeologjike mbiemërore përdoren për të emërtuar tipare të njerëzve me ato të kafshëve ose shpendëve, në bazë krahasimore ose jo. Psh:

Kështu me Kiton, unë , kështu. E po dhe atij bruz i shkonte puna , megjithëse e kobisja. Kot e kanë që thonë ku kobit njeriu, shpifet miu... Kish plot ,shyqyr, krahë pune , bagëti, miqësi dhe vetë **ish i fortë si kau.** E po, për bukë goje s'do rrija unë te djali, de, se s'isha shërbëtore, si ato të parat. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq. 406)

... Nga bujk ,në traktorist ,nuk hidhem dot, jo se kanali është shumë i madh, po sepse shkaku , i cili duhej të më shtynte për ta bërë këtë më duket i ulët... Ishte Shpresa ajo që filloi të thellonte sytë.

- **S'jam lepurak** , që të kërkoj vrimë në qytet! Unë e shikoj jetën në dritë të syrit.
(Jakov Xoxa, Juga e bardhë, fq. 180)

Ai e dinte: po të kishte ikur nga fshati, nën presionin e sulmit dhe të ndërsimeve të kryetarit, kishte për ta humbur krejt besimin e xha Likos dhe të pirganasve. Shpeshherë njerëzit e këqinj **janë si qentë e dobët**: po ike të sulen më keq; po sulmove ia krisin me vrap. Ai kishte qëndruar... (Jakov Xoxa , Juga e bardhë, fq. 364)

U hodh menjëherë me këmbë në brekë e në këmishë, **rendi si lingua** sa ment i doli shpirti edhe, sa të mbyllësh e të hapësh sytë, ish ku duhej – mur pas muri, derë pas dere e kyç më kyç. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 218)

Mbase ty të kujtohet një thënie e të madhit Hegel për imituesin: “Natyra me madhështinë e saj **i ngjan një elefanti** , imituesi i saj **është si një krimb** që zvarriset prej elefantit.” Kjo thënie ka një kuptim të madh. Tregimi im ndofta nuk kishte vlera universale. Por imituesi im ka bërë një shkrim mjaft të rëndomtë. (Dritëro Agolli, Vepra letrare 6, fq.54)

...U shtri në shtrat **me sytë dhelpërakë**, të Papagjonit nëpër mure. Sy të shpëlarë, kokërrdhokë të dalë si vezë syza, **surrat miu**. I kam ruajtur spiunllëqet e tua për të gjithë ata që m'i ke shokë dhe do t'i botoj. Me emër tjetër, me pseudonym; do t'i dërgoj me zarf anonim, por do t'i botoj. Do të të shkallmoj. (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes... fq. 278)

Ish kaq i tretur ky Kapllan aga sa mezi i ngjante agos tonë të parë, që e dinim **sa një lis të plotë. I bardhë si sheleg**: me flokë , me vetull, me mustaqe. Po i gëzuar, i gëzuar si s'kish tjetër në botë! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 9)

Një kohë i pari i pijanikëve të fshatit ka qënë Kamber Kollozheku, - një **i gjatë sa një plep**, i zeshkët si hoshaf e **me hundë me sqep si të shqiponjës**.

- Pse i thoshin Kollozhek? - ke për të pyetur ti.

- Prit se ta them: kish dalë asaj kohe kënga e Kollozhekut dhe Kamberi e këndonte ditë e natë, se pinte ditë e natë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 285)

- Dale të pyesim këtë shokun , - tha një grua e thatë, që kishte një fshesë në dorë. – Kur e si do të mbarojë kjo luftë?

- Ama ç'pyetje i bëre, - tha një ushtar i shkurtër, me fytyrë të rrumbullaktë, **me sy si të kaut** dhe me një palë mustaqe të trasha e të zeza. (Petro Marko,Veptra letrare 3 , fq.175)

- Lëre, lëre! Dil edhe pak jashtë ! – tha Duroja.

- Po dal, po me mend...

Duroja turfulloi **si kalë i lodhur** duke i ardhur rrotull bustit që rrinte aty mbi qilim, i plogët e shpërfillës për gjithçka. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 179)

- Sikur ua thashë njëherë. Mbrëmë isha te ai!

- Dhe ç'bëri?

- Edhe këtë jua thashë! Hapi krahët, **si zog i plagosur** ! “ Si zog i plagosur...” - e përsëriti Nuroja me mend. Dhe i erdhi për të qeshur. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 292)

...I ati, i gjyshi, kishin ikur prej kohe nga kjo botë. Ja të tjerë, të gjithë që gjashtëdhjetë e poshtë edhe ai, midis tyre, **si një gështenjë zgërbonjë**, në mes të një korije të re. Dhe e

humbi që asaj dite agai shijen e jetës... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.53)

2.4. Njësia frazeologjike mbiemërore dhe togjet e lira

(ngjashmëri dhe dallime)

Njësia frazeologjike mbiemërore ashtu si togjet e lira të fjalëve kanë lidhje të njëjta ose përbëhen nga dy a me shumë fjalë shënuese. Njësia frazeologjike pavarësisht sesa gjymtyrë ka ato i referohen vetëm një kuptimi idiomatik dhe të figurshëm, ndërsa togfjalëshat e lirë kanë aq kuptime ose koncepte sa gjymtyrë ka togu përkatës;

*Hiq – hiq gjer e sollëm në gryka. Kur doli aty lart (po regëtinte mëngjesi, tutje) ky Xoxi na ish bërë verdhica , gjysmë i gjallë e gjysmë i vdekur. Me thikë t'i bije, **s'i dilte pikë gjak**. Targaçet bosh, që të dy.*

- Fol , bre Xoxi , ç'ke – se ne këtu jemi! Na bëri me dorë ta lëmë të marrë veten. E zumë për krahu edhe e shpumë në zjarri , aty ndënë grendë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 26)

*- Hallë, - tha Joli .Ishte fyer dhe kishte nevojë të bërtiste, por ishte në pastiçeri, pak më tutje ishte Berti, kurse halla vazhdonte ta shihte me dhembshuri e urtësi prej njeriu **“të rrahur me vaj e me uthull”**. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 242)*

*But of course all the Plumstead and Framley set will move heaven and earth to get him out, so that he may not be there **to be a disgrace** to the diocese. (A. Trollope/ James M. Dixon, English idioms, fq. 164)*

*...His breast heaved; his whole person changed ,as he stood glaring over the cowardly tormentor who now lay crouching at his feet; and defied him **with an energy he had never known before**. (Charles Dickens, Oliver Twist , fq. 88)*

Siç vihet re ngjashmëria e njësive frazeologjike me togfjalëshat e lirë mund të lidhet me prejardhjen e tyre. Prandaj një pjesë e togfjalëshave kanë shërbyer si burim për njësitë

frazeologjike edhe në gjuhën shqipe si edhe në gjuhë të tjera.

- *Mua ? E ke gabim, - Spartak Papagjoni qeshi. – S'merret njeri me mua , i dashur. **Isha peshk i vogël** , i parëndësishëm . Si unë ka me qindra. Ti ik shpëto lëkurën. Mentar Tyta e vështroi dhe mendimi i fluturoi gjetiu. Përderisa i binduri, i zellshmi, puthadori e spiuni vullnetar Spartak Papagjoni i fliste me këtë gjuhë të pacipë, i kapardisej e i jepte këshilla, do të thoshte se bota e tij kishte marrë fund. Ose do të merrte fund së shpejti. (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq. 277)*

*Domethënë Spartak Papagjoni nuk i trembej së ardhmes se **kishte qënë peshk i vogël...** i pat shërbyer edhe ca kohë,maskarai, deri nga fundi i janarit, pastaj ia drodhi e nuk i dha informacione dhe Mentar Tyta nuk i kishte tanimë aq të sakta bisedat e brendshme e të fshehtat e udhëheqësve opozitarë.(Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq. 277)*

Në rrafshin kuptimor kemi të bëjmë jo me kuptimin e drejtpërdrejtë të togfjalëshit të shndërruar në njësi frazeologjike “ *isha peshk i vogël*”, por me kuptimin e figurshëm. Kalimi nga togfjalësh i lirë në njësi frazeologjike bëhet nga përdorimi në mënyrë të vazhdueshme i këtij togfjalëshi, në kuptimin e tij të figurshëm. Sot kuptimi i figurshëm i togfjalëshit “ *isha peshk i vogël* ” është: ‘ isha i parëndësishëm, në atë rend hierarkik ose institucional dhe zbatoja urdhërat e më të mëdhenjve’.

Njësitë frazeologjike krijohen gjatë ligjërimit, ato janë njësi të gatshme dhe ndonjëherë edhe në trajtë të ngurosur dhe uniteti i tyre semantik dhe përdorimi si njësi të gatshme i bën njësitë frazeologjike unike si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Në sajë të kësaj veçorie njësitë frazeologjike lidhen me fjalë të tjera , por pa u zbërthyer vetë. Kjo do të thotë që shpeshherë njësia frazeologjike hyn në fjali si një fjalë e vetme dhe kryen funksionin e fjalës.

Në mjaft raste gjymtyrët në togfjalëshin e lirë nuk përshtaten me njësinë frazeologjike, sepse ngurosjë bën të mundur të kuptuarit e figurshëm. Në bashkimet e lira të fjalëve nuk ka ngurosjë të formave të fjalëve. Njësitë frazeologjike dallojnë nga togjet e lira, sepse ato përdoren në kuptimin e tyre metaforik. Kuptimi tërësor në fjalët e njësive frazeologjike del nga shkrirja e kuptimit të gjymtyrëve. Në shembujt e mësipërm, lidhjet sintaksore të njësive frazeologjike nuk janë të qarta si në togfjalëshin e lirë, gjymtyra emërore e saj e ngurosur nuk ndryshon.

Mjaft njësi frazeologjike formohen sipas gjedheve të gjuhës edhe si formime analogjike bazuar në ndërtimin semantik dhe sintaksor të togfjalëshave të lirë. Prandaj jo të gjitha njësitë frazeologjike mund të kenë gjegjëset e tyre në togfjalështa të lirë.

*Nëna ish e gëzuar. Fshiu sytë edhe shtiri kafën në filxhan. Ne kishim aty në vatra një këmbë lepurit që fshinim e mblidhnim hinë. Tashi këmba ish në dorën time edhe goja e Milkës, sa një haur, aty pranë meje. S'di as unë si u bëra, po kur **ia pashë gojën të hapur** pranë meje e sytë e lotuar, mbytur në zhubrën e lëkurës, hë! Këmbën e lepurit me hi në gojë brenda! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare , fq. 84)(togfjalësh i lirë)*

*Tri ditë pas varrimit i kanë vajtur pastaj, atje në varri edhe i kanë derdhur një goxha vozë raki në krye. Edhe, rrëfejnë se i vdekuri e përpiu rakinë menjëherë. Se ku ta dish , i shkreti ndofta **priste gojë hapur**... Një kohë i pari i pijanikëve të fshatit ka qënë Kamber Kollozheku, - një i gjatë sa një plep, i zeshkët si hoshaf e me një hundë me sqep si të shqiponjës. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 285) (njësi frazeologjike)*

Sic e nënvizuam, togfjalëshat e lirë para se të kalojnë në njësi frazeologjike i nënshtrohen procesit të leksikalizimit dhe gramatikalizimit, sepse të gjitha shprehjet kanë fituar tiparet e qëndrueshmërisë gramatikore dhe semantike gjatë zhvillimit historik të gjuhës.

Mund të ilustrojmë disa raste të gramatikalizimit me anë të disa fjalëve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze (emra, mbiemra) që e humbasin kuptimin e tyre të mirëfilltë kur kalojnë nga togfjalëshat e lirë në njësi frazeologjike. Shikojmë që komponenti nuk mund të ketë të njëjtin kuptim leksikor. Psh: *i ka buzët me qumësht*

i rrahur me vaj e me uthull

i bërë grusht

ha bukën e përmbys kupën

të qëron të bardhën e syrit

a guilty secret

frozen with heart

with head up

spit laugh

Një togfjalësh i lirë transformohet në njësi frazeologjike, kur nuk është i motivuar, kur fiton tipare të qëndrueshmërisë semantike dhe kur fiton tipare të qëndrueshmërisë strukturore. Qëndrueshmëria strukturore është tipari themelor i njësive frazeologjike dhe shërben për të përcaktuar identitetin e njësive frazeologjike.

*Edhe sa për verë, gjer aty e ktheu prapë, se butet ishin në dera edhe plloskët në goja: me trëndelinë, me borzilok – e lehtë a e rëndë – si të ta desh **e bardha zemër** . E sa për të ngrënë, s'ka si bëhet më mirë, se qengjat e butë edhe gjahu i egër ish në heje – si ta doje. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 227-228) (njësi frazeologjike)*

*Kjo më ngushëlloi pak. Po jo së gjithash , se kisha pasur natën **një grusht pare të bardha** nëpër duar e m'i kish tretur mëngjesi. Mora përsëri bukë e djathë e dola në*

Mburima , ku uji mburonte glu – glu – glu, me flluska të rrumbulla; ku ngriheshin e binin fije shuri.(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 73) (togfjalësh i lirë)

Njësitë frazeologjike meqenëse janë trajta të ngurtësuara të fjalëve nuk mund të ndryshojnë, ato përdoren në ligjërim a në fjali si të gatshme, ndërsa në togjet e lira gjatë përdorimit në fjali edhe mund t'i zëvendësojmë njërën gjymtyrë dhe ana kuptimore nuk ndryshon. Në njësitë frazeologjike mbiemërore nuk mund të ndryshojmë fjalët ose gjymtyrët sepse do të humbiste logjika kuptimore e frazës:

*Dhe kur fliste kështu , mër – mër – mër e bër – bër- bër , erdhi edhe e mori gjumi ashtu si ish, **me kokën mbi trajstë**, me dorën mbi qese e me mendjen te sterrat me ujë e në pusët me aspra. Fjeti dhe u zgjua, fjeti dhe u zgjua – tri herë rresht – pastaj fjeti më thellë , sepse trupi i tij ish i lodhur së tepërmi edhe mendja e robëruar me kamje e skamje e me sterra për ujë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.219)*

*Zbriste djathi i butë. Hante Tira, hante Llambi, hanin edhe agallarët vetë. Jo vetëm hanin, po edhe qeshnin. Se për shaka e për rengje **i punonte mendja si flaka e zjarrit**, kur i hedh bylyr nishadër. Një ndajnatë papu iu bë si qen – me këmb' e duar – e iu turr mulla Ymerit kur dilte nga xhamia. Ky u tremb ngriti xhyben e ia mori me të katra , aman - aman! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 194)*

*A s'mjafton vetëm kaq? Mos emri juaj e imi , të mirë a të ligj qofshi, me kamje a me skamje , - ka për t'u kujtuar më dendur? Ne kemi parë, o shokë, bejlerë e të parë që **i kishin lirat me bisht e mexhitet me barrë** e që s'kanë lënë një gur që t'iu kujtohet emri...Them për të mira e jo ndryshe se për të këqija mos pyet, kanë punuar sa u ka mundur krahu dhe jo më kot bota u këndon çast për çast bokxhananë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 193)*

Në njësitë frazeologjike është pamundur futja e gjymtyrëve të tjera në strukturën e njësive frazeologjike. Nëse ndryshime të tilla bëhen lehtësisht në togfjalëshat e lirë në njësitë frazeologjike kjo është e pamundur. Megjithatë një pengesë të tillë nuk e hasim tek shprehjet, që përdorin në veprat letrare shkrimtarët për qëllime stilistikore. Ata krijojnë variante të ndryshme të njësive frazeologjike. Në ligjërimin e folur, njësitë frazeologjike i ruajnë strukturat e tyre tradicionale dhe u rezistojnë komponentëve shtesë duke u treguar kështu më konservatorë (ruajtës).

*Edhe pse mendja ime , si çdo mendje çilimiu , punonte **si punon flaka e zjarrit**, u sillej rreth e përqark këtyre botëve të ndryshme , që s'i ngjajnë botës sonë , si nuk i ngjan e bardha se zezës e mira së ligës. Asoherë pranë botës sonë ish, gjithë mbi dhe, një tjetër botë që nuk e shikonim dot me sy. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 180)*

*...Se pa sy qysh do ta vështroja Marinën? E në desha të kem gjësend asaj kohe, do ish të kem dyzet sy që ta vështroj, dyzet veshë që ta dëgjoj, dyzet duar që ta prek. Se **kaq plot e kisha zemrën** me të asaj ndajnate korriku, kur s'ngryset dot. Doli një shkëndijë nate nga pjergulla . I ra pas një tjetër. Si për dashuri ! (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 174)*

*Një mëngjes i vjen babait në furrë, për bukë , me bastun në dorë – “ Mirëmëngjes , o furrtar. Si ke gdhirë?” Shqip ! Pothuaj siç flasim ne , po pak si trashë : gjysmë toskçe, gjysmë gegçe. **Zërin e ka si të ariut** kur zemërohet. Babai është me lopatë në dorë , i dirsur: nxjerr furrën e tretë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 132)*

Zakonisht gjymtyra e ngurosur është gjymtyra emërore:

Baba kjo e uruar verë e re të shpie furrë më furrë e s'të jep bukë, krua më krua e s'të jep ujë.

*- E shoh se ti do të thuash gjëkafshë, po nuk e marr vesh mirë se ç'do të thuash. **Jam si***

nëpër tym.

- *Mirë që e the edhe vetë...Ne thamë të na rrëfesh punën e atyre qypave me florinj të Rrapsallit e ti na mbajte një copë herë me raki mani në furrë të gjyshit... (Mitrush Kuteli Netë shqiptare, fq. 140)*

- *Ç'janë ata qypa, moj bijë? Ç'janë këto pare me bisht?- pyeti plaku dhe u mundua ta shquante, ndër të tjerat, atë që foli, **me** ata **sytë e shpëlarë**, që ia kish përcëlluar flaka e furrës. (Më vonë, im gjysh humbi fare dritën e syve, rrojti dhe eci shumë vjet në errësi, gjersa ndërroi jetë kur ishte një njëqind e tetë vjeç). (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 128)*

Një pjesë e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore, hyjnë në strukturën e fjalive dhe mund të modifikohen nga gjymtyrët emërore, si në rastet e mëposhtme:

- *I shikonte, bir, se Babalja **kish shpirt të mirë** e **s'kish maçok në bark** . I leshtë si ky Babalja ynë s'ka pasur njeri në fshat. Ai as gjarprin nuk e vriste. – Shko , i thosh në punë tënde. As marauzhgat nuk i shkelte kurrë as gomarit nuk i binte me stap e **as fjalë të keqe nuk thosh me gojë**. Prandaj edhe atij i rrëfesheshin të gjitha si pa gjë të keq. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 291)*

*Edhe Marina ish atje tej: më e bardhë se niseshteja e turkave e se pëlhura e kaurkave. Këtë ma panë sytë e mi ! – Si ma panë , hyra ndënë ujë si rosakët **se më ish bërë mendja vija –vija**. E kur dola përmi ujë, rashë me not gjer përtej Kallmrit, sikur më shpinte qoftëlargu... Po tani shkuan të gjitha dhe ne rrinim aty ndënë pjergull, ku rridhte kroi e këndonin bulkëzat giu – giu, pa marrë frymë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 173)*

*...Well, I'm sure I hope your head begins to split as soon as you are married, which was the case with mine, I cannot consider that you are to be envied, though **I have no doubt** you*

think you are, all the girls do. However, I give you joy, my dear – and I hope you may now turn all your ological studies to good account, I sure I do! (Charles Dickens, Hard times, fq.107)

Në shembujt e mësipërm ka raste kur mbiemri lidhet vetëm me gjymtyrën emërore ose vetëm me gjymtyrën foljore që është përbërëse e njësisë frazeologjike, pra nuk lidhet me tërë njësinë frazeologjike. Në disa raste në njësitë frazeologjike ndryshimi i rendit (vendosja e foljes para emrit a mbiemrit) pasqyron efekte të theksimit të kuptimit.

Pa më ish kjo nus' e Çilit (Çili jam unë!) një vogëloshe bardhoshe si shkumbë qumështi kur gumëzhin në kusi, sapo i mjelë, me ca sy të shkruar e ca leshra të verdha si kalliri i pjekur. Edhe dëgjoja shpesh botën që thosh:

*- Rusp është kjo çupë! E bukura e dheut ! **T'i rrëmbesh kokën** e të ikësh!*

Dhe kur dëgjoja këto fjalë vinte e më pushtonte një gaz i madh, i trazuar me një helm edhe më të madh. Gaz, sepse Marina ime ishte e bukur mbi të bukurat; helm , sepse isha zilitar e druhesha se mos me të vërtetë mund t'ia rrembenin kokën e të iknin e të ma linin pa kokë...

(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.242)

*Ja këtë punë nuk e zgjidhja dot. Veç kësaj nuk mund ta merrja dot me mend se si gjyshi mund të rrinte në terret, në kazan me zift të valë, në mes të shpatanëve e të qoftëlargëve me këmbë dhie, që do ta shponin me dobec. Ai ishte kaq i butë, kaq i mirë , kaq i dashur. **U jepte** bukë **njerëzve**. Gjyshi na shkoi i pikëlluar. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 154)*

*Kësaj radhe nuk hymë në shpellë, po ia shtruam në një lëndinë, pranë zjarrit: unë më të djathtë, Zyferi më të mëngjër e Mustaqeverdhi në mes. Kjo natë ka qënë më e llahtaritur sesa e para. Me të mbyllur sytë, vinte e **na pllakoste një hije e zezë**, si plane , **plumb e***

rëndë. Kur e kur ikte hija e vinte një burrë i gjatë **me** ca mustaqe **si fshesë** e na rrihte me një topuz thane. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 152-153)

Në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore është e pranishme edhe dukuria e eliptimit të pjesëve të njësive frazeologjike, të cilat edhe fshihen:

Dua atë të bëj një të mirë të madhe, që të më kujtosh. Se edhe dreqi i vogël mund të të bëjë një mal me të mira! Të të rrëfej...

- Ndonjë thesar?

- Më shumë se një thesar : **një botë me thesare.** Unë **jam dreq**, po **dreq jo fort i zi.** Brirët e mi s'janë të përdredhur tri herë, as thonjtë e mi të gjatë fort.(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 220)

Pranë Resmi Dukajt u ul i njëjti njeri që kishte ndenjur edhe para mbërritjes së nëpunësit.

- Ky i shkreti **është dede**, - tha. – **Qengj!** S'bën për këtë punë ky. Ai që ishte para tij, po! Vinte hijerëndë ai, nuk të shikonte në sy, s'bënte muhabete, jo po tërci, jo po vërci! Një fjalë dinte ai: njëzet! (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq.189)

Shfaqja e njësive frazeologjike në variante të ndryshme sintaksore, vështirëson përcaktimin e identitetit dhe tregon shkallën e ulët të qëndrueshmërisë:

*U hodh pastaj nus' e Çulit me njetë shami në dorë edhe i kurdisi nuses një këngë sipas emrit të saj (se **m'u pat bërë mendja ujë** e pata harruar t'ju them se maces së Qipros i thoshim Pase), plot goja: (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.169)*

*In the strength of his misfortune , and energy of his distress, **he fired** for the moment **like a proud man.** In another moment , he stood as he had stood all the time – his usual stoop upon him; his pondering face addressed to Mr. Bounderby, **with a corious***

expression on it, half perplexed, as if his mind were set upon unravelling something very difficult; ... (Charles Dickens, Hard Times, fq. 80)

E vërteta është se maçoku i Shamshallos që deshëm ta dhëndërojmë, i kish mustaqet si rrënj' e preshit , po ç'ti bësh këngës e ç'ti bësh krushkës Magalinë? E sepse kjo krushka Magalina, si i thoshim nuses së Zhabikut, kish hyrë në valle , s'kish se kush t'ia ndalojë hovin e këngën, e mbajti gjer në fund. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 168)

2.5. Njësitë frazeologjike dhe shumëkuptimësia e tyre

Një pjesë e fjalëve janë polisemantike, por ka edhe njësi frazeologjike për të cilat mund të themi të njëjtën gjë, megjithëse ato njihen si njëkuptimëshe. Edhe tek njësitë frazeologjike gjendet polisemia, sidomos në ato njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore që lidhen me pjesë të trupit të njeriut:

me lakra në kokë – në kuptimin e parmë

a- kjo frazë ka kuptimin se sheh një njeri të cilit i kanë hedhur lakra mbi krye, ndërsa në kuptimin e figurshëm

b- përcjell mendimin se ky njeri ka mendime të këqija, negative dhe

c- mendimet janë të pavlera ose mendime të kota.

i ka buzët me qumësht – në kuptimin e drejtpërdrejtë të saj

a- ka kuptimin se i janë bërë buzët pis me qumësht dhe në kuptimin e figurshëm

b- mbart kuptimin se njeriu për të cilin po flasim nuk është i rritur, pra ka moshën e fëmijës që ende ushqehet me qumësht dhe

c- mendimin se personi në fjalë mund të jetë moshë e madhe, por është i papërvojë .

Siç e vëmë re, dukuria e shumëkuptimësisë (polisemia) është pjesë edhe e shprehjeve frazeologjike me vlerë mbiemërore. Në mjaft përdorime të njësive frazeologjike vëmë re edhe praninë e sinonimisë ose përafri të mendimeve për përvoja të caktuarë psh: *e ka gjuhën çorap*, *e ka gjuhën lopatë ose i pret goja*, *e ka gjuhën brisk*, ose *e ka kokën shkëmb*, *e ka kokën si të mushkës etj.*

2.6. Njësitë frazeologjike mbiemërore dhe klasifikimi i tyre

a - Njësitë frazeologjike mbiemërore dhe klasifikimi sipas motivimit

Njësitë frazeologjike mbiemërore sipas motivimit grupohen në njësi frazeologjike të motivueshme dhe të pa motivueshme. Në rastet kur njësia frazeologjike (togfjalëshi frazeologjik) krahas përdorimit të saj të figurshëm ka (ekziston) edhe togfjalëshin e lirë (kuptimin e parmë) atëherë themi se kemi të bëjmë me njësi frazeologjike të motivueshme.

Psh: *Ai mbeti **me sytë hapur** nga habia.* – (i habitur, i hutuar) përdoret me kuptimin idiomatik ose të figurshëm.

Psh: *Vajza rrinte **me sytë hapur** dhe nuk kishte gjumë.* – në këtë fjali përdoret kuptimi i drejtpërdrejtë.

Në rastet kur mungon gjegjësjë përkatëse dhe nuk zbulohet motivimi, kjo njësi quhet e pamotivueshme.

Në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore , mund të gjejnë shpjegimin përkatës edhe mjaft njësi të tjera që kanë si gjymtyrë përbërëse të tyre mbiemra. Psh : *me gojën kyçur (i heshtur, i pafjalë)*, *me gjak të ngirë (i frikësuar, i trembur)*, *me gjuhën e gjatë (llafazan) etj.*

Sipas rasteve përkatëse në njësitë frazeologjike njëra nga gjymtyrët mbart forcën e figurshmërisë (ngjyrimin emocionues) ose vatrën semantike, e cila zbulon motivimin e të

gjithë njësisë frazeologjike. Ajo mund të jetë një gjymtyrë e shprehur me emër, me folje, me ndajfolje ose me mbiemër.

b - Njësitë frazeologjike mbiemërore dhe klasifikimi sipas vlerës leksikore dhe formave të lidhjes së gjymtyrëve:

Njësitë frazeologjike i grupojmë edhe sipas strukturës së ndërtimit të tyre, nëse ato funksionojnë si folje janë foljore, nëse përdorimi i tyre luan funksionin e emrit janë emërore dhe nëse ato funksionojnë si ndajfolje janë ndajfoljore, nëse janë njësi me kuptime mbiemërore janë mbiemërore. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë të ndërtuara sipas disa formave të lidhjes së gjymtyrëve:

- dy emra me lidhje këpujore emër + emër si : *as mish as peshk, hundë e buzë, kockë e lëkurë* etj.
- dy folje folje + folje si: *qep e shqep, mat e pre, shih e shkruaj, shkel e shko* etj.
- emër + mbiemër si : *dhelpër plakë, teneqe e shpuar, baltë e dobët* etj.

*Kështu e ngrysi ai këtë jetë të ëmbël e të hidhur; me punë e me këngë. Prandaj njerëzit, të shumtët e donin. Sepse kënga e afron njerinë me njerinë, e zbut e bën më të mirë, më të dashur. Po kjo s'do të thotë se s'kish nga ata që nuk ja varnin fare e që rrinin **hundë e buzë** kur këndonte. Mirëpo këta ishin të paktë, nga ata që ne themi andej shpirtkazmë, pa shpirt. Këta dinin e donin vetëm një gjë: qesen me pare. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.179- 180)*

Larg oborrit të shtëpisë së Abedinit filluan të vinin të qeshura të tjera. Ata që qeshnin duhet të ishin rreth dy-tri veta. Havaja dhe Xhelo Mara e kuptuan që qeshte Bamja me

shokë. Me siguri që ata e kishin ndërsyer Zaken e krisur. Në fillim kishin dërguar Zekirjanë e gjorë, pastaj edhe të birin. Abedini erdhi **pikë e vrer**. U ul në sofër pa fjalë dhe piu njëra pas tjetrës shtatë gota. (Dritëro Agolli, Dështaku fq. 91)

Në të vërtetë, kryetari vazhdonte të sillej me të njëjtën prirje të mirë, madje, meqë punët... i drejtonte Nuroja kishin mbetur ashtu në mes **as mish as peshk**, kjo sjellje mund të quhej dashamirëse. Ajo i përngjiste butësisë së mësuesit ndaj nxënësit të dikurshëm kanakar, të i cili nuk i humbiste besimi asnjëherë. Prisni, një ditë ai do ta tregojë veten... (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 280)

Është nisur pastaj, ai në mes e trimat rreth e rrotull, e ka zhavaluar të piqet me njatë Moskov mjekërverdhë. **Me gaz të madh** ka shkuar, sikur ish dasmë e jo luftë ku derdhet gjak. Kush u kthye e kush jo, se u firos në luftë – se luftë pa vdekje, si tha ai, e bukë pa thërrime s'ka si bëhet. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.18)

Njësitë frazeologjike janë elemente të rëndësishme të leksikut të cilat e pasurojnë vazhdimisht atë. Gjuha është një organizëm gjithnjë në ndryshim dhe në transformim, duke huazuar, duke shkëmbyer fjalë dhe njësi frazeologjike dhe duke u pasuruar përmes dialekteve por edhe përmes neologjizmave dhe fjalëve të përdorur nga brezi i të rinjve.

- lidhjet mes dialekteve ose shkëmbimet mes tyre – *si rrip dulleje* (i padobishëm), *si pare defi* (të verdha), *skile e vjetër* (dinake), *karpuz i pjekur* (kuqalash), *kaur i keq* (njeri i keq) etj
- njësi frazeologjike relativisht të reja që përdoren nga të rinjtë - *si top futbolli* (i hedhur, i lëvizshëm), *s'i punon hard disku* (s'i punon mendja, i trashë), *s'i punon rëlëja* (RL) (s'i punon truri, i mefshtë), *i dolën llambatinat* (i dolën sytë vendit, i

çuditur), *fluturon me Red Bull*, (fluturon me presh - mendjelehtë) etj.

Shumë njësi frazeologjike janë të ngurosura edhe në ligjërimin e zakonshëm, ato përcjellin edhe një ngarkesë të madhe emocionale. Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë kategorinë e përgjithshme të mbiemrit dhe në rastin më të zakonshëm ato përbëhen nga një emër, një mbiemër, një folje dhe gjymtyrë fakultative. Këto njësi frazeologjike mund të jenë dy a më shumë gjymtyrëshe.

Në mjaft raste, në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike mbiemërore kanë si karakteristikë edhe praninë e gjymtyrëve fakultative ose disa treguesve formalë si; lidhëzat krahasuese, parafjalët, pjesëzat etj. ndonjëherë ato janë të domosdoshme dhe mund të krijojnë disa tipa formalë.

*Oh, qesja është e dhembshur, qajnë udhëtarët. “Bobo, i gori unë, thotë njëri. Kam fëmijët pa bukë!” “Medet, ia bën tjetri, jam mbytyr në borxhe. Si do t’i laj...Do të më nxjerrë fajdexhiu në diell!” Të këputin shpirtin. Po hajduti është hajdut, s’do t’ia dijë nga lotët. Ai e ka shpirtin në çark të dyfekut; këtë ka arë, këtë ka stan. Hajduti rron **me qefin në kokë**, lufton për hyqymet. Prandaj, kur i vjen rasti zhvat sa mund. (Mitrush Kuteli, *Netë shqiptare*, fq. 122)*

Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë edhe mikrotekst të ngulitur me gjymtyrë fakultative të përcaktuara ose njëra gjymtyrë e njësisë frazeologjike e cila mund të jetë kthyer në fakultative.

- Ku jeni? Ku jeni, moj shoqe?

Anita , që dëgjoji këtë zë dhe që pa dy hije që afroheshin, u sul me një frymë drejt tyre **me krahë të hapur** duke thirrur:

- Gori!

Dhe plaka , që u ngrit në këmbë e trembur, bërtiste... (Petro Marko,Vepra letrare 3, fq.312)

Njësi frazeologjike mbiemërore me gjymtyrë fakultative të ngulitur psh: *me gojë hapur* (i çuditur) *me krahë hapur* (i përzemërt,i dashur), *me zemër të hapur* (i çiltër) etj.

- *Agua! Ujë! Vdiqa për një pikë ujë!*

“Ah,- mendonte Puceli,kur dëgjonte fjalën ujë , - ç'bëra unë që s'piva shumë e shumë në atë lumë të mallkuar!”

Sa deshi të ishte brenda në lumë, tëkridhej i tëri me gojë hapur e të pinte sa t'i pëlçiste barku. (Petro Marko,Vepra letrare 3, fq. 384)

- *Ramë të flemë, sikush me gunën e tij. Natë si ajo mos ardhtë kurrë në botë! Tym e fërtyme. Endrra të flamosura. Këto ëndrrat i shihnim me sy hapur. Sikur ishim në një gropë të madhe tri bojë njeriu thellë, plot me gjarpërinj: të bardhë, të kuq, të zinj, larushë, të mëdhenj e të vegjël: ca të mbledhur kutullac, ca të zgjatur tejprtejt, ca të varur nëpër degët mbi kryet tona, gojëhapur, gjuhëkuq si flaka, të ndarë më dysh. (Mitrush Kuteli , Netë shqiptare, fq. 155)*

Njësi frazeologjike mbiemërore në të cilat gjymtyrët fakultative vijnë duke u ngushtuar ose duke u zgjeruar struktura frazeologjike psh: *me bukë e kripë* (e me zemër të bardhë - bujar). Këto janë pjesë brenda strukturës frazeologjike.

Variantet frazeologjike krijohen me ndryshime të rrafshit gramatikor dhe të rrafshit leksikor, ato lidhen me mundësinë e ndryshimit të gjymtyrëve të eptueshme pa e shpërbërë njësinë frazeologjike dhe pa e ndryshuar kuptimin frazeologjik.Të tilla ndryshime janë : *me dorë në zemër* (i përulur) dhe *me zemër në dorë* (i ndjeshëm, i dhimbsur) etj.

Javo se atëherë po vjen edhe Ago Dajlani e na qëndron përtej e ulet të dëgjojë këngën e Petrushit. Pa, vetë ky usta Vani ç'u ngrit në këmbë e iu lut **me dorë në zemër** të vijë ky në krye të sofrës. -Urdhëro e na ndero këtë çikë bukë, o zoti bujer, i pat folur ustai në gjuhën e vendit.(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.38)

Fytyra e kryetarit u bë fare shpërfillëse. I iku zemërimi, mllëfi, inati. Nuroja po i dilte ndyrësirë. U bind qëkurse e pa se me sa ngut gënjeu për atë çështjen e vjehrrit. Gënjeshtren e nuhaste që atje tej. "Hm...**ma vuri zemrën në pëllëmbë**, pizevengu, po këtë pyetje nuk e priste dhe u trullos, s'pati kohë të sajonte taktikn", mendoi. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 300)

Edhe zonjat e shtëpisë - nusja ime e nusja e Çulit – i gostitnin mysafirkat me nja dy pika ujë në ndonjë guaskë të thatë kërmilli, që kishin mbledhur e sjellë nga Çuka e madhe e nga Vërzat. Këtyre u thoshin raki e kafe, sipas rastit, e ua jepnin **me dorë në zemër**. Miqësia bënte sikur pinte... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.240-241)

Variantet frazeologjike leksikore janë njësi frazeologjike të mëvetësishme dhe për arsye praktike psh: me gjak të ngrirë (i trembur), me pendë të rëna (i pavlerë), me kokën dhallë (i trullosur, i lodhur), me zemër të ngrirë (i frikësuar)etj.

...- Kur nisesh për në mbrëmje, të ngjan sikur, po të mos vish do të bëhet një mbrëmje e jashtëzakonshme, dhe do të ngelet peng po të mos jesh. Dhe vërtet, ato minutat e para, kur zë vend, kur sheh se cilat vajza po vijnë, rri **me zemër të ngrirë** dhe pret me padurim të nisë orkestra. Kurse vajzat, të mbledhura të gjitha në një qoshe, gjithnjë të pakta në sasi, pale në cilësi, rrinë të menduaara, serioze dhe indiferente, e as sytë nuk t'i hedhin sytë, sikur s'të njohin fare...(Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 202)

*Ishte hera e parë që ecnin të dy, në atë orë të vonë, në bulevardin pa njerëz, mes apartamenteve me drita të shuara. Asaj iu kujtua përsëri e motra, Vera. Me siguri tani ajo rrinte në dritare, duke pritur **me zemër të ngrirë** derën të kërciste. Nga hapat dhe sidomos nga zhurma e portës së vjetër ajo do ta kuptonte kush po hynte në oborr: ajo, ose babai. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 140)*

Siç mund ta vëmë re nga shembujt e mësipërm, gjatë përdorimit në ligjërime hasim disa variante të përdorimit të njësisë frazeologjike. Shpeshherë si kufi nistor i saj mund të shërbejë herë një mbiemër dhe herë një emër edhe nëse njësia frazeologjike është dy ose tre gjymtyrëshe:

*Atëherë krenohej se kishte kryer një lëvizje shumë të mençur duke shfrytëzuar rrjetin agjenturor, por tani **e djegur nga ethet** në shtrat, me Aliun që në dhomën pranë vështronte vrasjen e Çausheikut si i shkalluar, nuk e shihte më me atë sy ngjarjen e dikurshme. Madje nëpër dhomë i bëhej se lëvrinin hije njerëzish të përçudnuar. (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq.143)*

*Domethënë Spartak Papagjoni nuk i trembej së ardhmes se **kishte qënë peshk i vogël**...I pat shërbyer ca kohë maskarai, deri andej nga fundi i janarit, pastaj e drodhi e nuk dha informacione dhe Mentar Tyta nuk i kishte tanimë aq të sakta bisedat e brendshme e të fshehtat e udhëheqësve opozitarë. (Diana Çuli, ...Dhe nata u nda në mes...fq.277)*

*...U shtri në shtrat **me sytë dhelpërakë**, të Papagjonit nëpër mure. Sy të shpëlarë, kokërrdhokë të dalë si vezë syza, surrat miu. I kam ruajtur spiunllëqet e tua për të gjithë ata që m'i ke shokë dhe do t'i botoj. Me emër tjetër, me pseudonim; do t'i dërgoj me zarf anonim, por do t'i botoj. Do të të shkallmoj. (Diana Çuli, ...Dhe nata u nda në mes... fq. 278)*

Megjithëse e kishte thirrur dhe e pati marrë me vete për të caktuar lëndinat më të mira për kuajt e për të zgjedhur sojin më të mirë nga kafshët e shalës që kishte shpërndarë andej – këndej e megjithëse Xoxi pati mbetur **me gojë hapur** nga ky plan , beu vazhdonte ta pyeste duke e detyruar tjetrin , sa herë hapte gojën për të pirë kafënë, ta mbyllte prapë, për t'iu përgjigjur : “Po, po, o bej!...” (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, fq. 446-447)

Kur e panë ago Jakupin, të dy ikën si ik lepuri dhe qëndruan më tej të vështrojnë ç'bëhet. I treti nuk mundi të ikë se kish një gjemb në këmbët. Agai e **kish hijen e rëndë** dhe kjo hij' e tij ruante vreshtat. Fëmija zuri të lotojë. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 60)

- Hallë, - tha Joli .Ishte fyer dhe kishte nevojë të bërtiste, por ishte në pasticeri, pak më tutje ishte Berti, kurse halla vazhdonte ta shihte me dhembshuri e urtësi prej njeriu “**të rrahur me vaj e me uthull**”. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 242)

U hodh menjëherë me këmbë në brekë e në këmishë, **rendi si lingua** sa ment i doli shpirti edhe, sa të mbyllësh e të hapësh sytë, ish ku duhej – mur pas muri, derë pas dere e kyç më kyç.(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.218)

Në njësitë frazeologjike mbiemërore dygjymtyrëshe të tipit folje + folje; fol e qesh, qesh e ngjesh(ironik), bëj e zhbëj(i pavendosur), shikon e shkruan (i zoti,i shkathët), shkel e shko(i pakujdesshëm) etj.

Kufiri nistor është një gjymtyrë foljore.

Frëngu i shikon me të butë, u qesh,mundohet t'i përkëdhelë , t'u flasë ,po ata ikin, kanë frikë mos i marrë në thes e mos i shpjerë në Frëngji. Ngjitet lart, në çukë; rri shikon, shkruan. Shkon më lart, në ato Tri Shkallët; prapë **shikon e shkruan**. Del në sheshet e Gështenjave, shikon murishtat e vjetra, tund kokën. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 132)

*“Po të filloj të mendohem kaq shumë, do të bëhem patjetër me dy kokë...Po unë me dy kokë duhet të jem gjersa **them e shthem; bëj e zhbëj**. Njëra kokë thur, tjetra shthur...Ja pra rreziku i të pasurit shumë kokë... Kurse po të kesh shumë këmbë, s’ka asgjë të dëmshme, se ato merren vesh mjaft mirë. Përkundrazi ato të ndihmojnë të qëndrosh në pozicion që mund të të vërtitë shqota e jetës. “Në çdo pozicion? Edhe në atë poshtërues!...” Dhe sytë i vajtën përsëri te shumë këmbëshi në tavan. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. I, fq.356)*

*Si reshtën punët e jashtme – për të liruar arat e për të mbjellë të lashtat, për të përmbysur ugaret, që të ishin gati për pranverë, e të tjera të kësaj dore – si ra dita e hipi nata, në fshat filluan gatitjet për dasmë . E gjersa të vinin dasmat, krisën gostitë derë më derë, për të lusura: shtro dreka e darka, **prit e përcill**, ngrehu e shko në drekat e darkat që shtrojnë të tjerët...(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.117)*

Në njësitë frazeologjike mbiemërore që kanë një trajtë përemërore të shkrirë hasim një fjalë onomatopeike si kufi fundor të saj, psh:

*Aty për aty, ai u pendua për sjelljen e mëngjesit kur ndenji në pritë me atë orë të mallkuar në pëllëmbë. Ç’do të thoshin ata që e kishin parë? Dhe nga dreqin i duhej marrë ana? Ku e kishte forcën që **s’ia bënte syri bef** ?Dukej se kurajoja i vinte jo aq nga mbështetja e shokëve, sesa e ndiente veten zot të punës.*

(Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq.137)

*Njerëzit e shikonin me bisht të syrit dhe i bënin shenjë njëri – tjetrit, po prapë druhashin prej tij. Hajdar beu e ndiente thellë këtë diskriminim të të birit...Ai habitej sidomos me popullin,që hiqte gjithë ato të këqija, që hante plumba dhe internime nga më të tmerrshmet dhe prapëseprapë **s’ia bënte syri tërr**. (Shefqet Musaraj, Para agimit, fq.77)*

Jemi përpjekur që herë pas here të sjellim ndonjë shembull edhe nga gjuha angleze, për të kuptuar se megjithëse gjuhët janë të ndryshme, kanë edhe mjaft ngjashmëri. Edhe në gjuhën angleze kufiri nistor i njësive frazeologjike dygjymtyrëshe ose tregjymtyrëshe është ose ndajfolje ose emër;

*But of course all the Plumstead and Framley set will move heaven and earth to get him out, so that he may not be there **to be a disgrace** to the diocese. (A. Trollope/ James M. Dixon , English idioms, fq. 164)*

*They hadn't tampered with her natural beauty, yet somehow they had succeeded in heightening it. Before, it used to creep up on you. Now you noticed it immediately. She wore eye makeup and her hair was fuller, **like a lion's** mane. (Jacqueline Susann, Valley of the Dolls, fq.261)*

*She stood on the bow, looking into the distance, holding Garret's hand. "Will we ever go?" she asked him gently, and it was that vision of her he always remembered: her hair billowing in the wind, her expression radiant and hopeful, **like that of an angel**. "Yes", he promised her, "as soon as we have the time". (Nicholas Sparks, Message in a Bottle, fq.343)*

*...His breast heaved; his whole person changed ,as he stood glaring over the cowardly tormentor who now lay crouching at his feet; and defied him **with an energy he had never known before**. (Charles Dickens, Oliver Twist , fq. 88)*

Tek njësitë frazeologjike mbiemërore me strukturë fjalie kufiri fundor mund të jetë edhe një emër psh; për ta pirë në kupë(i mirë, i përkryer), ha bukën e përmbys kupën (mosmirënjohës), t'i presësh kokën (e bukur), të qëron të bardhën e syrit (trim) etj

*Pa më ish kjo nus' e Çilit (Çili jam unë!) një vogëloshe bardhoshe si shkumbë qumështi kur gumëzhin në kusi, sapo i mjelë, me ca sy të shkruar e ca leshra të verdha si kalliri i pjekur. Edhe dëgjoja shpesh botën që thosh: - Rusp është kjo çupë! E bukura e dheut ! **T'i rrëmbesh kokën** e të ikësh! Dhe kur dëgjoja këto fjalë vinte e më pushtonte një gaz i madh, i trazuar me një helm edhe më të madh. Gaz, sepse Marina ime ishte e bukur mbi të bukurat; helm, sepse isha zilitar e druhesha se mos me të vërtetë mund t'ia rrembenin kokën e të iknin e të ma linin pa kokë... (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.242)*

*Rritu, rritu, i arriti e vogla të mëdhatë, u bënë të tria për të martuar. Të mira ishin, punëtore ishin, pastërtore ishin ... “ Si ishte e vogla?” “E vogla? **T'i rrëmbeje kokën:** me këta dy sy...me këto leshra...” “Pastaj?” Shkonte i bir i mbret, kur ngjtej për gjah e kur zbriste nga gjahu. Shko sot, shko nesër, një ditë...(Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 131)*

Kufi fundor ndonjëherë mund të jetë edhe një gjymtyrë fakultative që vjen duke e zgjeruar ose duke e ngushtuar njësinë frazeologjike mbiemërore; iu bë mendja çorbë (dhallë) qensh – i lodhur, i papërqëndruar, i del tym (flakë) nga koka – i nxehur, i xhindosur, iu sos durimi (aq sa nuk mbushi minutin) – i paduruar etj.

KAPITULLI I TRETË

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1 HYRJE

Në shkollën tonë mësimi i gjuhës shqipe zë vendin më të rëndësishëm, por a janë të mjaftueshme orët e planifikuara në programet mësimore për frazeologjinë ? Njohuritë që fiton nxënësi në shkollë karakterizohen edhe nga aftësia për të manifestuar një sjellje të caktuar, për të zbatuar atë që është mësuar dhe zbatimi mendohet se është rezultat i kombinimit të të mësuarit me formimin e tij si individ.

Mësuesi është jo vetëm një mësimdhënës, përcjellës i mirë i materialit shkencor, por “*edhe një studiues i fenomeneve gjuhësore që shfaqin nxënësit e tij*” (Gjokutaj, M. 2012: 41).

Ai e përzgjedh me kujdes gjuhën në përdorim dhe vendoset me nxënësin në situata reale komunikimi, duke respektuar detyrat argumentuese dhe krijuese.

Ky studim i paraqitur synon;

- 1- të eksplorojë pasqyrimin e njësive frazeologjike në tekstet mësimore në klasat 6^{të} -12^{të}
- 2- përvetësimi i tyre në klasat 6^{të} - 12^{të} .

Metoda kërkimore është një metodë mikse ndërmjet metodës sasiore dhe metodës cilësore.

3.2. Hipotezat e kërkimit

Gjithnjë e më tepër, në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë janë pëmirësuar arritjet në përvetësimin e gjuhës standarde, por ka edhe probleme të cilat lidhen sidomos me përbërësit e punës për zhvillimin e të folurit, me leksikun (fjalën dhe frazeologjinë).

Mësimi është proces i organizuar, i planifikuar më qëllim që të realizohet përvetësimi i diturive në fusha të caktuara, është proces që mundëson krijimin dhe përsosjen e shkathtësive dhe shprehive të një individi.

Në psikologjinë shkencore termi i mësimi ka një kuptim më të gjerë sesa ai për të cilin mund të përdoret në jetën e përditshme. Procesi i të mësuarit përmbledh të gjitha modifikimet relativisht të qëndrueshme të sjelljeve dhe aktiviteteve psikologjike të cilat vijnë si rezultat i përvojës, pra mësimi karakterizohet nga një ndryshim relativisht i përhershëm. Studimi ynë merr përsipër të vërtetojë;

H1 - nivelin e ulët të pasqyrimin të njësive frazeologjike në tekstet mësimore në klasat 6^{të} - 12^{të}

H2 - përvetësimin në nivel të ulët në klasat 6^{të} -12^{të} . {me nivel të ulët të pasqyrimin në tekstet mësimore kuptojmë % për orë mësimore krahasuar me 136 orë mësimore gjithsej për klasë}

3.3. Planifikimi i kërkimit

Për të bërë këtë punim u hartua një plan pune për të gjitha shkollat që do ishin pjesë e vëzhgimeve dhe e anketimeve, sidomos për të studiuar me imtësi tekstet mësimore të ciklit parauniversitar dhe përdorimin e njësive frazeologjike në Punëve me shkrim nga nxënësit që studionin (në shtator 2013) nga klasa e 6^{të} deri në klasën e 12^{të}, në të cilët gjejmë njohuritë e përgjithshme rreth frazeologjisë dhe përcaktuam metodologjinë (mikse), kampionimi i përdorur për studim është kampionim jorastësor (i volitshëm).

Qyteti i Rrogozhinës është në një pozicion strategjik gjeografik, sepse lidh lindjen me perëndimin dhe jugun me veriun vendit. Ai trashëgon vlera arsimore dhe kulturore të jashtëzakonshme, meqenëse edhe popullsia përbërëse e qytetit është e ndryshme (heterogjene; popullsi vendase, pakicë greke, pakicë maqedonase, komunitet çam dhe të ardhur nga zonat e veriut të Shqipërisë).

Arsimimit të brezave në këtë qytet i është kushtuar një rëndësi e veçantë, qoftë në vitet para demokratizimit të vendit, qoftë në vitet e demokracisë, duke e patur dijen dhe arsimin si të vetmet dritare të komunikimit me botën e qytetëruar dhe Europën. Meritën më të madhe në këtë mbarëvajtje të vlerave arsimdashëse e ka komuniteti i zonës, i cili institucionet arsimore i ruajti me fanatizëm ashtu si tempujt e shenjtë, gjatë periudhës së tranzicionit. Këto shkolla janë pjesë e zbatimit të projekteve të ndryshme, duke përmirësuar investimet në vite dhe duke shkëmbyer përvoja në mësimdhënie, të cilat ndihmojnë për të nxitur tek nxënësit të menduarit kritik dhe ndërveprues.

Tradita e mirë e komunikimit dhe bashkëpunimit të këtij komuniteti në fushën e edukimit më nxitën të ndërmarr këtë studim për të përcjellë mendime dhe sugjerime në varësi të gjetjeve që lidhen me temën. Informacioni i punimit u realizua nëpërmjet sondazheve dhe vëzhgimeve të organizuara në katër shkolla publike të ciklit parauniversitar [1 gjimnaz, 1 shkollë e bashkuar (gjimnaz + 9-vjeçare) dhe 2 shkolla 9-vjeçare] në fshat dhe në qytet, të cilat u përzgjedhën meqenëse janë më pranë qendrës së qytetit të Rrogozhinës.

Pjesë e këtij studimi u bënë nxënësit nga klasa e 6^{të} deri në klasën e 12^{të}, duke nxjerrë në pah larmirshmërinë e përdorimit të njësive frazeologjike në zhargonin studentor, mangësitë aty – këtu në përdorimin e tyre në Punët me shkrim dhe esetë. Nëpërmjet vëzhgimit të orëve mësimore dhe anketimeve përshkruese, hetuam edhe lidhjen shkak - pasojë në interpretimet e përdorimit të njësive frazeologjike në Punët me shkrim dhe në esetë:

- Si arrijnë të përcillen njohuri të përgjithshme rreth njësive frazeologjike në tekstet shkollore nga klasa 6-të deri në klasën e 12-të ?
- Sa përvetësohen nga nxënësit njohuritë rreth njësive frazeologjike ?

- Cilat janë disa prej pasqyrimeve të njësive frazeologjike në zhargonin studentor, të formuara sipas mundësive që ofron gjuha shqipe ?

3.4. Metodatat e studimit

Metoda e përdorur në këtë punim është metoda mikse, e cila realizohet përmes metodës sasiore dhe metodës cilësore duke vlerësuar si elemente të studimit; anketime, vëzhgime, studime të dokumentacionit (tekste shkollore, fletore të Punëve me shkrim të nxënësve).

- Pjesa sasiore: vëzhgime të teksteve mësimore
- Pjesa cilësore: anketime, vëzhgime, fletore nxënësish (Punë me shkrim, ese etj.)

Kjo metodë e studimit mundëson njohjen dhe paraqitjen e frazeologjisë në tekstet mësimore dhe mbledhjes së të dhënave nga kampionimi i volitshëm, se sa përvetësohen njësitë frazeologjike nga nxënësit e klasës 6-të deri në klasën e 12-të.

Teknikat e përdorura në këtë studim janë :

- Analizë përmbajtësore
- Matje me pyetësor

3.5. Prezantimi i leksikologjisë dhe njësive frazeologjike në tekstet mësimore

Zhvillimi i shprehive komunikative, varet shumë nga njohuritë e përdorimit të gjuhës dhe sidomos të njësive frazeologjike të cilat janë ekuivalente me fjalën. Nxënësit e ciklit të lartë në shkollat 9- vjeçare njihen me termin *Leksikologji* në tekstin e Gjuhës shqipe dhe Leximit të klasës së gjashtë dhe shpjegohet në këtë mënyrë :

*“Leksikologjia është degë e gjuhësisë që studion fjalët e një gjuhe dhe kuptimet e tyre. Fjala leksikologji vjen nga greqishtja e vjetër: lexis = fjalë dhe logos = dije, shkencë”.*²⁹

²⁹ Gjuhë shqipe e klasës 6 , Shtëpia botuese Albas, 2012, fq.195 – 196.

Në këtë tekst nxënësit njihen me shembuj fjalësh të cilat klasifikohen sipas fushave leksikore përkatëse si:

- fusha leksikore e ngjyrave (e bardhë, i verdhë, gri, jeshile, kafe, blu , rozë etj)
- fusha leksikore e kafshëve (mace, qen, zog, lopë, kalë, mi, buall, gjirafë etj)

Në këtë tekst didaktik nxënësi njihet me kuptime të reja fjalësh dhe i përdor ato në tekste përshkruuese ose në ese ose në shkrime të ngjashme me ditarët etj. Kështu nxënësi e ka më të lehtë të formulojë një tekst me ngjarje nëse mbështetet në shembujt e diktuar në librin shkollor.

Njohuritë e përgjithshme mbi Leksikologjinë si degë të Gjuhësisë vijnë duke u zgjeruar në tekstet e tjera të gjuhës shqipe, por në këtë tekst jepen informacione dhe koncepte edhe për nënfushat të tjera leksikore, të cilat mund të përfshijnë edhe fjalë të ndryshme që bëjnë pjesë në më shumë se një fushë leksikore. Në këto shembuj nxënësit arrijnë të krahasojnë anën kuptimore të të njëjtës fjalë dhe kontekstet e përdorimeve të saj.

Psh: a - fjala *bark*

bark – pjesë e trupit të njeriu

barku i javës – mesi i javës

b - fjala *këmbë*

këmbët e urës – metaforë

gjatësia e tij ishte rreth tre këmbë(njësi matëse)

c - fjala *kokë*

koka e punës – fillimi i punës

bën me kokë të vet – indipendent, i pavarur

koka e gozhdës – pjesa e sipërme e gozhdës

koka e grupit tonë - udhëheqësi, prijësi, truri

Ashtu si edhe në gjuhë të tjera edhe në gjuhën shqipe është shumë e domosdoshme puna me fjalorin, për të ndihmuar nxënësit që të shprehin sa më mirë mendimet dhe emocionet. Siç vëmë re fjalët e veçuara më sipër kanë si tipar dallues kuptimin figurativ, duke iu nënshtruar edhe kupimeve të dyta ose të treta sipas përdorimit. Edhe në grupet e mëposhtme të fjalëve kemi përdorimin e figurshëm të fjalëve dhe kuptimi i tyre del gjithnjë një mbiemër:

me zemër të hapur – i sinqertë

i bërë bishë - i egërsuar

me bisht në shalë - i turpëruar

me mend në kokë - i zgjuar

është për të nxjerrë sytë - e shkathët, çapkëne

Duke pasur si materiale bazë për studimin tonë tekstet shkollore, të cilat do të jenë burimet themelore për të vëzhguar njohuritë mbi frazeologjinë dhe të dhënat rreth saj në këto tekste në mënyrë graduale dhe më konkretisht në tekstin mësimor të Gjuhës shqipe të klasës së shtatë, nxënësi mëson të dallojë fushat leksikore të grupeve të fjalëve:

Psh : fusha leksikore kafshë

kafshë uji (peshk, fokë, delfin, breshka uji etj)

kafshë të egra (ujku, dhelpira, çakalli, ariu etj)

kafshë shtëpiake (qeni, pula, macja, derri, delja, lopa, dhia etj)

kafshë njëthundrakë (kali, mushka, gomari etj)

kafshë dythundrakë (delja, dhia, lopa etj)

insekte (flutur, mizë, karkaleci, bulkthi etj)

shpendë (zogu, bilbili, shqiponja, qyqja, dallëndyshja etj)

Këtu nxënësi njeh dhe plotëson emrat e kafshëve në bazë të njohurive të marra deri më tani nga lëndë të tjera si Biologjia, Gjeografia dhe Dituria Natyre duke i klasifikuar sipas kllasterit në tekst ³⁰.

Në këtë pjesë nxënësi i zgjeron njohuritë duke u aktivizuar për të plotësuar vendet vakante në kllaster, me njohuri ndërlëndore.

Megjithëse në tekstet shkollore respektohen njohuritë në bazë të shkallëve të vështirësisë në vëmë re se nxënësit marrin njohuri të bollshme rreth frazeologjisë dhe fushës leksikore të fjalëve si në shembullin e fushës leksikore të fjalës ngjyrë dhe marrëdhëniet mes këtyre fjalëve dhe njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore si:

ngjyrë e bardhë - e bardhë si bora (shumë i bardhë)

ngjyrë e verdhë - i verdhë si limoni (shumë i verdhë)

ngjyrë gri (e hirtë) – dukej si hiri (i mërzhitur)

ngjyrë e kuqe (e purpurt) – si mollë e kuqe flakë (e skuqur, e turpëruar)

ngjyrë e kuqe (si gjaku) – si flamuri ynë (shumë e kuqe)

ngjyrë jeshile (e gjelbër) – dukej jeshil si bari (i trembur, i mërzhitur)

ngjyrë blu (e kaltër) – me sy të kaltër si deti (të kaltër)

ngjyrë lejla (manushaqe) – mori ngjyrë manushaqe (i trembur)

ngjyrë rozë (trëndafili) – si mollëzat e saj ngjyrë rozë (e shëndetshme)

ngjyrë e zezë - u bë blozë e zezë (tepër i zi, i mërzhitur shumë)

³⁰ Teksti i Gjuhës Shqipe klasa e shtatë, Shtëpia botuese Albas fq. 268

Studimi i fjalëve të së njëjtës fushë leksikore bën të mundur edhe pasqyrimin e marrëdhënieve mes fjalëve të kësaj fushe leksikore, nëse ato janë përfaqësuese;

- të së njëjtës klasë (emër, mbiemër, folje);

Vetëm në tekstin e Gjuhës shqipe së klasës së tetë³¹ pasqyrohet përkufizimi rreth frazeologjisë dhe veçoritë e njësive frazeologjike. Ky informacion u përgjigjet pyetjeve: Ç'është frazeologjia gjuhësore dhe frazeologjia letrare? Ç'janë njësitë frazeologjike? Si klasifikohen njësitë frazeologjike?

Në këtë nxënësit marrin informacionin e nevojshëm rreth njësive frazeologjike duke sjellë edhe shembuj me ushtrime për identifikimin e njësive frazeologjike. Ndërsa po në këtë tekst shkollor nxënësi njihet me veçoritë e njësive frazeologjike:

a) njësitë frazeologjike funksionojnë në gjuhë si një fjalë e vetme psh:

me buzë të varura = i vrenjtur, i ngrysur, i mërzitur

daulle e shpuar = llafazan, fjalaman

b) njësitë frazeologjike kanë rend të ngulitur psh:

si sytë e ballit = të shtrenjtë

me buzën në gaz = i gëzuar

Informacioni rreth frazeologjisë dhe njësive frazeologjike vjen duke u zgjeruar dhe duke u plotësuar vazhdimisht edhe me shembuj edhe me ushtrime, sipas programit metodik dhe aftësive të nxënësve dhe mundësive të identifikimit të njësive frazeologjike në tekstet letrare.

³¹ Teksti i Gjuhës Shqipe klasa e tetë, Shtëpia botuese Albas fq. 224 - 225

Njësitë frazeologjike kanë përgjithësisht kuptim të figurshëm dhe ato gjenden edhe në gjuhën e folur, në letërsinë e shkruar dhe në krijimtarinë gojore.

Si klasifikohen njësitë frazeologjike? Njësitë frazeologjike klasifikohen në njësi frazeologjike; emërore, mbiemërore, ndajfoljore dhe foljore.

- a) emërore - ëndrra në diell (ëndrra të kota)
- b) mbiemërore – me mend në kokë (i zgjuar)
- c) ndajfoljore – kodra pas bregut (kot)
- d) foljore – më la me gojë hapur (u çudita)

Njësitë frazeologjike që janë të pasqyruara në shembujt e mësipërm përcjellin ngjyrimet emocionale (gëzim, hidhërim, përbuzje etj). Ato lidhen me fushën konceptore, me fushën semantike dhe me fushën leksikore të fjalëve. Fjalët e gjuhës shqipe që kanë më tepër ngjyrim emocional janë:

- njësitë frazeologjike – i hurit dhe i litarit , me buzët varur, ka lakra në kokë etj
- fjalë që shënojnë cilësi – e mirë, i keq, i bukur, mirësi, ligësi etj
- emra kafshësh, lulesh, bimësh, sendesh që kanë një tipar të dallueshëm si; flutur, dhelpër, gur, shkëmb, ari, plep, lis etj.

Në tekstin e klasës së nëntë njësitë frazeologjike trajtohen më gjerësisht dhe më imtësisht se në tekstet mësimore të klasave pararendëse, meqënëse edhe nxënësit janë më të plotësuar me njohuritë e deritanishme dhe janë të aftë edhe të hartojnë tekste (në orët e punëve me shkrim) tek të cilët ata mund të përdorin njësitë frazeologjike të mësuara në ligjërimin e përditshëm ose nga tekstet shkollore.

Po në tekstin e klasës së nëntë pasqyrohet dhe përkufizimi i njësisë leksikore ‘fjalë’ dhe veçoritë e vlerat e saj si edhe prejardhjen e kuptimeve leksikore. Në këtë tekst shkollor argumentohet me shembuj konkretë sesi pasqyrohen në leksik ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore, teknologjike, ekonomike të një vendi. Me kalimin e kohës disa fjalë dalin nga përdorimi dhe zëvendësohen me fjalë të reja, ose ndryshojnë duke fituar kuptime të reja.

Edhe njësitë frazeologjike si pjesë e rëndësishme e ligjërimit gjuhësor ashtu si vetë gjuha që është në lëvizje të vazhdueshme, ndryshojnë duke u pasuruar ose duke u transformuar vazhdimisht. Në tekstet shkollore njohuritë rreth njësive frazeologjike janë përgjithësuese, por megjithëkëtë njohuritë shfrytëzohen edhe nga përdorimi në ligjërimitin e zakonshëm gjatë bisedave të përditshme, por edhe në tekstet të hartuara nga vetë nxënësit, sidomos në në orët e Punëve me shkrim (esetë). Njësitë frazeologjike meqenëse përdoren kryesisht në kuptimin e tyre të figurshëm shpesh kuptimi i tyre del nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse duke arritur në një kuptim të vetëm (mbiemëror) si në rastet e mëposhtme:

me zë të çjerrë - i ngjirur,

me mend në kokë - i ditur,

me buzën në gaz – i qeshur,

i bërë xurxull - i dehur,

me bisht në shalë - i turpëruar,

nuk ka pikë yndyre – i pacipë,

nuk i vjen era njeri – harbut,

ishte me dy fytyra – hipokrit etj

Në shumë raste kuptimi i njësish frazeologjike mbiemërore del kryesisht nga një tipar i shpendit, kafshës ose insektit, duke i dhënë të gjithë njësish kuptimin sipas cilësië dalluese të shpendit a të kafshës (kjo kuptohet përdoret në mënyrë figurative, alegorike) sepse ato u adresohen njerëzve). Prandaj në shembujt e mëposhtëm vërejmë disa raste të tilla , psh:

u bë flutur – e lehtë, e shpejtë

është këmbë mize – e dobët, hollake

u bë pulë - i urtë, i qetë

u bë lepur – i shpejtë

u bë derr – i mërziur

është skile – dinak, i djallëzuar

është arushë mali – i fuqishëm, guximtar

është bagëti e trashë - i paditur, i trashë, budalla

është bari pa bagëti – i vetmuar

ka maçokun në bark – zemërligë

e ka gojën bilbil – gojëtar, gojëmbël

është bisht qeni – njeri i keq, i pandreqshëm

nxjerr dhjamë nga pleshti – dorështrënguar

është bletë shkëmbi – i padobishëm

është bollë e vrarë - e lodhur, e këputur

u bë breshkë - i ngadaltë, i ngathët

e zë demin nga brirët - është i zoti

sikur i ka ngrënë gomari bukën, sikur i ka ngrënë macja brumin – i mërziur

as me buaj e as me qe – i pavendosur

buf kënete – i ngathët, i mefshtë
 i ha pula bukën – ngordhalaq, i pazoti
 si koka e gomarit – e trashë
 sikur lan kokën e gomarit – mosmirënjohës
 është cironkë - e dobët
 s'është çjap për atë zile – i paaftë për atë punë
 është derr me zile – shumë i trashë
 i thotë derrit dajë - servil
 si dash me këmborë - i shquar, i njohur, krenar
 është bërë dele – i thinjur, flokëbardhë
 dele e zezë - njeri i keq
 është derr në kotec – i mbyllur, i rrethuar
 ka dhelprën në bark – shumë i zgjuar
 është dhelpër plakë - dinak, i sprovuar
 është dhi e egër – e shkathët
 është keckë mali - çapkëne, e gjallë, e zgjuar
 është dhi e zgjebosur dhe bishtin përpetë - e pavlerë
 qibri në qiell dhe b...në diell (dialektore) – i pavlerë dhe mendjemadh
 është turi derr – i keq
 i kanë hyrë grerëzat – i shqetësuar, i lëvizshëm
 me një grusht miza – i zemëruar
 si gjeli majë plehut – mendjemadh
 si gjeli mbi thekër – i papërmbajtur

si gjeli mbi vezë - i shqetësuar
i kanë hipur kacabujtë - e nevrikosur
ka rënë edhe nga kali – i sprovuar
është kalë pa fre – i shfrenuar
është kalë karroce – i drejtë, i padjallëzuar
është kërriç gomari – i papjekur
i ka hyrë krimbi – i shqetësuar
ka zënë krimba – e pisët, e fëlliqur
është bërë lepur – i dobët
i ka hyrë lepuri në bark – i frikësuar
e kishte lëpirë lopa – i pispillosur
s'ë ha as qeni – e keqe
është nga ata që të lidh macen – koprac
është mace e zezë - njeri i keq
është maçok me brirë - shumë i prapë
si miu në çark – i mbyllur
është mi gjirizesh – i ndyrë
ka mizën nën kësulë - fajtor
rrëshqet si ngjalë - dredharak
nuse lale është - e shkathët, e zhdërvjellët
zë peshk në bar – i shkathët
është si këmbët e pulës – e ngatërruar
si pulë e lagur – e frikësuar

është qen i rrahur – i zbutur
 s'ka ku ta kapë qeni – leckaman
 si qeni në qerre – i kapardisur
 është qen rojë - i besuar
 është qen i zgjidhur nga zinxhiri – i tërbuar
 është qen zorrësh – i poshtër, i ulët
 është qumësht dallëndysheje – më i mirë, i rrallë
 i dhimbset edhe qyqes – i mjerë
 s'ia qeni shkopin – shumë i zoti
 ka parë ujkun që i vogël – i rrahur me jetën
 ujk pa dhëmbë - i pazoti
 si vezët e qyqes – të shpërndarë
 është zog pa pupla – i pambrojtur
 është zog dallëndysheje – i brishtë
 si zogjtë e korbës – të shpërndarë
 aty ha pula gurë - të varfër
 nuk ka çfarë ha miu pas darke – shumë të varfër
 aty miu nuk gjen as kripë - shumë të varfër
 i fluturon gomari me gjithë samar(dialektore) – mendjelehtë

Siç shihet struktura e njësive frazeologjike mbiemërore ka në të shumtën e rasteve strukturë togfjalëshi me modelin *folje + emër* ose *emër + emër* tek të cilat bëhen pjesë edhe parafjalët dhe mbiemrat. Larmia e strukturave të njësive frazeologjike janë frut i lidhjeve kuptimore dhe gramatikore që ofron gjuha shqipe. Krahas njësive frazeologjike me burime

fjalësh të botës shtazore në gjuhën shqipe hasen edhe shumë përdorime të njësive

frazeologjike me vlerë mbiemërore me burime fjalësh të botës bimore të tilla si;

i gjatë si plepi – shumë i gjatë

është bar i keq (farë e keqe) – njeri i keq

pemë pa kokrra – i padobishëm

është fije kashte – i hollë

është me lakra në kokë - i prapambetur

është kashtë e kokrra – të shpërndarë

fluturon me presh – mendjehetë

bëhet kulpër – servile

është tre kokrra në degë dhe dy në majë - i papjekur

si maçoku në thekër – mendjemadh

është i ushqyer me arra – i majmë, i shëndoshë

është si kalli misri – i shëndetshëm

shëtit lule më lule – i pamoralshëm

është kopsht me lule – e bukur

është e kuqe si mollë - e shëndetshme

ishte si selvi – e gjatë dhe e bukur

bathë e mbirë në rrugë - i vetëm

e ka gjuhën lëpjetë - llafazan

fle mbi dafina – i vetëkënaqur

ka rënë nga fiku – i sprovuar

bluan egjër – i varfër

është filiz – shumë i ri
 i bërë spec në fytyrë - i turpëruar
 është gjethe fiku – e ashpër
 si gjeli në majë të plehut – i vetëkënaqur
 sikur ka pirë hashash – i trullosur
 është karabush – budalla, mendjelehtë
 nuk hahet as me hudhra – e keqe
 është (mbeti) kalli – i vetëm
 është karafil nga mendja – mendjelehtë
 është si kokrra e mollës – e mirë, e shëndetshme
 të merr kokrrën e melit – shumë i shkathët
 nuk e ha atë kokërr ulliri (kumbull) – i zgjuar (nuk bie në kurth)
 është kungull nga mendja (s'ia pret kungulli) – i trashë
 shkel mbi dafina – i lavdishëm, i vlerësuar
 grin lakra – llafazan
 kokën me lule b...me curle(lecka-dialektore) – mendjemadh, kokëbosh
 ishte bërë labot – i zverdhur, i dobësuar
 lëmë pa drithë - i padobishëm
 është lëng gështenjash – e hollë, e keqe
 është lëng groshe – i pavlerë
 u bë si lule kungulli – i verdhë
 është lis me degë - njeri i zoti
 bëhet luledielli – i paqëndrushëm

i ka mendtë në majë të thanës – mendjelehtë

është tre mel tre sel (dialektore) – i trashë nga mendja

një në majë e asnjë në degë - mendjelehtë

shet gorrica – mendjemadh

i lulëzon pjepri në shënëndre – mendjelehtë

është rrush aguridhe – i papjekur

grin sallatë - llafazan

këtu pula ha ullinj (dialektore) – vend i pasur, bereqetli

Në këto njësi frazeologjike emri i bimës përfaqëson në tërësi bimën dhe në ndonjë rast kuptimi i njësisë përfaqësohet vetëm nga një tipar i bimës. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore e shfaqin kuptimin e tyre edhe vetëm nga një tipar i jashtëm i bimës ose nga një subjekt veprimi në lidhje me bimën.

3.6. Vëzhgime dhe anketime në shkolla

Numri i të anketuarve në të pesë shkollat gjithsej ishte 1.417 nxënës ;

nga këta 1057 nxënës në qytet dhe 360 nxënës në fshat; nga këta 727 nxënës të shkollës së mesme dhe 690 nxënës të shkollës 9- vjeçare.

Nga vëzhgimet e ndërmarra si mësuese e gjuhës dhe e letërsisë kam patur mundësinë e hulumtimit dhe të anketimit gjatë procesit mësimor, të përdorimit nga nxënësit e këtyre shkollave të njësive frazeologjike, si në mësimnxënie, ashtu edhe në mundësinë e përdorimit të njësive frazeologjike në punët me shkrim – esetë.

Duke qënë e angazhuar me temën kam bërë përpjekje për të sjellë edhe pasqyrimet përkatëse për grupmosha të veçanta përdorime të njësive frazeologjike, si edhe elemente të veçanta të tyre.

Tabelat nr. 1

Anketimi i nxënësve sipas klasave dhe përdorimi i njësive frazeologjike në Punët me shkrim (esetë) për numër njësish.

Shkolla e bashkuar "Gosë" (cikli 9-vjeçar) – tetor 2013

<i>Nx. gjithsej</i>	<i>klasat</i>	<i>2 njësi</i>	<i>3 njësi</i>	<i>4 njësi</i>	<i>5 njësi</i>
36 nxënës	6-ta	21 nxënës.	11 nxënës.	4 nxënës.	-
28 nxënës.	7-ta	12 nxënës.	13 nxënës.	2 nxënës.	1 nxënës.
29 nxënës.	8-ta	11 nxënës.	8 nxënës.	6 nxënës.	1 nxënës.
32 nxënës.	9-ta	14 nxënës.	13 nxënës.	3 nxënës.	2 nxënës.

Shkolla e bashkuar "Gosë" (cikli i mesëm) - tetor 2013

<i>Nx . gjithsej</i>	<i>klasat</i>	<i>2 njësi</i>	<i>3 njësi</i>	<i>4 njësi</i>	<i>5 njësi</i>
81 nxënës.	10-ta	46 nxënës.	21 nxënës.	12 nxënës.	2 nxënës.
81 nxënës.	11-ta	43 nxënës.	28 nxënës.	8 nxënës.	2 nxënës
73 nxënës.	12-ta	32 nxënës.	27 nxënës.	16 nxënës.	2 nxënës.

Shkolla 9-vjeçare "Qamil Gjuzi" – tetor 2013

<i>Nx. gjithsej</i>	<i>klasat</i>	<i>2 njësi</i>	<i>3 njësi</i>	<i>4 njësi</i>	<i>5 njësi</i>
66 nxënës.	6-ta	48 nxënës.	16 nxënës	2 nxënës.	-
67 nxënës	7-ta	32 nxënës.	24 nxënës.	8 nxënës.	3 nxënës.
75 nxënës.	8-ta	28 nxënës.	32 nxënës	11 nxënës.	4 nxënës.
67 nxënës.	9-ta	22 nxënës.	30 nxënës.	14 nxënës.	3 nxënës

Shkolla 9-vjeçare “Xhorxh Soros”- tetor 2013

<i>Nx. gjithsej</i>	<i>klasat</i>	<i>2 njësi</i>	<i>3 njësi</i>	<i>4 njësi</i>	<i>5 njësi</i>
<i>72 nxënës.</i>	<i>6-ta</i>	<i>43 nxënës.</i>	<i>26 nxënës</i>	<i>3 nxënës</i>	<i>-</i>
<i>59 nxënës.</i>	<i>7-ta</i>	<i>32 nxënës.</i>	<i>22 nxënës</i>	<i>3 nxënës.</i>	<i>2 nxënës</i>
<i>90 nxënës.</i>	<i>8-ta</i>	<i>35 nxënës.</i>	<i>38 nxënës</i>	<i>12 nxënës.</i>	<i>5 nxënës.</i>
<i>69 nxënës.</i>	<i>9-ta</i>	<i>19 nxënës.</i>	<i>34 nxënës.</i>	<i>13 nxënës.</i>	<i>3 nxënës</i>

Shkolla e mesme e përgjithshme “Haxhi Qehaj”- tetor 2013

<i>Nx . gjithsej</i>	<i>klasat</i>	<i>2 njësi</i>	<i>3 njësi</i>	<i>4 njësi</i>	<i>5 njësi</i>
<i>161 nxënës.</i>	<i>10-ta</i>	<i>87 nxënës.</i>	<i>34 nxënës</i>	<i>28 nxënës</i>	<i>12 nxënës.</i>
<i>159 nxënës.</i>	<i>11-ta</i>	<i>69 nxënës.</i>	<i>42 nxënës.</i>	<i>36 nxënës</i>	<i>22 nxënës</i>
<i>172 nxënës.</i>	<i>12-ta</i>	<i>62 nxënës.</i>	<i>55 nxënës</i>	<i>34 nxënës</i>	<i>21 nxënës.</i>

Në shkollat e mesipërme janë bërë vëzhgime të punëve me shkrim, duke qenë se vëzhgimi është pjesë e rëndësishme e studimit social-pedagogjik dhe u vu re se niveli i përvetësimit dhe përdorimit të njësive frazeologjike nga nxënësit vjen duke u rritur nga klasa më e ulët tek ajo më e larta, ashtu siç e kërkon edhe vlera e informacionit dhe qartësia që përcjell teksti mësimor për secilën klasë, duke respektuar veçoritë e moshave, nivelin e njohurive etj. Përzgjedhja e informacionit shkencor në mënyrë të kujdesshme dhe sipas nivelit të dijeve u serviret nxënësve në tekste, por atyre u rekomandohet edhe përdorimi i fjalorëve të ndryshëm gjuhësorë. Nga vëzhgimi vumë re se nga 1.417 nxënës të vëzhguar vetëm 474 (më pak se gjysma e nxënësve) prej tyre përdorin *tre* njësi frazeologjike në punët me shkrim (ese-të) dhe 300 nxënës përdorin *katër* dhe *pesë* njësi frazeologjike në një tekst eseistik. Është vënë re se gjuha e nxënësve është shumë e larmishme, kjo duke u nisur nga

vetë fakti se të rinjtë përdorin një pafundësi shprehjesh dhe fjalësh në varësi të mjedisit social-kulturor, nivelit, gjuhët që zotërojnë, ambjentit familjar prej nga vijnë etj. Nxënësit e përdorin mjaft mirë gjuhën, njësitë frazeologjike edhe në zhargonin e tyre, si një gjuhë të fshehtë që kuptohet vetëm nga ata dhe nga asnjë individ tjetër jashtë grupit. Për këtë arsye u bënë edhe anketime. Anketat u shpërndanë në të gjitha nivelet. Me këtë rast gjej mundësinë të falenderoj mësuesit që më mundësuan kryerjen e tyre brenda klasave të tyre, nxënësit dhe drejtorët e shkollave. Pyetësi përmban rreth 10 pyetje formën e së cilës do ta paraqesim më poshtë. Pyetjet përqëndrohen në; a) vendi që zënë njësitë frazeologjike në të folmen e tyre dhe b) ndikimi i zhargonit mbi gjuhën letrare dhe njësitë frazeologjike

3.6.1. Modeli i pyetësorit dhe gjetjet

Pyetësi është i tipit eksplorator për të kuptuar dhe analizuar gjetjet mbi përdorimin e njësive frazeologjike nga shkollarët. Qëllimi i këtij anketimi është të mbledhim informacion për efikasitetin e përdorimit të frazeologjizmave dhe lidhjen mes këtyre variablave. Pyetësi u përshtat me grup-moshat e shkollarëve për të patur informacion sa më vlefshëm dhe më cilësor.

1. A përdorni njësi frazeologjike gjatë ligjërimit të përditshëm?
 - a. Gjithmonë
 - b. Ndonjëherë
 - c. Asnjëherë
2. Në fjalorin tuaj pjesën më të madhe e zënë njësitë frazeologjike me vlera negative, apo me vlera pozitive, dashamirëse?
 - a. E para
 - b. E dyta

- c. Të dyja rastet
3. Ju pëlqen të përdorni fjalë të vjetra (ose dialektore) gjatë komunikimit/ të folurit?
- a. Po - gjithmonë
 - b. Jo - asnjëherë
 - c. Ndonjëherë
4. Në çfarë mjedisi parapëlqeni t'i përdorni njësitë frazeologjike gjatë komunikimit tuaj?
- a. Në shtëpi
 - b. Në shkollë
 - c. Vetëm me miq të ngushtë
5. Mendoni se njësitë frazeologjike janë të rëndësishme për të komunikuar me të tjerët?
- a. Ndonjëherë
 - b. Asnjëherë
 - c. Gjithmonë
6. A mendoni se një folës ka kulturë gjuhësore të gjerë kur gjatë bisedave përdor shpesh edhe njësi frazeologjike?
- a. Po
 - b. Jo
 - c. Ndoshta
7. Të nxitin moshatarët të përdorësh bashkë me gjuhën edhe njësi frazeologjike?
- a. Gjithmonë
 - b. Asnjëherë

c. Me raste

8. Mendoni se zhargonet apo gjuha e grupit ndikon mbi njësitë frazeologjike?

a. Po / gjithmonë

b. Jo/ asnjëherë

c. Me raste

9. Sa e gjeni veten në zhargonin shkollor që përdorni duke ndryshuar edhe njësitë frazeologjike?

a. Shumë

b. Pak

c. Aspak

10. Cilat janë disa nga fjalët më tipike/më të përdorshme të moshës suaj?

Shkruani disa prej tyre .

Pas anketimeve dhe sondazheve të zhvilluara në të cilat u përfshinë 1.417 nxënës, u shqyrtuan rezultatet dhe u vlerësuan me përqindje edhe përdorime të njësive frazeologjike nga të anketuarit. U evidentuan përgjigjet e pyetësorit dhe u analizuan gjetjet, të cilat u grupuan sipas rezultateteve në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr. 2 / 1 (pyetja1)

Përdorimi i frazeologjizmave në ligjërimin e përditshëm	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Gjithmonë	349	204	39
Ndonjëherë	276	371	46
Asnjëherë	102	115	15

Tabela nr. 2 / 2 (pyetja 2)

Përdorimi i frazeologjizmave në ligjërimin e përditshëm	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Në vlera pozitive/ dashamirëse	478	293	55
Në vlera negative	191	227	29
Edhe negative, edhe dashamirëse	58	170	16

Tabela nr. 2 / 3 (pyetja 3)

Përdorimi i fjalëve të dialektit në ligjërimin e përditshëm?	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Gjithmonë	198	302	35
Asnjëherë	247	157	29
Ndonjëherë	282	231	36

Tabela nr. 2 / 4 (pyetja 4)

Njësitë frazeologjike i përdorni më shpesh	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Në shtëpi	321	268	42
Në shkollë	207	153	25
Vetëm me miq të ngushtë	199	269	33

Tabela nr. 2 / 5 (pyetja 5)

Sa të rëndësishme janë njësitë frazeologjike?	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Ndonjëherë	229	177	29
Asnjëherë	12	23	2
Gjithmonë	486	490	69

Tabela nr. 2 / 6 (pyetja 6)

Ka kulturë gjuhësore një folës që përdor shpesh njësitë frazeologjike?	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Ndoshta	113	268	27
Jo	2	9	1
Po	612	413	72

Tabela nr. 2 / 7 (pyetja 7)

Keni patur nxitje nga moshatarët tuaj për të përdorur edhe njësitë frazologjike?	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Me raste	313	285	42
Asnjëherë	5	18	2
Gjithmonë	409	387	56

Tabela nr. 2 / 8 (pyetja 8)

Zhargoni shkollor ndikon mbi njësitet frazeologjike	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Me raste	379	441	58
Asnjëherë	89	25	8
Gjithmonë	259	224	34

Tabela nr. 2 / 9 (pyetja 9)

Sa e gjen veten në zhargonin shkollor?	Nxënësit e gjimnazit 10-12	Nxënësit e klasave 6-9	%
Pak	295	304	42
Shumë	347	295	45
Aspak	85	91	13

Pyetja 10 /është e pasqyruar me shembuj të shprehjeve frazeologjike nga zhargoni studentor i cili është mjaft i pasur edhe me shprehje frazeologjike, sepse gjatë anketave vumë re shprehje të ndryshme që secila grup moshë përdor në komunikim me moshatarët e tyre.

Më poshtë po pasqyrojmë disa nga fjalët dhe shprehjet e përdorura prej tyre;

është lopë race – një shoqe që është shumë e shëndoshë

është si qyp - i shëndoshë dhe i mefshtë

është nëntëdhjetë e nëntsh – i poshtër

është elektron i lirë - i papërmbajtur, i lëvizshëm
ta heq CD (trurin) – e palogjikë, e tmerrshme
nuk i kap mirë radari – i mefshtë
i var noçkat (turinjtë) – i zemëruar
i dalin mendtë sipër ekstejshënit (flokëve) – budallaqe, mendjelehtë
flet përçart (broçkulla) – i paqartë që flet pa lidhje logjike
u bë telenovelë - i gjatë dhe i mërzitshëm
është si lopë larë - e pakujdesshme, i lë orenditë vend e pa vend
i ka marrë koka superxhiro – i tërbuar nga zemërimi
më heq zarin (trurin) – (është) i papërgjegjshëm
është miss eleganca – shumë e dobët
ai të skanon trurin (mendimet) – inteligjent
është minë me sahat – gjaknxhtë

Në këtë studim përmes vëzhgimeve të orëve si mësuese kam vërejtur se në tekstet mësimore të Gjuhës shqipe në klasat 6, 7, 8, 9^{-të} njohuritë rreth frazeologjisë dhe njësive frazeologjike vijnë duke u plotësuar dhe duke u shtuar, ndërsa në tekstet e klasave më të larta (në klasat e 10 - 12) nuk preket fare ky term, madje nuk ka as orë të veçanta mësimore, në të cilat nxënësi të përsëritë njohuritë e përfutuara në tekstet mësimore të klasave 6, 7, 8, 9^{-të}.

Kështu i mbetet vetëm mësuesit të tregohet i kujdesshëm që herë-herë të identifikojë njësitë frazeologjike në pjesët e shkëputura nga letërsia artistike ose të përsëritë bashkë me nxënësit njohuritë rreth frazeologjisë.

Sugjeroj se është e tepër e rëndësishme që në tekstet e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë për shkollat e mesme të riprezantohen njohuritë rreth frazeologjisë dhe njësive frazeologjike, në dobi të punës së mësuesve dhe të nxënësve.

Mendoj se është e domosdoshme që njohuritë rreth frazeologjisë të pasqyrohen edhe në tekstet e shkollës së mesme, sepse nxënësi aftësohet në përdorimin më të saktë dhe më të drejtë të njësive frazeologjike.

3.6.2. Përpunimi i të dhënave dhe pritshmëritë

Të dhënat e mbledhura në këtë punim përmes vëzhgimeve, anketimeve, hulumtimeve dhe gjetjeve në tekstet e Gjuhës shqipe (teksteve letrare, fjalorëve) janë përpunuar me kujdes në mënyrë që të përcaktoheshin qartë edhe temat e këtij punimi.

Ky studim pritet të vërtetojë që në tekstet mësimore të Gjuhës shqipe në klasat e 6-të - 12-të pasqyrohet në nivel të ulët informacioni për njësitë frazeologjike dhe si pasojë edhe përvetësimi i tyre prej nxënësve, është në një nivel të ulët.

Themi në nivel të ulët, sepse në Planet Mësimore orët për Leksikologjinë janë shumë të pakta në numër për sasi orësh gjithsej, kuptohet që specialistët kanë pikëvështirimin e tyre.

Orët për Leksikologjinë janë shpërndarë sipas tabelës:

Klasat	Orë mësimore gjithsej	Orë Leksikologjie
Klasa e 6 -të	175	3
Klasa e 7 -të	175	6
Klasa e 8 - të	175	4
Klasa e 9 -të	175	5

Studimi synon të sjellë argumente nga ana teorike, për të kuptuar sesa të rëndësishme janë njësitë frazeologjike në pasurimin e gjuhës. Me anë të këtij studimi do të evidentojmë disa njësi frazeologjike, të cilat përdoren nga të rinjtë si zhargon studentor, të ndërtuara sipas modeleve që ofron gjuha shqipe, po kështu kemi pasur në vëmendjen tonë edhe shembuj të urimeve dhe të mallkimeve.

3.6.3. Disa modele ushtrimesh rreth frazeologjizmave (sugjerime)

Përdorimi i njësive frazeologjike në ligjërimin e përditshëm është një pasqyrim i kulturës, koncepteve ose mendimeve të ngulitura në gjuhë. Për të pasur mundësi që këto njësi frazeologjike të gjejnë përdorimin me po aq fanatizëm edhe nga brezat pregatiten ushtrime gjatë procesit mësimor.

Ushtrimi 1. Gjeni cilës fushë leksikore i përkasin këto fjalë:

- makinë, timon, frena, semafor, regulla, polic
- turist, bagazhe, avion, biletë, orar nisjeje, mbërritja
- libër, shënjues, punonjëse biblioteke
- topi, fusha, arbitër, faull

Ushtrimi 2. Vendosini në dy kolona sipas fushave leksikore përkatëse fjalët e mëposhtme: dhelpër, pulë, patë, rosë, ujk, dele, lopa, ariu, lejleku, gjeli, harabeli, shqiponja, derri, qengji, dhia, zogu, dallëndyshja, bufi, luani, tigri.

Ushtrimi 3. Plotësoni fushat leksikore të mëposhtme me sa më shumë fjalë:

mësim _____

veshje _____

filma për fëmijë _____

lojëra për fëmijë _____

Ushtrimi 4. Nënvizoni fjalën që përfaqëson fushën leksikore në rreshtat e fjalëve:

e bardhë, i kuq, ngjyra, kafe, jeshile, blu, e zezë, rozë

lule, vjollcë, manushaqe, mimoza, trëndafil, luleborë, karafil

lajme, filma, emisione, televizor, festival, sport

telefon, lavatriçe, hekur, frigorifer, kompjuter, elektro-shtëpiake

Ushtrimi 5. Në tekstin e mëposhtëm identifikoni njësitë frazeologjike dhe përcaktoni llojin e tyre.

Si e kish zënë të thënë, ashtu edhe të rrojturit : si mos o zot! Qeni rronte më mirë, sepse qeni s'kish zemrën e të zot!

- Ah, un' i mjeri , - thosh (se fliste vete, me zë) – ah, un' i mjeri do vdes për bukë! Ja, shiko, grunjat e fqinjit sa të plota janë! Pa shiko gjën' e gjallë...

Edhe kështu mër-mër-mër nat' e ditë qante sytë e këmbët, në vend që të hajë me lugë floriri. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.217)

Ushtrimi 6. Formoni nga dy fjali për secilën shprehje frazeologjike në të cilat ajo të përdoret njëherë në fillim të fjalisë dhe njëherë në mes të saj. A ka ndonjë ndryshim në kontekstet e përdorura? (Arsyetoni me ndihmën e mësuesit).

s'ia vlente barra qeranë, nga i thati digjet i njomi, fshati që duket s'do kallauz, për një plesht djeg jorganin, e ka zemrën flori, me mustaqe një pëllëmbë, nuk çan kokë.

Ushtrimi 7.

Renditni disa shprehje frazeologjike që kanë në trup të tyre fjalët e mëposhtme dhe thoni llojin e tyre: *gojë, kokë, zemër.*

Ushtrim 8. Plotësoni me fjalë të tjera fushat leksikore të mëposhtme:

- pemë

- lule
- profesion
- vegla pune

Ushtrim 9. Ndërto për secilën fjalë të veçantë një familje fjalësh:

- kohë
- ndërtesë
- gjuhë
- mjet informimi
- mjet transporti

Ushtrim 10. Formoni fjali me njësitë frazeologjike të mëposhtme:

m'u bë gjaku ujë, u bë miza buall, e ka gjuhën shpatë, m'u bë zemra kallkan, dhëlpër plakë, e ka halë në sy, i vuri gishtin kokës.

Ushtrim 11.

Gjeni për secilën njësi frazeologjike fjalën gjegjëse sinonimike të saj:

m'u bë zemra mal, u bë derr, nuk ia ha qeni shkopin, shtatin pyll e mendjen fy(e)ll, s'ia bën syri tërr.

Ushtrim 12. Bëni një krijim ku të përshkruani stinën që ju pëlqen dhe përdorni sa më shumë njësi frazeologjike.

Ushtrim 13. Lidhni me shigjetë njësitë frazeologjike me fjalët sinonimike përkatëse:

ha bukën dhe përmbys kupën	mendjemadh
mbeti qyqe	i mërzhitur
hunda e gjatë e keqja e të zot	i vetëm
rrinte me buzë e hundë	mosmirënjohës

me zemër të hapur

i turpëruar

u bë lulëkuqe

i singertë

Ushtrim14.

Ndërtoni fjali ku njësitë e mëposhtme të përdoren edhe si grupe të lira fjalësh (togfjalësha të lirë).

- tund bishtin
- i vë gishtin kokës
- s'le dy gurë bashkë
- i bie kokës me grushte
- daulle e shpuar

Ushtrim 15.

Shkruani një ese përshkruese për një person në të cilën të përdorni disa nga shprehjet frazeologjike të mëposhtme:

e ka zemrën e bardhë, të flet pa dorashka, i pret drutë shkurt, i ka duart e arta, si dritën e syve, i var buzët, me gojë hapur, e mori ferra uratën, e ka bukë me djathë, kockë e lëkurë, me zemër të hapur, nuk i veton ashka e syrit, e ka zemrën behar, lis me dega, e hapi mendjen, ia vlen barra qeranë, me buzë në gaz.

Njësitë frazeologjike janë mjet i jashtëzakonshëm i pasurimit gjuhësor, mirëpo edhe gjuha pëson ndryshimet e veta, nga grupmoshat të cilat edhe e modifikojnë psh:

të rinjtë shpeshherë njësitë frazeologjike i përdorin duke i ndryshuar ose duke i modifikuar sipas kontekstit ose mundësive që u ofron gjuha shqipe dhe dialekti (më poshtë kemi renditur disa modele të përdorimit të tyre nga të rinjtë dhe adoleshentët) psh:

fluturon me redbull (me preshe) – është mendjelehtë

e ka zemrën qelibar – të pastër
 e ka zemrën katran – të zezë, të keqe
 i var noçkat (turinjtë) – i zemëruar
 si ai me hell të bretkosës (dialektore) – i bezdisur
 si kecka me krëhërin (dialektore) – e bezdisur
 i dalin mendtë sipër ekstejshënit (flokëve) – budallaqe, mendjelehtë
 flet përçart (broçkulla) – i paqartë që flet pa lidhje logjike
 u bë telenovelë - i gjatë dhe i mërzitshëm
 si lopë larë - e pakujdesshme, i lë orenditë vend e pa vend
 ta heq CD (trurin) – e palogjikë, e tmerrshme
 nuk i kap mirë radari – i mefshtë
 i ka marrë koka superxhiro – i tërbuar nga zemërimi
 më heq zarin (trurin) – (është) i papërgjegjshëm
 miss eleganca – shumë e dobët
 ai të skanon trurin (mendimet) – inteligjent
 është minë me sahat – gjaknxehtë
 u bë drakula – i djallëzuar
 ka qimen e dërrit – i pafat
 u bë leshko fare – budalla
 të çon në det e të bie pa lagur – shumë i zoti
 është me penallti në tru – i metë, gjysmak nga trutë
 të rrëshqet (fluturon) nga duart – e shkathët, e zhdërvjellët
 m'u hapën trutë - shumë i lodhur

u bë farë grami – e shpeshtë, e dendur

është gjellë qensh – shumë e keqe

ta bën kokën daulle – i mërzitshëm, llafazan

nuk lidhet me asgjë(nuk mban fije e as kallam) - mashtrues, gënjeshtar

bën hije kot mbi tokë - i pavlerë

fut spica – ngacmues, ironik

të gërric nervat – i bezdisshëm, acarues

e kemi lakra në kopësht – të largët, të parëndësishëm

është i larë me lëng plëndësi – i pafat

Të rinjtë siç e vëmë re, janë motivuar nga formulimet e mëparshme të njësive frazeologjike dhe mundësive që u ofron shqipja, por me elemente dhe fjalë të reja që kanë nëntekst të veçantë sipas rasteve të përdorimit.

Të rinjtë si të gjithë grupet e tjera shoqërore kanë edhe elementet e veta të identifikimit (kodifikimit) me të cilat komunikojnë ose kuptohen mes tyre. Këto janë shpeshherë mjete të pasurimit të gjuhës ose mjete të shmangies nga njësia frazeologjike – tip të cilën e njohim dhe e trashëgojmë nga më të vjetrit, kjo varet nga këndvështrimi.

Gjuha është vazhdimisht në ndryshim dhe si e tillë ajo pasurohet, ndryshohet, transformohet duke pasqyruar në të mendimet, përvojat, gjendjet shpirtërore sipas këndvështrimeve të ligjëruesve ose bashkëfolësve.

Përdorimi i njësive frazeologjike të formësuara nga të rinjtë janë një pasqyrim i plotë se gjuha është një organizëm që gjallërohet dhe transformohet në marrëdhënie të pashmangshme nga ndikimet e grupit shoqëror që e përdor. Ajo është përfaqësuesja më e mirë e vlerave shpirtërore, shoqërore dhe perceptore të bashkësisë përkatëse.

3.7.1. Mallkime dhe urime me përdorim dialektor

3.7.2. Mallkime

Një rol të jashtëzakonshëm në pasurimin dhe gjallërimin e gjuhës dhe të frazeologjisë kanë edhe mallkimet edhe urimet si pjesë e ligjërit të përditshëm, por ato kanë edhe vlerë konceptuale të ideve apo mendimeve me funksion mirëdashës apo keqdashës sipas rasteve.

të vraftë qulli (dialektore) – i varfër, kjo shprehje frazeologjike përdoret për të mallkuar dikë që të varfërohet aq shumë sa të mos ketë për të ngrënë gjë tjetër veç qullit

të vraftë buka ime (dialektore) – mosmirënjohës, i drejtohet dikujt që nuk është mirënjohës përndryshe *ha bukën dhe përmbys kupën*

mosgdhifsh nesër – vdeksh, kur i lut vdekjen dikujt se nuk e honeps dot

të hëngshin krimbat – e papastër, pisanjose, zakonisht mallkohet një grua kur nuk është nikoqire ose është e tillë dhe zilepset nga shoqet prandaj e mallkojnë.

u bëfshin qeroska (dialektore) – qerose (pa flokë), zakonisht mallkohen gratë të cilat kanë gatuar nëpër dasma të mëdha ose gëzime familjare dhe miqtë kanë gjetur qime në pjatë

u bëftë qyqe – e ve, e vetme (mallkohet dikush që të mbetet e vetme dhe pa njeri, sipas mendësisë shqiptare nuk ka më të mjerë se ai që nuk ka të afëm, miq apo fëmijë.

u bëftë hallonjkë (dialektore) – e çmendur (mallkimi i drejtohet një gruaje në mënyrë që ajo të çmendet ose të lajthitet)

u bëftë gazepe – i varfër, i shkretë (mallkohet dikush që të mos i mbetet më asgjë)

u bëfsh lëmsh – ngatërrestar (mallkimi i drejtohet dikujt që të hyjë në ngatërresa meqë nuk mban vendin që i takon)

mbetsh çyryk – gjysmak (mallkimi i lëshohet dikujt që të mbesë pa mend ose pa gjymtrë)

mbetsh dërrasë - i varfër, bosh, i vetëm (mallkimi i drejtohet dikujt që ka pasuri dhe e mallkojnë që të mos i gëzohet pasurisë)

mbetsh qorr – i verbër (mallkimi i drejtohet dikujt që të humbasë dritën e syve duke qenë se ajo është gjëja më e shtrenjtë)

t'u shoftë fara – steril (mallkimi i lëshohet dikujt që të mos trashëgojë fëmijë)

Ndonjëherë në trajtat e mallkimeve të shprehura me njësi frazeologjike ka edhe elemente të besimit fetar, të cilët identifikojnë edhe grupin shoqëror që përdor këto njësi frazeologjike.

Psh: *të bëftë zoti helaq* – të turpëroftë - i turpëruar (me turp)

të martë perëndia mendttë - u çmendsh – i lajthitur (pa mend)

të lëntë zoti trokë - u varfërofsh – i varfër (fukara)

të bëftë zoti gazeq – u varfërofsh – i varfër

e kish lënë Allahu pa mend – i pamend, jo i mençur, budalla

3.7.3. Urime

Njësitë frazeologjike janë domosdo edhe pasqyrim i ngarkesave të forta emocionale sidomos në mënyrën e konceptimit të urimeve ose trajtave të veçanta me ngarkesë pozitive dhe kundrejt gjithë organizimeve të ndryshme gjuhësore.

të bëftë zoti brus – i pasur, t'i shtohet pasuria, malli e gjëja e gjallë

u bëfsh mbret e shkuar mbretit – i pasur dhe i pari i vendit

u rritë djalë me mend – i mençur, i ditur

u bëfsh plak me mjekër – jetëgjatë, ky urim i jepet një fëmije të porsalindur ose ndonjë fëmije që ka ditëlindjen

u rritë si djalë dëshiri (dialektore) – i shëndetshëm e me gjithë të mirat

u shtoftë dhe u pasuroftë sa fijet e flokut në kokë - shumë i pasur

Nga vëzhgimet e ndërmarra si mësuese e gjuhës dhe e letërsisë kam patur mundësinë e hulumtimit dhe të anketimit gjatë procesit mësimor, të përdorimit nga nxënësit të njësive frazeologjike qoftë në mësimnxënie qoftë edhe në mundësinë e përdorimit të njësive frazeologjike në punët me shkrim – esetë. Duke qënë e angazhuar me temën kam bërë përpjekje për të sjellë edhe pasqyrimet përkatëse për grupmosha të veçanta përdorime të njësive frazeologjike, si edhe elemente të veçanta të tyre.

Në shkollat e mësipërme janë bërë anketime me shkrim, duke qënë se anketimi është pjesë e rëndësishme e studimit social-pedagogjik dhe u vu re se niveli i përvetësimit dhe përdorimit të njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore nga nxënësit vjen duke u rritur nga klasa më e ulët tek ajo më e larta, ashtu siç e kërkon edhe vlera e informacionit dhe qartësia që përcjell teksti mësimor për secilën klasë duke respektuar veçoritë e moshave, nivelin e njohurive etj. Përzgjedhja e informacionit shkencor në mënyrë të kujdesshme dhe sipas nivelit të dijeve u serviret nxënësve në tekste, por edhe u rekomandohet edhe përdorimi dhe shfletimi i fjalorëve të ndryshëm gjuhësorë.

Nga anketimi me shkrim vumë re se një pjesë e nxënësve të shkollave të mesme në punët me shkrim (ese-të) të zhvilluara në klasë e kishin shumë më të lehtë përdorimin e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore në komunikimin e përditshëm dhe më pak të lehtë përdorimin e tyre në një tekst eseistik, kjo edhe për vetë karakterin e temave ose të një stili më të zgjedhur komunikativ të të shkruarit.

Është vënë re se gjuha e nxënësve është shumë e larmishme, kjo duke u nisur nga vetë fakti se të rinjtë përdorin një pafundësi shprehjesh dhe fjalësh në varësi të mjedisit social-kulturor, nivelit, gjuhët që zotërojnë, ambjentit familjar prej nga vijnë etj. Nxënësit e

përdorin mjaft mirë gjuhën, njësitë frazeologjike edhe në zhargonin e tyre, si një gjuhë të fshehtë që kuptohet vetëm nga ata dhe nga asnjë individ tjetër jashtë grupit.

Zhargoni studentor është mjaft i pasur. Gjatë anketave u vunë re shprehje të ndryshme që secila grup moshë përdor në komunikim me moshatarët e tyre. Më poshtë po jap disa nga fjalët dhe shprehjet e përdorura prej tyre.

është lopë race – një shoqe që është shumë e shëndoshë

është si qyp - i shëndoshë dhe i mefshtë

është nëntëdhjetë e nëntsh – i poshtër

është elektron i lirë - i papërmbajtur, i lëvizshëm

ta heq CD (trurin) – e palogjikë, e tmerrshme

nuk i kap mirë radari – i mefshtë

i var noçkat (turinjtë) – i zemëruar

i dalin mendtë sipër ekstejshënit (flokëve) – budallaqe, mendjelehtë

flet përçart (broçkulla) – i paqartë që flet pa lidhje logjike

u bë telenovelë - i gjatë dhe i mërzitshëm

është si lopë larë - e pakujdesshme, i lë orenditë vend e pa vend

i ka marrë koka superxhiro – i tërbuar nga zemërimi

më heq zarin (trurin) – (është) i papërgjegjshëm

është miss eleganca – shumë e dobët

ai të skanon trurin (mendimet) – inteligjent

është minë me sahat – gjaknxehtë

Në këtë studim përmes vëzhgimeve të orëve si mësuese kam vërejtur se në tekstet mësimore të Gjuhës shqipe në klasat 6, 7, 8, 9^{-të} njohuritë rreth frazeologjisë dhe njësive

frazeologjike vijnë duke u plotësuar dhe duke u shtuar, ndërsa në tekstet e klasave më të larta nuk preket fare ky argument. Kështu i mbetet vetëm mësuesit të tregohet i kujdesshëm që herë-herë të identifikojë njësitë frazeologjike në pjesët e shkëputura nga letërsia artistike ose të përsëritë bashkë me nxënësit njohuritë rreth frazeologjisë.

Sugjeroj se është e tepër e rëndësishme që në tekstet e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë për shkollat e mesme të riprezantohen njohuritë rreth frazeologjisë dhe njësive frazeologjike, në dobi të punës së mësuesve dhe të nxënësve. Mendoj se është e domosdoshme që njohuritë rreth frazeologjisë të pasqyrohen edhe në tekstet e shkollës së mesme, sepse nxënësi aftësohet në përdorimin më të saktë dhe më të drejtë të njësive frazeologjike.

KAPITULLI I KATËRT

ANALIZA DHE STRUKTURA E NJËSIVE FRAZELOGJIKE ME VLERË MBIEMËRORE NË GJUHËN SHQIPE

4.1. Tipologji strukturore

Duke respektuar strukturën e ndërtimit të njësive frazeologjike të shqipes dallojmë këto organizime të njësive frazeologjike:

1) Shumica e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë strukturë togfjalëshi por disa prej tyre janë me strukturë fjalie si: *t'i presësh kokën, ta kërkossh me qiri, ha bukën përmbys kupën, për ta pirë në kupë, të qëron të bardhën e syrit* etj. Sipas rastit apo kontekstit ndonjë prej këtyre njësive frazeologjike me strukturë fjalie mund të mbarttë edhe kuptim foljor. Mjaft shprehje në trajtë fjalie që shënojnë tiparin edhe pronësinë e tiparit ndeshen nën strukturën e qëndrueshme: *ka + shprehjen që shënon tiparin (e) ka + gjuhën e gjatë.*

e ka synë pishë – trim, syptrembur

e ka mik me kokë – besnik , trim

e ka hijen e rëndë – hijerëndë, guximtar

e ka krimbin në rrënjë – e krimbur , e prishur

e ka kokën dru – i trashë

Në këtë grup takohen njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore dhe njësitë frazeologjike me vlerë foljore. Sidoqoftë në thelb vëren prof. Thomai “*në këto shprehje kemi njësi frazeologjike foljore në trajtë fjalie, (ku shprehja e tiparit pa shprehur njëkohësisht edhe pronësinë e këtij nuk mund të bëhet), por që mbartin vlera cilësuese si mbiemrat*” (Thomai, J. 1981: 87)

ka qenë rob i punës – shumë punëtor

e kishte mendjen e fjetur - i bindur

2) Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore vijnë edhe prej tipit foljor dhe në vend të gjymtyrës foljore kanë një mbiemër prejpjesor; psh : *i rrahur me vaj e me uthull, i bërë pulë, i bërë bishë, i bërë rrogoz, i bërë grusht, i qepur me pe të bardhë* etj. Siç vihet re shumica e këtyre njësive frazeologjike formohen nga ato njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë të parë një folje kryesisht pësore dhe si gjymtyrë të dytë një emër që është përdorur si krahasim.

i bërë qull – i lagur

i bërë derr – i mërzhitur

i rrahur nga era dhe shiu – i dobët

i bërë fije mëndafshi - i hollë

i bërë pulë – i urtë, i qetë

e djegur nga ethet – e sëmurë

të rrahur nga dielli e nga furra – të vuajtur, të lodhur

i rrahur nga jeta – i vuajtur, me përvojë

ishin bërë legjendë – patriotik, heroik, i famshëm

3) Frazeologji që përbëhen nga dy gjymtyrë të shprehur me emra, të cilët duke u përdorur pranë njëri – tjetrit dhe duke u mbështetur në një krahasim përcjellin shkallë të lartë cilësie (element dallues ky për mbiemrat)

si gur mulliri - të rënda

rri hundë e buzë - të mërzhitur, turivarur

janë miq me kokë - besnikë

është shpirt çifut – i rreptë, i egër, katil

rri gojë e hundë – të ngushtë, të lidhur gushtë

është shpirt njeriu - i mirë

është mot'i zisë – i keq, i varfër

është rrip daulleje – i pavlerë, i trashë

4) Njësi frazeologjike të cilat janë strukturuar me një emër dhe një mbiemër të tipit *dhelpër plakë, viç i palëpirë, daulle e shpuar, baltë e dobët* etj. Këto njësi frazeologjike merren edhe si krahasime të thjeshta megjithëse këtu krahasimi është i fshehur.

është kaur i keq – i keq

është djali këmbëlepur – i shpejtë

është plumb e rëndë - e rëndë

është dreqi i madh - shumë i shkathët, i shpejtë

është mërzi e verdhë - i zverdhur nga mërzia

janë ëngjëllushë të bukur - të pafajshëm, foshnjarakë

5) Njësi frazeologjike të cilat kanë në përbërje lidhëzën *si*, p.sh: *si qimja në qere, si kalë pa fre, si pulë e lagur, si gur varri, si sytë e ballit* etj. Në këto njësi frazeologjike kemi pasqyrimin e një shkalle të lartë të cilësisë, megjithëse këto njësi frazeologjike sipas kontekstit të përdorimit ndonjëherë janë edhe ndajfoljore.

si një varkë e vjetër – e paqëndrueshme, e lëkundur

si karakoll i vjetër - i vjetër, i lashtë

si dy dhëmbët e një furke - të njëjtë, të barabartë

si një kukuvajkë - e vetmuar

si një smerald të shndrritshëm – i çmuar, i vlefshëm

si pika e diellit – i qartë, i dukshëm

si xixa drite - të qarta, të ndritshme

si thasët me lesh – të lehtë

si qimja e ariut – e trashë

sikur zura qiellë me dorë – i gëzuar, i lumturuar

6) Mjaft njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore lidhen me parafjalën *me*: *me lugë në brez, me një këmbë në varr, me kryet përpetë, me kryet varur, me mend në kokë* etj. Këto njësi frazeologjike lidhen me burimin e këtyre njësive frazeologjike nga struktura me foljen posesive *kam* që paralelisht në shqipe parafjala *me* i përgjigjet semantikisht foljes *kam*. Prof. Thomai vëren se: “ *Nga kjo mund të nxjerrim edhe përfundimin se njësia frazeologjike **me lakra në kokë** është dytësore, e prejardhur përkundrejt njësisë frazeologjike (**që**) **ka lakra në kokë**.* ” (Thomai, J. 1981: 86)

me vetulla të ngrysur – i ngrysur, i mërzhitur

me natyrë të rëndë - i rreptë, serioz

me kapën mbi sy - i shpenguar, i rehatuar

me ato mustaqe të egra si dëllinja – i rreptë, trim

me sy hapur – i vëmëndshëm, i kujdesshëm

me vështrimin e tij të akullt – i ftohtë

me dorë në zemër – i respektuar

me gojën e me zemrën plot – i kënaqur

me buzët e djegura(e zhuritura) – i etur

me qefin në kokë - i turpëruar

me kokë në magje – i uritur, hamës

me lopatë në dorë – punëtor

me mend në kokë - i matur, i zgjuar

me djersën e ballit – punëtor, i ndershëm

7) Në gjuhën shqipe ka edhe njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore që përbëhen edhe nga dy folje si: *shkel e shko* (i pakujdesshëm), *fol e qesh* (i qeshur, gazmor), *qesh e ngjesh* (ironik), *qep e shqep* (i pasaktë,i pakujdesshëm), *mat e pre* (i kujdesshëm, i vëmëndshëm), *hiqet e vihet* (i/e lëvizshme) etj. Ndonjëra prej këtyre njësive frazeologjike mbart edhe kuptim ndajfoljor, nëse do të përdorej në fjali në atë kontekst.

hiqet e vihet – i lëvizshëm, send që lëvizet nga vendi

është hyr e dil – i lëvizshëm, që nuk i zënë këmbët dhe’

bjerë e ngrehu – i sëmurë, i lodhur

është qesh e qaj – emotiv, i paqëndrueshëm emocionalisht

është hap e mbyll – llafazane

8) Njësitë frazeologjike mbiemërore me kuptim të kundërt kanë si gjymtyrë të parë një mbiemër prejpjesor me parashtesën mohuese *pa* ; p.sh. *i pavënë dorë, i pavënë në jetë , i pazënë fill, i pavënë re* etj.

Siç vë në dukje Jani Thomai “*nuk mund të shënohen në çdo rast njësi frazeologjike me kuptim të kundërt, sikurse nuk mund të kemi kurdoherë njësi frazeologjike me kuptim pohues si; i vënë dorë - i pavënë dorë. Po ashtu nuk mund të formohet njësi frazeologjike mbiemërore nga çdo stukturë foljore ; psh: nga bëhem erë nuk mund të formohet i bërë erë ose i pabërë erë. Në këtë pikë nuk mund të gjejmë një rregullsi dhe s’mund të përcaktojmë grupe. Këtu kufizimi është edhe më i madh, sepse çdo veprim mund të substancializohet, por jo çdo veprim mund të kthehet në tipar sendi*” (Thomai, J.1981:88).

Megjithëse në gjuhën shqipe këto njësi frazeologjike mund të përdoren në një formë të caktuar (vetëm pohore ose mohore), këto njësi frazeologjike nuk e përjashtojnë mundësinë e tjetërsimit për të kuptuar edhe ngjyrimin emocional gjatë ligjëritimit. Në shembujt e mëposhtëm e vëmë re këtë:

është i pavënë re (i pa parë, i fshehtë)

është i papjekur fare (i pabërë, aguridhe)

është e patrazuar (e urtë)

është e pa zënë fill (e papërdorur, e re)

është djalë i pandreqshëm (mistrec i keq)

është vajzë e paformuar (e parritur, e paarsimuar)

Rendi i njësive frazeologjike mbiemërore mund të jetë edhe i ngurtësuar, për shkak të ngjyrimin emocional që është gjithnjë i pranishëm në to. Ndonjëherë për shkak të stilit ndryshon edhe rendi i vendosjes së njësive frazeologjike, por edhe ngurosja ndryshon me atë vendosje fillestare të njësisë frazeologjike.

zemrën e kish plot gaz – i gëzuar, i lumturuar

i rrihte zemra nga gazi – i gëzuar

i kishin zemrat mbushur me aq gaz – të lumtur

4.2. Disa veçori të formës në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore

Nga pikëpamja e formës, në shumë gjymtyrë të gjuhës shqipe janë fjalët e përdorimit më të shpeshtë foljet; marr, kam, bëj, jam etj ...emrat si pjesë të trupit të njeriut; zemër, dorë, gojë, kokë, sy, buzë etj... edhe fjalë të tjera të përditshmërisë së jetës njerëzore. Prandaj edhe formimi i njësive frazeologjike lidhet me përdorimin e fjalëve të veçanta, me veçoritë emocionale dhe me veçoritë kuptimore.

u është bërë goja kamare – llafazanë

me buzët e djegura – të etur

e kishte përgjigjen majë gjuhe - i shkathët nga goja, i shpejtë

Në letërsinë artistike ngjyrimi emocional dhe gjymtyra me kuptim të figurshëm luajnë rol në ndryshimin e kuptimit frazeologjik. Në raste të tjera është e pranishme si fjalë bosht edhe në rastet kur shënojnë shkallë të lartë cilësie dhe nuk lidhen me asnjë emër tjetër si: *të hurit e të litarit, kaposh mbi pleh, kishte dy pare mend* etj. Këto janë zakonisht tipat më të pasur e më të zakonshëm në gjuhën shqipe dhe skema e mëposhtme është: (emër + numëror + emër) për njësitë ;

është mësallë me dy faqe, kishte dy pare mend, ishte dy bojë njeriu etj.

mësallë me dy faqe – i pafytyrë, jobesnik

dy duart për një kokë – trim , i zoti

Në gjuhën shqipe ndeshen mjaft shpesh disa njësi frazeologjike që përbëhen nga dy a më shumë emra, nga të cilët njëri është edhe si përcaktues për emrin tjetër pavarësisht nëse mund të jetë në rase të ndryshme (pa parafjalë ose me parafjalë)

psh: *me djersën e ballit*. Jo rrallë në marrëdhënie të tilla ndërthuren edhe marrëdhënie të tjera, sidomos me ato kundrinore e subjekt veprimi si: *i bërë erë, i bërë pulë, i bërë derr, i bërë qull, të merr gjak në vetull* etj.

i bërë qull – i djersitur

ia priste truri – e mençur

s'ia bënte syri bef – trim , guximtar

nuk ia hante qeni shkopin – i zoti

burrë me mend në kokë – i mençur, i zgjuar

s'ia bënte syri tërr - nuk i trembej syri – trim , guximtar

Në gjuhën shqipe ka edhe njësi frazeologjike mbiemërore dhe ndërtime me marrëdhënie përcaktore send + cilësi si psh: *me krahë hapur, me gaz të madh, me djersën e ballit, me bisht të syrit, nuk shkel në dërrasë të kalbur* etj.

sheh me bisht të syrit – tinëzar

me gaz të madh – i gëzuar

me hije të rëndë – serioz, i sertë

me djersën e ballit – punëtor, i ndershëm,

me gjak të ngrirë – e trembur, e frikësuar

me një buzëqeshje të ngrirë - e ftohtë, jodashmirëse

Ndonjëherë edhe njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë ndërtuar me marrëdhënie rrethanore të tilla si; veprim + emër + cilësi a rrethanë veprimi psh; *nuk sheh përtej hundës së vet, i qepur me pe të bardhë, e ka mendjen e lehtë, e ka gojën çorap, e ka kokën e fortë, e ka kokën shkëmb, e ka mendjen e trashë, etj.*

nuk sheh më lart se hunda jote - fodull

i kishte rënë një hije mërzie – i mërziur

Në gjuhën shqipe shpeshherë mjaft njësi gjuhësore të cilat janë ndërtuar me marrëdhënie rrethanore si; veprim + emër + cilësi a rrethanë veprimi si; *nuk lë dy gurë bashkë, nuk e ha atë kokërr ulliri, nuk e vë ujët në zjarr, s'e nxjerr dot qimen nga qulli, nuk i shkel këmba dhe' etj.* shfaq sipas përdorimit në fjali herë prirje foljore dhe herë prirje mbiemërore.

s'e vë ujët në zjarr – moskokëçarës, indiferent

nuk ia hante qeni shkopin – i zoti

të sillnin zorrët në gojë – të neveritshëm

Në mjaft raste të përdorimeve në gjuhën shqipe të njësive frazeologjike mbiemërore të cilat ndërtohen me parafjalë + emër + mbiemër (ose një fjalë tjetër me funksion cilësues ose përcaktues) përbëjnë një grup më vete dhe mjaft të pasur në gjuhën shqipe. Më të zakonshme janë ato njësi frazeologjike me gjymtyrë mbiemërore.

me hundë të varur – e zemëruar

me zemër të thyer – e mërzhitur

me faqe të bardhë – faqebardhë

me gjak të prishur – i zemëruar, gjaknxhtë

me gjak të ftohtë – i qetë

me buzë të varura – i mërzhitur

me zemër të ngrirë – të frikësuar

as sytë nuk t'i hedhin sytë – indiferente

me kokën lart - krenare

me sy indiferentë – indiferent

me një zë të frikur – i frikësuar

me sy të merakosur – i shqetësuar

me zemër të vrarë – i lënduar shpirtërisht

me kokën të varur – e mërzhitur

me zë të lodhur - i lodhur

me një lëngim të thellë sysh – e pikëlluar

4.2.1. Njësitë frazeologjike që formohen nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi

Në gjuhën shqipe mjaft njësi frazeologjike të formuara nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi

kuptimisht shtjellohen edhe si njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore të tilla janë; *hundë e buzë, kashtë e kokrra, fol e qesh, qesh e ngjesh, prit e përcill* etj

kockë e lëkurë - e dobët , hollake

fol e qesh – gojëmbël, e mirë, e dashur

shikon e shkruan – e shkathët, e zgjuar

është prit e përcill – bujare, nikoqire

ç' thosh e ç' lidhte – i shkathët nga goja dhe nga puna

është rob e raja - i shtypur, i varur nga të tjerët

them e shthem – i pasigurtë

bëj e zhbëj – i padobishëm, i pasigurtë

është thur e shthur – i pasigurtë në punën që bën

është kocka e rrudha – shumë i dobët, hollak

Njësitë frazeologjike nuk kanë gjithnjë të njëjtën vlerë semantike-funksionale as ndërmjet njëra - tjetrës as në vetvete. Natyra gramatikore e gjymtyrëve nuk përcakton natyrën e njësisë frazeologjike. Po kështu edhe zhvillimi i tyre nuk është i njëjtë, sepse një gjymtyrë mund të jetë mbiemërore, tjetra jo, njëra mund të ketë arritur deri në shkallën e përngjitjes e tjetra jo. Megjithatë ato i kanë veçoritë thelbësore të frazeologjisë; kuptimin leksikor, strukturën, funksionin etj .

si drita e fortë e diellit – e fortë, e dukshme

e kishim të çelur fort zemrën nga gazi – të gëzuar, të lumtur

ishte prekur në shpirt – e lënduar, gati për të qarë

si shpata që të përshkon trupin – vrastare, vdekjeprurëse

me sy të pafajshëm – të pafajshëm, fëminorë

i ke paret me bisht – i pasur, i kamur
e nxirë nga tymi – e nxirë, e zezë, e pisët
është e përzhitur, nga flakët – e djegur
i qe mbushur koka qyp – i bindur
është pa mend në kokë – i trashë

4.2.2. Ndërtime të njësive frazeologjike me elemente krahasuese

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë ato njësi të cilat përcjellin krahasimet me cilësitë e sendeve dhe me cilësinë e veprimeve. Të tilla njësi janë; *si gur varri, si pulë e lagur, si gjel mbi pleh, si kalë pa fre, si rreth unaze, si sytë e ballit, si mishi me kockën* etj.
si gjuha e ndonjë mëshqerre të therur – e gjatë, e kuqërremtë
si cicërima të gëzuara zogjsh – të gëzuar, të hareshëm
sa koka e një gjeldeti – e vogël
sa tundi detin nga fundi – e fuqishme, tronditëse
sa mezi e pushtonin me krahë dhjetë njerëz - e madhe, e trashë
si peshku pa ujë – i pajetë
si mbi gjëmbe – i trembur, i sikletosur
si vesa e prillit – e përkohshme
si miu në çark – i mbërthyer, i zënë ngushtë

Këto njësi frazeologjike, sidomos ato të tipit me **si** së bashku me njësitë ndajfoljore të mënyrës që përmbajnë krahasim mund të përmbliidhen në një grup me vlerë të përgjithshme në grupin e njësive frazeologjike të cilësisë (të shprehjes së cilësisë së sendit e të veprimit). Njësitë frazeologjike që ndërtohen me parafjalën *me* janë mbiemra prejppjesorë dhe nganjëherë bashkëvenë edhe me kallëzuesin emëror. Më shpesh hasim njësi

frazelogjike të cilat janë të formuara në këtë mënyrë; me + emër + parafjalë + emër si
psh: *me buzë në gaz, me mend në kokë, me gisht në gojë, me lot në faqe, me shpirt ndër
dhëmbë* etj.

me një barrë mend – i mençur

me gjithë atë mjekër të bardhë – e gjatë dhe e bardhë

me të rrahurat e shpejta të zemrës - i frikësuar

me kaq llahtari – e frikshme

me trurin e lodhur - e lodhur,

mbeti me gojë hapur – llafazane

me fytyrë të egërsuar – e mërziur shumë

me shpirt ndër dhëmbë – e vuajtur

me një lëmë zjarri – i zjarhtë

me një shinik aspra të bardha – e pasur

me lot ndër sy - e entuziazmuar

me bisht në shalë – i turpëruar

me zë të nxjerrë si me zor – i ngjirur

me vetulla të ngrysyra – i pakënaqur

Një grup më vete përbëjnë njësitë frazeologjike të cilat kanë gjymtyrën e dytë mbiemërore
ose një fjalë tjetër me funksion cilësues – përcaktues të tipit: me + emër + mbiemër psh: *me
zemër të hapur, me veshë të ngrehur, me hundë të varur, me gjak tëndezur, me mendje të
ngritur, me zemër të thyer, me buzë të zhuritura, me gjak të ftohtë, me gojë të kyçur* etj.

me gozhdën e dashurisë së shkretë – i dashuruar

me sy më të zbutur – e qetë, e butë

me zemër të thyer - zemërthyer, e trishtuar

me krahë të hapur – e gëzueshme

Njësitë frazeologjike me strukturë të tillë janë të figurshme dhe me shprehësi të lartë, sepse janë shënuese të një cilësie në raport me gjymtyrën me të cilën lidhen. Shpeshherë ato përdoren në gjuhën e folur popullo

nuk ia priste truri – i mefshtë, i trashë

s'ia ha qeni shkopin – shumë i zoti

e bëra zemrën gur – e fortë, zemërgur

kanë qejf të marrin të tjerët nëpër gojë - llafazanë

e ka mizën nën kësulë - i implikuar, i paqetë

me shpirtin majë hundës – i mërzhitur

i vinte goja rodhan – i shkathët nga goja, brisk

ka zemër të madhe - bujar, zemërbardhë

4.3. Ndërfutja e elementeve në njësinë frazeologjike mbiemërore

Shpeshherë njësitë frazeologjike varen edhe nga ndërfutja e elementeve në brendësi të një njësie frazeologjike mbiemërore që lejon edhe modifikimin nga ana semantike. Në disa raste ajo mund të çojë në edhe shpërndarjen e gjymtyrëve të njësisë frazeologjike. Në rastet kur kemi një njësi frazeologjike mbiemërore të përbërë nga *folje + emër*, mund të ndërfutet ndajfolja:

Pa pyetur fare autorin, të cilit nuk i mbushej mendja të kishte shkruar gjë të bukur, njëri nga shokët e tij me nofkën “Eshkani” – nofkë kjo që i kishte mbetur ngaqë, kur

fliste, merrte përnjëherësh zjarr si eshka, ia mori skicën me marifet dhe, mik pas miku, gjeti rastin dhe e botoi me pseudonym në një nga gazetatat qendrore, kryeredaktori i së cilës kishte fituar besimin e autoriteteve qeveritare... (Shefqet Musaraj, Para agimit, fq.11)

*Pas këtij shpërthimit të këtij emocioni kaq të madh, ishte vështirë të qëndroje. Prandaj pimë edhe dollinë e fundit, u ngritëm dhe përqafluam shokun Zylo. Ai doli me lulet e freskëta në dorë dhe **me lotët e pastër në sy**. Do të thoni ju se për ç'arsye shokun Zylo e përcollëm me ceremoni? Ah, të dashur, nuk e shoh të udhës t'ju bëj një leksion të gjatë! (Dritëro Agolli, Vepra letrare 6, fq.237)*

Ndërfutja edhe e mbiemrit në strukturën e njësive frazeologjike mbiemërore në gjuhën shqipe nuk është e rrallë, sepse ajo lidhet edhe me emrin pasardhës. Një tjetër rast i ndërfutjes është edhe ai që nuk lidhet me asnjë nga gjymtyrët frazeologjike por lidhet në tërësi në të, nëpërmjet marrëdhëniesh sintaksore (Thomai, J. 1981:56) si në shembullin e mëposhtëm:

*Beut i tundej në erë xhufka e zezë e festes së kuqe. Edhe ikte, ikte... Pas tij iknin ata njëzet e ca lanxho, që i kishin mbetur besnikë deri në fund. Ama trimat e Malush Agait, që kishin zënë tërë grykën, kishin dalë nga pusitë e u thërrisnin: “Isa –ha! Isa – ha!” sikur t’u ndërsenin qentë e stanit. **Iku** beu, si i thonë një fjale, **me bishtin ndër shalë**. Ama ish bërë tym e zjarr nga zemërimi. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq.136)*

Ka raste të njësive frazeologjike mbiemërore që janë të ngurosur nga lidhja e brendshme kuptimore dhe ndërfutja e elementeve është e pamundur. Zakonisht kjo ndodh në njësitë e pamotivueshme, por edhe nëse kjo ndodh është e jashtme nga ana semantike.

Ama frëngu e ka synë pishë. E shikon kajmekam efendinë sikur ai vetë të qenkej zot i vendit e kajmekami të qenkej lanxho, mingo. Edhe nga trupi vjen i fortë, i gjatë, i lidhur;

përpara kajmekamit të rrëgjuar e të futur në ca shallvare si thasë ai duket dushk, kajmekami gorricë e egër. Të bën t'i rrish me dorë në zemër. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq ,94)

Ditë e javë erdhën e shkuan dhe e gjetën e lanë grizaraken me këtë ankth në zemër. Asaj **i qe mbushur koka top** se kishte rënë me barrë. Aq ia priste mëndja e mënd të tjera s'kish ku të kërkonte. Mos kishte t'ëmën gjallë e t'i ulej në prehër e t'i rrëfente?(Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll.I, fq. 240)

Nga të pesë lekët e gjobës,tre i kishte marrë polici,dy – Grandelli.Dhe **i qe bërë zemra mal**: Ago Zylali i kish rrëfyer udhënpër tënxjerrë lekun me të ndenjtur dhe ai,Grendelli i i kish sjellë peshqesh, si mirënjohje një defterkë karticigare nga ato të Stamlesit...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq ,281)

Dhe me të vërtet!...Ai ,Koz dynjaja, të cilit **i priste gjuha brisk** në kohë të lërimëve, mbjelljeve, prashitjeve, kur vinte puna të fliste me bashkëfshatarët për vuajtjet e tyre, tani, në kohën e të korrurave dhe lëmit, detyrohej shpesh herë t'i vinte penges gjuhës, për t'u ndukur frerin disa shokëve të tij, që, nga dielli e vapa e beharit, **u mirrte koka zjarr** e mund të bënin ndonjë “mbroçkull” në fshat. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq.125)

...Po kjo s'do të thotë se s'kish edhe nga ata që nuk ja varnin fare e që **rrinin hundë e buzë** kur këndonte. Mirëpo këta ishin të paktë, nga ata që ne u themi andej **shpirtkazmë**, pa shpirt. Këta dinin e donin vetëm një gjë : qesen me pare. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 179)

E ka yshtyr dhaskali, atë, të flasë kështu; po e di unë sa **ia pret mendja atij!** – shau një plak që e dëgjonte priftin e nuk e dinte kujt t'i jepte tani të drejtë: vehtes apo beut. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll.I, fq.69)

Në strukturën e njësive frazeologjike është studiuar ndërfutja e elementeve nga Ernst³² i cili dallon ndërfutje që sjellin modifikime të jashtme, modifikime të brendshme dhe të koordinuara:

- ndërfutja e një mbiemri konsiderohet si ndryshim i jashtëm

*Deti është i rrezikshëm, tha. Është një ëndërr që të magjeps. Dhe mund të humbasësh në të. Pastaj, me zërin e saj të ëmbël, që rusisht tingëllonte **si cicërima të gëzuara zogjsh**, i recitoi vjershën e Lermontovit. E, ai tek kthehej në repart, përsëriste me vete: beljejet parus adinokij v tumanja morja gallubom ... (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq. 225)*

*Greku, një shok i gjatë, me një hundë të madhe , me mollëzën e Adamit sa koka e një gjeldeti, **me një baskë të zezë, të madhe** , të shtypur nga e djathta, aq, sa i dilte përmbi veshin si strehë, e shikonte Gorin dhe i përgjigjej...(Petro Marko,Vepra letrare 3, fq. 210)*

*Retë zvogëlonin qiellin e Tiranës. Uria kërcënonte banorët e saj, kurse ndryshimet e befta politike dhe liria e fjalës – të cilat ata nuk ishin mësuar i verbonte **si drita e fortë e diellit** të burgosurin përjetë që e nxjerrin papritur nga qelia e errët. ... (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq. 248)*

*...Veç ai Mali i Thatë, përtej,ma mbante atë takijen e bardhë majë kokës, që rrihte më kot t'ia marrë dielli.Binte erë dhe' e plis, erë Shëngjergji. Këtë erë të hollë që deh njerinë, e ndienim që të gjithë se **e kishim të çelur fort zemrën nga gazi** i Destanit. Digjte fort dielli i prillit, se moti ish përpara. (Mitrush Kuteli, Netë shqiptare, fq. 7)*

³² Abeille' , A.(1995): "The flexibility of French idioms: A representation with lexicalized tree adjoining grammar", në M. Everaert, E. – J.van der Linden , A.Schenk and R.Schreuder, "Idioms: Structural and Psychological Perspectives", Hillsdale,Nj: Lawrence Erlbaum Associates,vep. e cituar, shih. Vora. R. fq.22

- modifikimi është i brendshëm atëherë kur ndërfutja e një emri modifikon një pjesë të kuptimit të njësisë frazeologjike.

*...E, mirë, **e bëra zemrën gur**, i dhashë aty në sy të të gjithëve një pesëdhjetëlekëshe, të re, kuptohet. Kjo dhuratë bëri përshtypje dhe u komentua goxha. Jani më lëvdoi e më ngrit në qiell. (Teodor Laço, Zemërimi i një njeriu të urtë, fq. 77)*

- kur modifikimi prek si kuptimin idiomatik edhe atë të drejtpërdrejtë të gjymtyrës emërore, modifikimi është i koordinuar.

*... **Kockë e lëkurë** ishte bërë. Ajo qante përditë, po fshehurazi nga ne. Njëherë, kur ishte në katua duke pastruar ,unë mbajta këmbët dhe dëgjova si qante. Zemra më pikoi vrer. (Petro Marko, Griva, fq.188)*

*Ama frëngu **e ka synë pishë**. E shikon kajmekam efendinë sikur ai vetë të qenkej zot i vendit e kajmekami të qenkej lanxho,mingo. Edhe nga trupi vjen i fortë, i gjatë, i lidhur; përpara kajmekamit të rrëgjuar e të futur në ca shallvare si thasë ai duket dushk, kajmekami gorricë e egër. Të bën t'i rrish me dorë në zemër. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq . 94)*

I emocionuar, me dorën që i dridhej, Koli vuri cigaren në buzë. E thithi fort,por ajo ishte shuar. Xhevdeti nxori çakmakun.

- E di që nuk e ke menduar keq? – tha Xhevdeti. Koli mori frymë thellë. Këto fjalë e qetësuan disi.

*- Gëzoje nipçen, pa Vera ka kësmetin e vet: ajo është shpuzë, **s'ia ha qeni shkopin!** Mos jua ki hiç merakun! Koli mblodhi supet. (Kiço Blushi, Pajtoni i fundit, fq. 278)*

Në mjaft raste në gjuhën shqipe, ndërfutja e një elementi lidhor në strukturën e njësisë

frazeologjike çon në ndryshime të kuptimit të saj. Kur gjymtyrët e njësisë frazeologjike shpërndahen rriten mundësitë e humbjes së kuptimit frazeologjik të shprehjes. Gjymtyrët humbasin unitetin semantik dhe komponentët e njësisë frazeologjike e ndryshojnë formën.

4.4. Kombinime të varianteve në njësitë frazeologjike mbiemërore

Variantet formale të një njësie frazeologjike mbiemërore janë të qarta për atë sa kohë ato kanë në bazë të kuptimit të tyre metaforën dhe gjymtyrët me të cilat zëvendësohen i përkasin së njëjtës fushë semantike. Nëse kanë të njëjtin kuptim do të thotë se ato mund të jenë sinonime frazeologjike të cilat ose krijohen nga sinonimia kontekstore ose nga sinonimia leksikore.

- *Je në rrugë të mirë, mos u tremb aga, mbaje veten e shko përpara se ai zot i sheh të gjitha. Edhe tatëpjetë ish greminë pa fund, sa ago Jakupi u tromaks e foli:*

- *Si të dal që këtu, o mik?*

- *Fluturo, aga, fluturo se t'i mund.*

*Edhe agai zgjati krahët e u ngjiti lart, lart. Edhe **zemrën e kish plot gaz**. Pastaj u zgjua.*

(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.64)

*Këndoi: “Këtë krua e ka hapur ago Jakupi. Edhe zoti ia shkrojtë ndër të mira”. Kish frikë se mos ish ëndërr, prandaj zgjati dorën në ujë - rridhte një ujë i ftohtë i kulluar, edhe piu për së dyti e për së tretë. Pastaj u zgjua. ëndërr pat qënë, po ëndërr e mirë, sa **i rrihte zemra nga gazi**. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.64)*

Në shembujt e mësipërm njësitë frazeologjike janë sinonimike me njëra – tjetrën dhe mund të konsiderohen si njësi leksikore ekuivalente dhe variante të njëra – tjetrës. Siç mund të shihet njësia frazeologjike mbiemërore në përbërjen e saj ka gjymtyrë si: folje, mbiemra,

ndajfolje, emra, numërorë etj. të cilat po të zëvendësohen me gjymtyrë sinonimike do të kemi variante të së njëjtës njësi frazeologjike.

4.5. Variacione të mbiemrit

Njësitë frazeologjike mbiemërore në gjuhën shqipe kanë të pranishëm edhe elementin jo mbiemëror me të cilin krijojnë lidhje varësie edhe nga ana kuptimore. Roli i mbiemrit nuk mund të kuptohet pa praninë e gjymtyrës mbiemërore dhe formimi më i zakonshëm është bashkimi *emër + mbiemër (i nyjshëm ose i panyjshëm) në numrin njëjës*. Jo gjithmonë në njësitë frazeologjike mbiemërore është e pranishme gjymtyra e mbiemrit, por edhe kur mbiemri është i pranishëm ai mund të jetë i zëvendësueshëm me mbiemra të tjerë sinonime të tij.

Prania e lugëve të drunjta e turbulloi më keq nënën e Yllit. Ajo bëri kryq, me një lëngim të thellë sysh, që të kujtonin pikëllimin qiellor të shenjtorëve ndër afresket e kishave të Myzeqesë. I lutej perëndisë, me gjuhën e vogël, t'i falte edhe një mëkat tjetër: po hante qeshqek para kërrshëndellave dhe me lugë rapke. “ Kush e kishte fajin: kryetari apo nusja?” (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. I, fq.169)

- Kurrë, tha ai dhe përplasi receptorin në dysHEME. – Kurrë!

- Berti, zgjohu, ç'ke kështu?

Mamaja po e shihte me sy të merakosur. Ajo tërhoqi dorën nga balli i tij. Ai u ngrit menjëherë ndenjtur duke vështuar në dritare. “Siberizimi i Shqipërisë.Akujt. Byroja e Akullimit.” Si kishin hyrë në trurin e tij këto fjalë, ky figuracioni i hatashëm dhe këto terma të çuditshëm? (Kiço Blushi,Pajtoni i fundit , fq. 191)

- Ç'janë ata qypa, moj bijë? Ç'janë këto pare me bisht?- pyeti plaku dhe u mundua ta shquante , ndër të tjerat, atë që foli , me ata sytë e shpëlarë, që ia kish përcëlluar flaka e

furrës. (Më vonë, im gjysh humbi fare dritën e syve , rrojti dhe eci shumë vjet në errësirë, gjersa ndërroi jetë kur ishte nja njëqind e tetë vjeç).(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 128)

...Ai na pa **me vështrimin e tij të akullt**, zuri nofullën e rëndë me dorë dhe qëndroi pak. Adila u bë gati ta përshëndeste, por ai mori udhën nga dera pa thënë asnjë fjalë.

(Dritëro Agolli, Vepra letrare 6, fq. 20)

Njësitë frazeologjike mbiemërore siç vihet re në shembujt e mësipërm gjymtyrët mbiemërore janë sinonimikë dhe mundësojnë përdorimin e njësive frazeologjike në vend të njëra - tjetrës. Jo gjithmonë njësitë frazeologjike mund të zëvendësojnë në trajtë sinonimike ndër mbiemra, por ajo mund të formojnë sinonimi vetëm me një gjymtyrë.

- Nuk duam , aga, se na dhe rrush edhe ne do ta ruajmë ...

-Dum- dum- dum, bënë çape në udhë edhe pastaj djali më i madh – **i kuq si prushi** – me një shportë në dorë, kaloi shtegun. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 61)

Bukë morëm në furrë , se babagjyshi e kish derën e zemrën të hapur për të gjithë. Qielli kaltërosh, si i përzier me hi. Uji i gjolit, i valë. Dhe ne **të nxehur si prushi**. Edhe sepse ish aq i valë uji, gazin e asaj dite nuk e harroj, gjer të më vihet plloça mbi një varr... Bën të ngryset e s'ngryset dot. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 172)

4.6. Variacione të emrit

Njësitë frazeologjike mbiemërore përbëhen nga dy gjymtyrë emërore. Shpeshherë nga këto marrëdhënie këto gjymtyrë janë me lidhje këpujore ose me lidhje përcaktore. Këtu variantet e emrit janë të zëvendësueshme kur gjymtyra e parë është e ngurosur.

- kur gjymtyrët emërore janë sinonime

... **Kockë e lëkurë** ishte bërë. Ajo qante përditë, po fshehurazi nga ne. Njëherë, kur ishte në katua duke pastruar ,unë mbajta këmbët dhe dëgjova si qante. Zemra më pikoi vrer. (Petro Marko, Griva, fq.188)

Kur arrita tek shtëpia dhe karrocieri më ndihmoi t'i ngjisja rraquet lart, nxorra lekët t'i paguaja hakun,por ai nuk pranoi. Fshiu ballin e djersitur – ishte një burrë i vjetër gjithë **kocka e rrudha** – dhe më tha - ç'të të marr ty moj bijë, ti qenke më keq se unë...Nuk di pse ta tregova këtë,sonte qenkam bërë llafazane. (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq. 123)

- kur gjymtyrët emërore janë sinonime edhe me baza dialektore

Mora përsëri bukë e djathë e dola në Mburima,ku uji buronte glu – glu –glu, me fluska të rrumbulla, ku ngriheshin e binin fije bari. Atje ujin e pija me grushtose shtrirë , me **gojë e hundë** brenda. Dhe së brendëshmi, në ujë, një tjetër djalë si vetë Theofili i afrohej fytyrës sime. Shumë është ndryshuar bota ime që atyre mëngjeseve me diell, kur pata filluar të njoh se janë dy jetë të ndryshme: ajo e ëndrrave dhe ajo e së vërtetës. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 73)

Po kjo s'do të thotë se s'kish edhe nga ata që nuk ja varnin fare e që rrinin **hundë e buzë** kur këndonte.Mirëpo këta ishin të paktë,nga ata që ne u themi andej shpirtkazmë, pa shpirt. Këta dinin e donin vetëm një gjë : qesen me pare. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 179)

Por në gjuhën shqipe këto njësi frazeologjike gjenden më rrallë: për të nxjerrë sytë dhe për të qitur sytë, sy të shpëlarë dhe sy shëllirë , m'u bë mendja dhallë dhe m'u bë mendja çorbë, më del tym nga koka dhe më del zjarr nga koka etj.

- gjymtyra zëvendësuese nuk ka lidhje sinonimike dhe mund t'i përkasin fushave semantike të ndryshme.

Dita sa një muaj,thashë ,edhe i harroj grifshat e maçokut të Shamshallos.

- *Unë tetë , - gënjeu Verdhaniku.*

- *Unë njëqind, foli – një foshnjë që s'dinte as rrugën e gjolit.Po për të folur i vinte goja rodhan. E po ta pyesje sa vjet është, gjithë njëqind të thosh.*

U bë rishtaz qetësi. Zbritën me zhurmë,për tatëpjetë, djemtë e Xhambazit: tre xhinde me të madhë e shenjtanëve bashkë. Dhe si shkuan, prapë qetësi. (Mitrush Kuteli,Tregime të zgjedhura, fq.173)

Dhe me të vërtet!...Ai ,Koz dynjaja, të cilit i priste gjuha brisk në kohë të lërimeve, mbjelljeve, prashitjeve, kur vinte puna të fliste me bashkëfshatarët për vuajtjet e tyre, tani,në kohën e të korrurave dhe lëmit, detyrohej shpesh herë t'i vinte pengesë gjuhës, për t'u ndukur frerin disa shokëve të tij, që, nga dielli e vapa e beharit, u mirrte koka zjarr e mund të bënin ndonjë “mbroçkull” në fshat. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq.125)

Gjymtyrët emërore të njësive frazeologjike në shembujt e mësipërm janë të fushave të ndryshme semantike, por ato edhe mund të zëvendësojnë njëra – tjetrën .

Pa pyetur fare autorin, të cilit nuk i mbushej mendja të kishte shkruar gjë të bukur,njëri nga shokët e tij me nofkën “Eshkani” – nofkë kjo që i kishte mbetur ngaqë, kur fliste, merrte përnjëherësh zjarr si eshka, ia mori skicën me marifet dhe, mik pas miku,gjeti rastin dhe e botoi me pseudonym në një nga gazetatat qendrore, kryeredaktori i së cilës kishte fituar besimin e autoriteteve qeveritare...

(Shefqet Musaraj, Para agimit,fq.11)

*Dhe me të vërtet!... Ai, Koz dynjaja, të cilit i priste gjuha brisk në kohë të lërimeve, mbjelljeve, prashitjeve, kur vinte puna të fliste me bashkëfshatarët për vuajtjet e tyre, tani,në kohën e të korrurave dhe lëmit, detyrohej shpesh herë t'i vinte penges gjuhës, për t'u ndukur frerin disa shokëve të tij, që, nga dielli e vapa e beharit, **u mirrte koka zjarr e mund të bënin ndonjë “mbroçkull” në fshat.** (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq.125)*

*Bulevardit i erdhi fundi e ajo mori kthesën për në shtëpi. Sidoqoftë besonte se dhimbja e tij ishte po aq e fortë sa edhe ajo e saja. Se të dy do të vuanin nga mosfolja, nga mostakimi, nga ëndrra e perealizuar e fejesës që s'arritën ta shpallnin... Të dy do të ruanin në shpirt **si një smerald të shndrritshëm** thesarin e dashurisë së tyre. (Diana Çuli, Dhe nata u nda në mes...fq.95)*

*Fola unë? Thashë gjë unë? Pashë ndonjë të njohur unë?Të gjithë sytë dukeshin **si xixa drite** që na shoqëronin për rrugën tonë të gjatë e, mbase, pa kthim... Dera e hekurt u mbyll nga poshtë me lloze të çelikta. Brenda, përmbi dengjet dhe valixhet tona ishim hedhur edhe ne. Makina u nis. Tundeshim si thasët me lesh në një karro që ecën në një rrugë plot me gropa. Më ishte përdredhur këmba. Nuk e dija se cili më kishte rënë në kurriz...Më merrej fryma... (Pertro Marko, Nata e Ustikës, fq. 40)*

Në shembujt e mësipërm vëmë re se gjymtyrët emërore ose mbiemërore i përkasin të njëjtës fushë leksikore dhe kanë kuptime të njëjta ose të përafërta.

4.7. Variacione të foljes

Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë shpesh të pranishme edhe foljen, ndaj gjejmë në njësitë frazeologjike mbiemërore edhe zëvendësimin e foljes si në rastet e mëposhtme:

*Zbritën pastaj krua më krua, ajazmë më ajazmë , hije më hije, ishin të lumtur fort edhe **i kishin zemrat të mbushura me aq gaz**, sa kurrë s'i shkonte ndër mend se do ketë ky njeri. I*

vajti mendja një grimë për bagëti e stane, si në botën e të gjallëve dhe, nameta u gjend në pyje të veshura e që atje në ca stane bukuri e madhe... (Mitrush Kuteli, *Tregime të zgjedhura*, fq. 232)

Këndoi: “Këtë krua e ka hapur ago Jakupi. Edhe zoti ia shkrojti ndër të mira”. Kish frikë se mos ish ëndërr, prandaj zgjati dorën në ujë – rridhte një ujë i ftohtë e i kulluar, edhe piu për së dyti e së treti. Pastaj u zgjua. Endërr pat qenë, po ëndërr e mirë, **sa i rrihte zemra nga gazi**. (Mitrush Kuteli, *Tregime të zgjedhura*, fq. 64)

- E – e – e ...- ia bëri gjyshi duke qeshur. – Tashi po e marr vesh se ku shtie dyfeku i gjatë. Shtie shumë larg. Të mëdhenjtë **bënë buzën me gaz**; ne, vegjelia u gajasëm, sepse të qeshurat e të qarat i kishim në xhep, të përziera e i nxirrnim lumë, me shkak e pa shkak. Lamë qoshet ku lonim e zumë vend pranë të mëdhenjve, të dëgjojmë. (Mitrush Kuteli, *Tregime të zgjedhura*, fq. 128)

...Bame Vorbulla e lëshoi sëpatën përtokë, duke e mbajtur për bishti. **Vuri buzën në gaz**, përkuli pak kokën nga e djathta, e mbylli njërin sy e tha;

- Kur ishim në luftë, nuk na thoshin që do vijë një kohë që do të na ndërhyjnë në punët e shtëpisë, Xhelo! (Dritëro Agolli, *Dështaku*, fq.119)

Këto zëvendësime të foljes mund të jenë me folje të tjera sinonimike ose jo.

4.8. Variacione me fjalë joemërtuese

Në strukturën e njësisë frazeologjike me vlerë mbiemërore gjymtyrët funksionale mund të zëvendësojnë njëra – tjetrën pa ndryshuar kuptimin e njësisë frazeologjike. Gjymtyrët joemërtuese si parafjala mund edhe të zëvendësohen me një parafjalë tjetër, në njësinë frazeologjike mbiemërore në gjuhën shqipe.

... - Aq na ka rrahur, o agë, me top si në Edrene! Po me top gorrice, nga ata të fortët! E një e shkrepitirë, e një e gjëmuar, që aman o zot! Thamë se vjen tellua e priftit të Llëngës!

- Jo more, - edhe agai **e shpuri buzën me gaz** – një herë u prish bota me ujë, në kohë të Nuhut, tashi i vjen radha me zjarr e me squfur.(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 16)

...Bame Vorbulla e lëshoi sëpatën përtokë, duke e mbajtur për bishti. **Vuri buzën në gaz**, përkuli pak kokën nga e djathta, e mbylli njërin sy e tha;- Kur ishim në luftë, nuk na thoshin që do vijë një kohë që do të na ndërhyjnë në punët e shtëpisë, Xhelo! (Dritëro Agolli, Dështaku, fq.119)

Zbritën pastaj krua më krua, ajazmë më ajazmë , hije më hije, ishin të lumtur fort edhe **i kishin zemrat të mbushura me aq gaz** , sa kurrë s'i shkonte ndër mend se do ketë ky njeri. I vajti mendja një grimë për bagëti e stane , si në botën e të gjallëve dhe, nameta u gjend në pyje të veshura e që atje në ca stane bukuri e madhe... (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura , fq. 232)

Këndoi: “Këtë krua e ka hapur ago Jakupi. Edhe zoti ia shkrojti ndër të mira”. Kish frikë se mos ish ëndërr, prandaj zgjati dorën në ujë – rridhte një ujë i ftohtë e i kulluar, edhe piu për së dyti e së treti. Pastaj u zgjua. Endërr pat qenë , po ëndërr e mirë, **sa i rrihte zemra nga gazi** .(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 64)

Jemi përpjekur të sjellim edhe shembuj të gjuhës angleze për të parë nëse edhe në gjuhën angleze mund të zëvendësohen fjalët joemërtuese;

Uncle Jolyon in his later years – indeed, ever since the strange and lamentable affair between his granddaughter June's lover young Bossiney, and Irene ..., - had noticeably

rapped the family's on the knuckles; and that way of his own...had begun to seem them a little wayward... (John Galsworthy, The Forsyte Saga, fq 217)

The fact is someone ought to speak to Bossiney and ascertain what he means. I'm afraid of this myself, for I should certainly rap him over the knuckles, but I thought that you, knowing him at the club, might put in a word, and get to ascertain what the fellow is about. ... (John Galsworthy, The Forsyte Saga, fq. 169)

Edhe në gjuhën angleze fjalët joemërtuese mund të zëvendësohen pa e prishur kuptimin e njësisë frazeologjike (Vora, R. 2012: 76)

4.9. Variacione të kombinuara

Në njësinë frazeologjike mbiemërore ka raste kur dy ose më shumë gjymtyrë kanë variantet e tyre janë quajtur variante të kombinuara .Veçojmë këto raste:

- Rasti i parë është kur ndryshojnë a këmbëhen të gjithë elementët e strukturës së njësisë frazeologjike mbiemërore, pa e prishur kuptimin e saj.

(për dikë që është llafazan); *gramafon i prishur; s'i pushon goja, ka gjinkallën në gojë e ka gojën çorap*

- *Nuk durohet ai, nuk di rend e radhë, e ka gojën çorap. (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe fq.59)*

- Rasti i dytë është kur këmbëhen ose zëvendësohen gjymtyrë të njësisë frazeologjike mbiemërore edhe kur njëra nga gjymtyrët mbetet e pandryshuar; për të treguar se (është kokëfortë):*e ka kokën (shkëmb) gur, e ka kokën si të mushkës, e ka kokën me gunga*

- *Nuk kam ç'i bëj, e ka kokën me gunga, e nuk ha pykë.* (Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* fq.159)

Shpeshherë njësitet frazeologjike mbiemërore lidhen me ndryshimin e gjymtyrëve të eptueshme, të cilat nuk çojnë në ndryshimin e kuptimit frazeologjik të njësisë frazeologjike psh: *ka zemër të bardhë* dhe *e ka zemrën të bardhë* - *zemërbardhë*

më ligjëron zemra dhe *i ligjëronte zemra* – shumë i gëzuar, fluturoj nga gëzimi

Memecja ***kishte zemër të bardhë***, por nuk e shprehte dot. (Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* fq.570)

Ç'e nxirrte atë tymin fjollë në anë të mustaqes, i ligjëronte zemra që kish hyrë në shtëpi të re. (Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* fq. 572)

Edhe në gjuhën angleze njësitet frazeologjike mbiemërore emri ndryshon numrin, por nuk ndryshon kuptimin e njësisë frazeologjike:

In hot blood – gjaknxehët

To make s.o.'s - i ndez gjakun (Pavli Qesku, *Fjalor Anglisht – Shqip*, fq. 30, Botime EDFA, Albania, Tiranë, 2002)

4.10. Variacione sintaksore

Në gjuhën shqipe ka disa raste zhvendosjeje të gjymtyrëve në njësinë frazeologjike mbiemërore, pa e prishur kuptimin e njësisë. Lëvizja ose zhvendosja e njëres gjymtyrë të njësisë lejon praninë ose vendosjen e saj edhe në mes edhe në fund të njësisë frazeologjike.

*Kësaj radhe nuk hymë në shpellë, po ia shtruam në një lëndinë, pranë zjarrit: unë më të dhathtë, Zyferi më të mëngjër e Mustaqeverdhi në mes. Kjo natë ka qënë më e llahtaritur sesa e para. Me të mbyllur sytë, vinte e na pllakoste një hije e zezë, si plane, **plumb** e*

rëndë. Kur e kur ikte hija e vinte një burrë i gjatë me ca mustaqe si fshesë e na rrihte me një topuz thane. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 152-153)

Trarët, pasi kishin pirë ujë, ishin **rënduar e** ishin **bërë plumb.** (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe fq.382)

Javo se atëherë po vjen edhe Ago Dajlani e na qëndron përtej e ulet të dëgjojë këngën e Petrushit. Pa, vetë ky usta Vani ç'u ngrit në këmbë e iu lut **me dorë në zemër** të vijë ky në krye të sofrës. -Urdhëro e na ndero këtë çikë bukë, o zoti bujer, i pat folur ustai në gjuhën e vendit. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.38)

Unë i lutem **me zemër në dorë** Naltësisë suaj të mos i vini veshin asaj që thotë arqipeshkvi i Tivarit. (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe fq.577)

4.11. Variacione të përdorura në dialekte

Siç pohon Shkurtaaj. Gj. "...gjuha shërben si mjeti parësor dhe themelor i komunikimit dhe i transmetimit e i shkëmbimit të përvojës e të trashëgimisë kulturore nga një grup në një tjetër, nga një breznë në një tjetër" (Shkurtaaj, Gj. 1996 :163). Gjuha është një dukuri shoqërore e cila ndryshon dhe transformohet në bashkësi të ndryshme shoqërore dhe si e tillë has në kontakte me faktorë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Lëvizja e vazhdueshme e lirë e njerëzve mundëson ndonjëherë edhe shkrirjen ose dhe përzierjen e gjuhës dhe frazeologjizmave me terma ose fjalë të reja, si në rastet e mëposhtme:

më zien koka - shumë i shqetësuar, i mërzhitur

më del zjarr nga koka

më del tym nga koka

më del avull nga koka

më ziejnë trutë

jam në tym

më rrahin shumë çekanë në kokë

më këndojnë bilbilat (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe. fq.253)

as në qiell as në tokë

del gjithnjë i larë – i pafajshëm

del gjithnjë vaj mbi ujë

s'merr faj përsipër

nuk ka miza në kësulë

Edhe njësitë frazeologjike në kohë janë ndikuar nga ndryshimet gjuhësore dhe jashtëgjuhësore dhe sot ato shfaqen në variante të ndryshme. Megjithëse njësitë frazeologjike mbiemërore shfaqen në variante të ndryshme gjeografike ato janë forma gjuhësore nga e njëjta origjinë, por janë zhvilluar në territore të ndryshme dhe në kohë të ndryshme ose nga bashkësi shoqërore të ndryshme.

KAPITULLI I PESTË

FUSHA LEKSIKO – SEMANTIKE DHE PASQYRIME TE ETNO - KULTURËS NË NJËSITË FRAZELOGJIKE MBIEMËRORE

5. 1. Fusha leksikore dhe semantike në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore

Leksiku është tërësia e fjalëve të një gjuhe. Ç'është fusha leksikore? Fusha leksikore është tërësia e fjalëve që emërtojnë sende, vende, profesione ose gjendje që i përkasin një sferë të caktuar profesionale, familjare ose shoqërore, të cilat kanë lidhje origjine me njëra – tjetrën, psh; fusha e sportit, futbollit, trajnerit, arbitrit, stol rezervash, gol, faull, rezultati etj.

Semantika studion kuptimin e fjalëve, kuptimin e fjalive ose të ideve të shprehura. Ç'është fusha semantike? Fusha semantike studion kuptimet e fjalës (njëkuptimësinë ose shumëkuptimësinë) psh; *xhami (qelq), xhami' (objekt kulti)* etj; ose të njësive frazeologjike psh; *e merr çiftin me gjithë derë – i rrëmbyer, i nxituar; e kishte mendjen të mbushur – i bindur* etj.

Njësitë frazeologjike në tërësinë e tyre janë fjalë që gjatë ligjërimit duke pasur strukturë të hapur lidhen me fjalë ose leksema të fushave të ndryshme në varësi të kontekstit ligjërimit. Këto lidhje mund të bëhen nga ligjëruesi në funksion të qëllimit dhe kanë vlerë nominative dhe vlerë shprehëse: psh *nuk rri pa i futur hundët* (i bezdisur, do të dijë gjithçka), *është nuse me tel* (e urtë, e edukuar), *ka edhe ai damarin e vet* (është gjaknxhtë) etj.

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë mjaft të pasura në trajta fjalësh të fushave leksikore të ndryshme të cilat pasqyrojnë edhe vlera shprehëse psh;

nuk e ha atë kokërr ulliri (i zgjuar, finok),

ka hequr të zitë e ullirit (i vuajtur),

si vaj ulliri (i verdhë),

është si vaji i ullirit (kurativ, i shëndetshëm) etj.

Në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore përdoren për t'i dhënë gjuhës një nuancë tjetër kuptimore, një nuancë me ngarkesë të lartë emocionale. Ato janë mjaft shprehëse sidomos në ligjërimin e përditshëm; *nuk ia pret mendja – i trashë, është gjarpër – dinak, është njeri me zemër – trim, e kishte mendjen të mbushur – i bindur, rrinte buzëvarur – i mërzitur, e ka si sytë e ballit – të shtrenjtë, nuk të hap udhë – i vendosur (jotolerant), të ha shpirtin – i mërzitshëm (i bezdisur)etj.*

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë vatra semantike të shumëllojshme, kjo në varësi të modeleve të formuara, në varësi të lidhjes së gjymtyrëve ose të mundësive shprehëse dhe kontekstit të përdorur nga folësi. “*Asnjë metodë e analizës nuk mund të japë rezultate të sigurta pa vëzhgimin e kujdesshëm të tipareve gjuhësore të frazeologjisë*”.³³

Në gjuhën shqipe kanë vepruar dhe veprojnë mjete të shumta stilistikore të cilat kanë ngjyrimë dhe kuptime shprehëse – emocionale, prandaj gjatë analizës të shprehjeve a fjalëve të përdorura në veprat letrare apo në ligjërimin e zakonshëm një rol përcaktues luan ngjyrimi emocional negativ i fjalëve të shprehur me mbiemra ose njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore; *i bën hije tokës kot (i pavlerë), mbytet me një lugë (pikë) ujë (i ngathët), e ka humbur toruan (i nxehur, i nevrikosur), është fyell nga mendja (mendjelehtë) etj.*

Shfrytëzimi me mjeshtëri i pasurisë leksiko – semantike përmes fjalëve të reja ose të vjetra, sinonimeve, antonimeve, krahinorizmave etj. bën të mundur një sistem të larmishëm dhe të ndërlikuar fjalësh apo mënyrash për të shprehur opinione, mendime, vlerësime për mjedisin dhe botën që na rrethon. Po t'i referohemi P. Haxhillazit “ *leksiku me ngjyrim stilistik dhe*

³³ Thomai, J. “Fjalor i frazeologjik i gjuhës shqipe” Botime EDFA, fq. XXXVIII.

emocional e ka numrin mesatar të kuptimeve polisemantike rreth 4,5 kuptime për fjalë....”

(Haxhillazi,P.1986:159) ndërsa “ *në stilin bisedor fjalët përbëjnë afërsisht 6,4 % të njësive leksiko – semantike ...”* (Haxhillazi,P.1986:161)

Pavarësisht nga struktura semantike e fjalëve dhe shprehjeve (fjalë të parme, të prejardhura, fjalë të përngjitura apo togfjalësha etj.) në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë pasqyruar edhe koncepte etnokulturore dhe etnolinguistike;

i bie curles në një vrimë (i mërzitshëm),

është i larë me lëng plëndësi (i pafat),

si maçoku në thekër (i kapardisur),

e lë si lopa bajgën (e pakujdesshme),

është bisht qeni(i pandreqshëm),

i digjet xhani (i përmalluar),

është hoj-broj (i papjekur,i nxituar) etj.

Në mjediset familjare gjatë ligjëritit të përditshëm njësitë frazeologjike janë tepër të zakonshme, prandaj ato mund të jenë të shumëllojshme dhe në larmi me kulturën dhe emocionet e çdo pjesëtari të familjes.

Për të identifikuar këto mjafton të sjellim disa shembuj të njësive frazeologjike me karakter etnolingustik dhe etnokulturore;

si qengj manar(i urtë),

sikur ka ngrënë këmbë pule(spiun,tregon gjithçka),

si qoka me zogjtë(të bashkuar),

e do në dreckë të ballit (kokëfortë, i pagdhendur),

nuk ke ku ta kapësh (i varfër),

është bërë ta përplasësh pas murit(shumë i dobët),

nuk ka mend në poç (kokë) (i trashë, i pamend),

si kope delesh (të bindur,të urtë),

fut spica (ngatërrestar), etj

Po ashtu në njësitë frazeologjike gjejmë të pasqyruara qëndrimet dhe këndvështrimet e individëve, sipas kodifikimit personal, emocionalitetit dhe pikëpamjeve të tyre delikate, në funksion të situatave, dëshirave, urimeve, mallkimeve etj. Njësitë frazeologjike janë shprehje e qartë e veçorive sociologjike dhe mendësisë së një individi ose një bashkësie të tërë;

me mendje të shëndoshë (i zgjuar)

si lopë larë (e lëvizhme,e pakujdesshme)

ua mbedh (rripat) të gjithëve (trim,i zoti)

i shkon uji gjithnjë në hulli (i zoti)

është nga ata që e krip (kripos) djathin vetë (shumë i zoti)

5.2. Lidhja etnokulturore me njësitë frazeologjike

Krahas kuptimit të tyre të drejtpërdrejtë të pikëpamjeve të një individi, njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë një burim i mirë i lidhjeve etnokulturore me mendësinë, larminë e këndvështrimeve dhe vlerësimeve të një grupi të caktuar me lidhje kulurore të njëjta ose të përafërta. Këto njësi përmbajnë larmi informacioni (përvojë jetësore) dhe larmi emocionesh (emotiviteti) për aspekte të ndryshme të jetës. Pikëpamjet e veçanta të pjesëtarëve të një grupi janë pasqyruar në kulturë dhe sigurisht edhe në gjuhë. Kështu njësitë frazeologjike mund të pasqyrojnë edhe këndvështrimet e bashkësisë së tyre edhe nga pikëpamja socialkulturore edhe nga pikëpamja etnografike. Në rrjedhë të kohës gjuha

shërben për të ngulitur përvojën individuale ose kolektive nisur edhe nga një lloj perceptimi i veçantë pohimesh ose mohimesh të veprimeve, të ndjesive, të këndvështrimeve, psh; *do që t'i bjerë shi vetëm në arë të vet (egoist)*

është hoj – broj (mendjelehtë)

si keckë hurdhe (e shkathët)

të çon në det e të bie pa lagur (mashtrues, gënjeshtar)

është nga ata që ta punon nën rrogoz (i pabesë) etj

Duke analizuar shembujt e mësipërm frazeologjikë vëmë re se elementet kulturorë(*hoj-broj, hurdhe, rrogoz*) janë pjesë e njësisë frazeologjike prandaj “*gjuha e një bashkësie nuk është vetëm një mjet i thjeshtë komunikimi, një rregullator i marrëdhënieve të gjithanshme shoqërore, ajo është edhe mjet që të jep mundësinë për formimin e botëkuptimit të individit si pjesëtar i bashkësisë, si dhe shpreh gjithë zbërthimin e qenies shpirtërore të tij. Veçanësia e një gjuhe në raport me një tjetër, krahas dallimeve të njohura, qëndron edhe në faktin se çdo gjuhë përfaqëson në mënyrë shumë origjinale mënyrën se si pjesëtarët e bashkësisë folëse perceptojnë marrëdhëniet e gjithanshme, nga ato ekzistenciale deri në ato etnokulturore. Vetëm në gjuhën e tyre vlerat shpirtërore të një populli gjejnë mënyrën më të mirë të shprehjes, sepse ato nuk janë të krijuara jashtë kësaj gjuhe*”. (Rrokaj, Sh.2012:16)

Gjerësisht në qytetin e Rrogozhinës dhe kryesisht në Shqipërinë e Mesme gjejmë njësi frazeologjike të cilat kanë një përdorim të veçantë dhe domosdo edhe ngjyrim të fortë emocional duke dalluar kështu edhe tipare të kulturës dhe të etnologjisë, psh;

flet la(larë) pa la(larë) (i ndyrë nga goja)

me fëmijën ka hise (pjesë) shpirti (shumë i shtrenjtë)

është kokë maloku (kokëfortë)

e ka kokën me qoshe (i pa bindur)

Këto njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore duket se pasqyrojnë botëkuptimin banorëve dhe këtyre individëve të cilët pasqyrojnë në këtë mënyrë perceptimin e tyre, për disa njerëz të tjerë të së njëjtës bashkësi ose jo.

5.3. Etnologji e përdorimit të frazeologjisë në varësi të grupeve shoqërore

Njësitë frazeologjike hyjnë në ligjërim dhe pasqyrojnë veçantitë e grupeve shoqërore nga të cilat përdoren. Duke iu referuar Prof. Shkurtaç.Gj. te “Sociolinguistika” theksohet: “*Nga ana tjetër, gratë në përgjithësi janë të përjashtuara nga përdorimi i një vargu shprehjesh e fjalësh të lidhura me disa sfera tabu siç janë sfera e seksualitetit, punët e rënda bujqësore, mekanika e rëndë etj.*” (Shkurtaç, Gj.1996 :167).

Në rrethana të caktuara njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore zhvillohen edhe ndryshohen sipas rastit nga gratë duke mishëruar edhe mënyrën e tyre të menduarit, ose të jetuarit, psh;

janë arkë e dry – të ngushtë, (shumë të lidhura): Duke qenë se në marrëdhëniet familjare bija dhe nëna janë shumë të lidhura, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga mendësia (meqënëse janë të dyja femra), pra shumë ë ngushta. *Janë nënë e bijë, arkë e dry.* (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, fq.6)

e kalbur në bark – e keqe, (shpirtzezë) një shprehje e tillë mes një grupi grash nuk ka vetëm kuptimin e një gruaje me zemër të keqe, por përdorimi i saj arrin një shkallë sipërore dhe kërkon të identifikojë një grua shterpë dhe me zemër të keqe.

m’u bë barku petë - e uritur, njësia përdoret në trajtë krahasuese, sepse petët janë asortimente të pregatitura nga gratë dhe krahasimi me to identifikon një njeri që është i

uritur, ndonjëherë janë gratë të cilat përdorin edhe një shprehjeje të tillë: *më bie të hollë* - shumë e uritur duke identifikuar me hollësinë e petëve.

e ka gojën behar – gojëmbël, njësia frazeologjike identifikon mendimin për një nuse të re, të bukur dhe gojëmbël, një mendim i tillë gjen vend edhe në njësi të tjera si: *e ka gojën mjaltë, e ka gojën sheqer*.

bilbil në kafaz – e zonja, vajzë e mirë, vajzë për shtëpi që nuk del. Kjo njësi shpalos mendimin për një vajzë nikoqire dhe të ndershme.

- Çupë për kokë të çupës, është bilbil në kafaz. (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, fq.27)

bollë e vrarë - e lodhur, bolla është një lloj gjarpri e trashë dhe zakonisht gjendet pranë banesave të fshatit dhe ushqehet me minj ose zogj. Këtu përdoret në kontekstin e lodhur, e ngathët, e pafuqishme, kjo i referohet një gruaje jo të shkathët dhe përtace.

- Ajo është si bollë e vrarë, nga hallet. (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, fq.32)

është me dy fije brinjë - është kockë e lëkurë, e dobët – mendimet e grave vijnë si formësimet të mendësisë tradicionale, se një nuse e dobët nuk mund të sjellë në jetë trashëgimtarë të shëndetshëm dhe kjo për komunitetin e grave duhet zgjedhur me kujdes. Njësia frazeologjike *si këmbë zogu* – identifikon dhe emërton një vajzë hollake ose **si e ushqyer me miza**.

nuk i digjet buka – e shkathët, e zonja, në këtë njësi kemi shpalosjen dhe ngurosjen e mendimet në të veçantën e një vajze a zonjë shtëpie.

i ha bukën gomari – i pazoti, i paaftë, njësia frazeologjike me vlerë mbiemërore përdoret mes shoqeve për të dhënë mendime rreth një personi të tretë dhe gjykimin e tyre për të si në

njësinë: i ha pula bukën nga dora

i ka ngrënë macja brumin – i mërzhitur, kjo njësi frazeologjike i ka fillesat dhe përdorimet nga graria për arsyen e thjeshtë se graria mbruajnë brumë dhe bukë në magje. Siç vëmë re nga shembujt e gjetur në Fjalorin Frazeologjik të Gjuhës Shqipe dhe në ligjërimin e përditshëm përdorimi i fjalëve të përdorura nga gratë është sa delikat aq edhe pjesë e aktivitetit dhe angazhimeve të punëve të grave si : në të gatuar (në magje, përdorimi i fjalëve brumë, bukë, petë etj). Përveç këtyre graria shfaqin edhe mendimet e tyre në lidhje me një cilësi të dikujt a të diçkaje psh: i ka duart e arta, e kam si sytë e ballit, dhi e egër, legen i shpuar etj.

çakalle mulliri – llafazane, njësia frazeologjike me siguri përdoret nga graria kryesisht në fshat sidomos kur presin në radhë për të bluar në mulli, njësia ka si përbërëse emërtimin e një kafshe të egër pylli (çakalle) që identifikon një njeri të shkathët e çapkëne.

i shartuar në degë - i vrazhdë, kokëkrisur, njësia frazeologjike përdoret nga graria për të shprehur mendimin për një djalosh, të rrëmbyer dhe kokëkrisur.

Psh : *Të madhin e kishte djalë të shtruar, por i vogli ishte i shartuar në degë.* (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, fq.66)

bëhet diell – e mirë, e shkathët, njësia ka si vatër kuptimor burimin e energjisë universale, diellin dhe identifikon me një njeri të mirë që bën edhe të mira të mëdha.

i ka hyrë djalli në bark – smirëzi, njësia frazeologjike pasqyron mendësinë për një njeri i cili e ka ndryshuar sjelljen e tij për keq dhe për të përcjellë një ngjyrim të veçantë të kësaj të keqeje identifikohet me djallin.

është bërë për ta lidhur në djep – i dobët, i mplakur, i tkurrur, njësia me siguri lidhet me mënyrën e rritjes së fëmijëve dhe lidhjen e tyre në pelena, që identifikojnë rritjen dhe

përkujdesjen e nënave për foshnjat e tyre. Mendimi lidhet me trupin dhe shtatin e parritur të foshnjave, të dobët dhe të vogël

e ka zemrën e dobët – e butë, e ndjeshme, njësia frazeologjike përdoret për të shfaqur mendimin zakonisht për gratë, sepse ato kanë natyrë më të butë , më të ndjeshme dhe nuk mund të durojnë tronditje të forta shpirtërore.

ka duar të arta – punëtore, njësia zakonisht përdoret nga graria për të vlerësuar një vajzë punëtore, së cilës i vjen ndoresh gjithçka, këto mendime pasqyrohen edhe në njësi të tjera që nga kuptimi janë të përafërta me të psh: *i ka duart flori* dhe *ç'i sheh syri ia bën dora të thyhet në dorë* - i brishtë, delikat, njësia përcjell mendimin për një send a objekt që lidhet me brishtësinë dhe delikatesën e tyre.

si drita e diellit – e qartë, e pastër, kjo njësi frazeologjike lidhet me kujdesin femëror dhe pastërtinë, ky mendim i grave shfaqet i qartë mbi pastërtinë vjen e pasqyrohet në shkallë sipërore, pra shumë e qartë dhe e pastër

e kam si drita e syve – të shtrenjtë, njësia frazeologjike identifikon një gjë tepër të shtrenjtë për një grua ajo është fëmija, për këtë mendim përdoret edhe njësia frazeologjike : *si sytë e ballit*

dhi e egër – vajzë a grua e shkathët, njësia frazeologjike përdoret nga gratë për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me një vajzë tepër të shkathët dhe e gjallë dhe ndonjëherë e pashoqerueshme.

e ka gjakun të ëmbël – e dashur, e shoqërueshme, njësia frazeologjike përcjell mendimet për një vajzë e cila veçohet nga të tjerat, sepse ka një cilësi të sajën , ajo është e dashur dhe e ëmbël.

nxjerr dhjam nga pleshti – koprace , njësia frazeologjike përdoret nga gratë për të dhënë

mendimin e tyre për një shoqe që është mjaft koprace, krahasimi vjen në trajtë ironizuese, sepse pleshti është një insekt shumë i vogël dhe nuk ka as mish e as dhjam , këtu njësia përdoret në konotacion keqdashës dhe tallës.

t'ia rrëmbesh kokën – e bukur shumë, perri, njësia frazeologjike pasqyron mendimin e grave për një vajzë a djalë tepër të bukur dhe shumë të mirë gati –gati një bukuri mitike, prandaj këto mendime shfaqen edhe në njësi të tjera si: *t'i presësh kokën*

legen i shpuar - llafazan , njësia frazeologjike besoj se përdoret më tepër nga graria duke qenë se sendi që është përdorur për të krahasuar dhe për të pasqyruar mendimin ose opinionin e tyre (legeni) përdoret nga gratë. Legeni kur është i shpuar nuk mban ujë edhe njeriu për të cilin flitet është njeri që s'mban fjalë. Për të shfaqur mendimin edhe për një natyrë tepër llafazane përdoren shprehjet: *e ka gjuhën lëpjetë* (lëpjeta është një lloj lakre e egër e cila gatuhet dhe ka gjethe të gjatë) ose *e ka gjuhën lopatë* (edhe këtu merret si cilësim gjerësia e lopatës, pjesa metalike e cila ka ngjason edhe me formën gjuhës)

i qepur me pe të bardhë - i qartë, i dukshëm – Kjo njësi shfaq mendimin e grave për një dukuri a veprim që është bërë pa kujdes dhe është i dukshëm, pra është e kotë të fshihet ajo që duket. Nëse për të bërë një qepje të kujdesshme gratë përshtatin ngjyrën e perit me ngjyrën e copës, kjo njësi bën të dukshëm një gabim ose një defekt që vërehet lehtë.

mbeti qyqe – e vetmuar, njësia frazeologjike përdoret nga graria për të shfaqur mendimin e tyre për një njeri që ka mbetur vetëm, pasi ka humbur të afërmit e saj. Qyqja në mendësinë popullore është një shpend që jeton vetëm, prandaj edhe krahasimi i një njeriu të mbetur vetëm bëhet me të.

e ka zemrën pulë - frikacake, njësia frazeologjike përdoret për të pasqyruar një tipar ose një cilësi të veçantë të një gruaje edhe pse ajo në tipologjinë e vet krahasohet me një shpend.

Pjesërisht shprehjet e përdorura nga gratë lidhen me jetën e tyre të përditshme dhe punët e tyre si: gatimi, pastrimi, qepja, rritja e fëmijëve, kujdesi për kafshët shtëpiake etj.

Edhe njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore tregojnë se në grupe të caktuara shoqërore ka mënyra të veçanta të të menduarit dhe të të shprehurit, duke nxjerrë në pah vlera të jashtëzakonshme të gjuhës duke shfrytëzuar edhe sende a mjete të tjera për të bërë krahasimin duke u mbështetur në cilësinë a rrethanat e një shpendi ose një kafshe.

5.3.1. Etnologji e përdorimit të njësive frazeologjike nga burrat

Në mendësinë popullore ka gjithnjë fjalë dhe shprehje që përdoren vetëm nga burrat, adresuar atyre ose vetëm në ambjente të caktuara për ta, duke bërë të mundur që një pjesë e shprehjeve të përdoren vetëm nga meshkujt, kjo nuk është vetëm pjesë e vlerësimit por edhe konceptimit të disa punëve që i bëjnë vetëm burrat (si lufta, pija dhe punët e rënda të bujqësisë)

e zuri rakia – i dehur, njësia frazeologjike jep cilësinë e një njeriu që është pijedashës dhe është dehur (për kujtesë gratë në mendësinë tonë nuk mund të dehen), për këtë mendim rreth natyrës pijedashëse mashkullore përdoren edhe njësi të tjera si: *u bë rrumbull*, *u bë xurxull*, *u bë thumb*. Në këto njësi nuk kemi vetëm mendimin rreth njeriut të dehur por edhe mënyrën jo korrekte të veprimit të tij.

u bë rrip daulleje – i trashë, i paaftë, njësia frazeologjike përcjell mendimin se njeriu për të cilin bëhet fjalë është i paaftë dhe i trashë, që nuk kupton.

të rruan pa lagur – batakçi, mashtrues, në këtë njësi frazeologjike mendimi që përcillet është për një njeri tepër mashtrues e batakçi, për të shfaqur këtë mendim përdoret edhe shprehja *të çon në det dhe të nxjerr pa lagur*.

stallë derrash – i papastër, i pisët përdoret për të dhënë mendimet për një ambient të papastër, ose të rrëmujshtëm.

e merr vdekjen në sy – trim, guximtar, njësi frazeologjike përdoret për të vënë në dukje cilësinë e një njeriu guximtar duke shprehur të kundërtën e saj, pra nuk ka frikë vdekjen, por e pret me trimëri. Për të sjellë në vëmendje këtë cilësi burrërore përdoret edhe kjo shprehje: *nuk i vetëtin syri, e ka syrin pushkë* - trim ose *e ka syrin shkëndijë*

e ka kokën shkëmb – kokëtrashë, përdoret për të dhënë mendimin për një njeri që nuk zë mend ose nuk kupton, nuk bindet etj. Krahasimi me shkëmbin vjen dhe realizohet për të konceptuar fortësinë e shkëmbit dhe të kokës së njeriut.

nuk e ka shokun – i zoti, trim, punëtor, njësi frazeologjike përdoret për të dhënë me superlativa cilësitë e mira të një burri që nuk krahasohet me askënd tjetër.

e ka gjakun shpuzë - shumë i shkathët, trim, i papërmbajtur, njësi përdoret për të vlerësuar gatishmërinë e një njeriu të mirë dhe të sakrificës, i papërtueshëm, pjesëza mohuese kërkon të përcjellë mendimin se ai është i vetëm në llojin e vet.

i shartuar në trung – i mirë, i sjellshëm, i kuptueshëm, megjithëse është përdorur si model një proces që kryhet vetëm tek bimët frutore, shprehja është tepër e zgjedhur për kontekstin në të cilin përdoret. Mendimi se një filiz apo një i ri është i mirë, i sjellshëm dhe komunikues, qëndron edhe në shprehjet: *dardha bie nën dardhë dhe degët do ngajnë nga rrënjët*

të ngul thikën pas shpine – i pabesë, kjo shprehje gjen përdorim në mjedise maskiliste duke iu referuar natyrës së pabesë edhe të armikut dhe të tradhëtarit, që historia e popullit tonë ka njohur shumë. Duke qenë se formulimi i njësisë ka karakter luftarak edhe lufta është mjedis për burrat.

ujk i vjetër – i sprovuar, i pjekur, i zoti

vetë vali e vetë kadi – i plotfuqishëm, njësia frazeologjike përdoret për të cilësuar një njeri me pushtet dhe që bën si do vetë, pa pyetur askënd. Megjithëse ka edhe njësi të tjera frazeologjike që shprehin po të njëjtën cilësi dhe që përdoret në mjedise burrash si: *vetë zot e vetë shkop*

s'ka dalë nga veza – i ri, i parritur, i papjekur, njësia përdoret për të emërtuar dhe cilësuar një djalë të parritur mirë, të pa rrahur me jetën.

ka zemër lepuri – frikacak, shprehja frazeologjike me vlerë mbiemërore përdoret për të veçuar një cilësi të caktuar të cilën e ka edhe lepuri. Krahasimi me lepurin vjen e bëhet më tronditës për faktin se kjo kafshë është shumë frikacake dhe si i tillë krahasimi bëhet në shkallë sipërore .

Në njësitë frazeologjike mbiemërore pasqyrohen mjaft cilësi të gjendjeve njerëzore, mendimeve , ideve të cilat nguliten në gjuhë dhe për një send a për një cilësi mund të hasim njësi me anë të të cilave koncepti emërtohet në disa mënyra duke krijuar kështu marrëdhënie sinonimike për cilësitë e një frymori a të një sendi.

i kishin hypur xhindet – i nervozuar së tepërmi

i kish vajtur thika gjer në eshtë – i rraskapitur, i lodhur, i varfër

i bërë derr – i mërzhitur

i hypën gjaku në kokë – është gjaknxehtë

i ziente zemërimi në zemër – i zemëruar

Njësitë frazeologjike të cilat pasqyrojnë mënyrën e të menduarit dhe përvojat e ndryshme të njerëzve që e përjetojnë dhe reflektojnë qëndrimin e folësve mund të përdoren për të zëvendësuar një mbiemër, brenda një fjalie. Në shembujt e mëposhtëm do të vëmë re se

njësitë frazeologjike mbiemërore janë një mundësi e pafundme për të krijuar lidhje të reja fjalësh ose kuptime të reja me ngjyrimë të shumta stilistikore.

si një re e vogël e bardhë - e lëvizshme, e përkohshme

i kish rënë leshi i kokës – qeros, i pa flokë

si pe merimange – i hollë

si djelli i muajit maj – i qartë

Në shumicën e rasteve njësitë frazeologjike pasqyrojnë një bazë të njohur apo të panjohur në lidhje me cilësinë a sendin me të cilin krahasohen ose merren në konsideratë, sidomos në aspektin historik që reflektohet në njësitë e mëposhtme:

nuk ishin syleshë – të kujdesshëm, të vëmëndshëm

si ata qentë e liq që të hanë nga prapa – të pabesë

të fshinte nga faqja e dheut – trim

të merr gjak në vetull – guximtar

si një lis i madh me fletë - trim i mirë me shokë shumë

nuk i veton ashka e syrit – trim

Njësitë frazeologjike janë elemente të pasurimit të gjuhës dhe si të tilla ato mund të shërbejnë për të ruajtur vlerat shprehëse dhe figurative në gjuhën shqipe, sidomos në përdorimin e metaforave, similitudës (krahasimit të zgjeruar), metonimisë, personifikimit etj.

5.4. Disa njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore nga zona e Rrogozhinës

Fondi i pasur i njësive frazeologjike në ecurinë e gjuhës shqipe vjen gjithnjë duke u zgjeruar, duke u plotësuar me fjalë dhe shprehje. Gjallëria e jetës, bukuria dhe sfidat e saj ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e gjithësecilit, mirëpo secili prej nesh ka aftësinë dhe

këndvështrimin e tij për shqetësimet dhe eksperiencat jetësore. Me mjaft interes i shohim për të sjellë në këtë punim edhe njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore që janë në përdorim në jetën e përditshme të qytetit të Rrogozhinës dhe zonave përreth duke prezantuar edhe disa veçori të tyre.

Në njësitë frazeologjike janë të njohura tanimë tipat e marrëdhënieve sinonimike, antonimike, homonimike etj. duke nxjerrë në pah mjaft elemente të krahinave të veçanta shqipfolëse kështu që edhe e folmja e Rrogozhinës ka tiparet e saj në njësitë frazeologjike të cilat u përkasin fushave të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Duke pasur parasysh karakteristikat e shumëkuptimisë dhe marrëdhëniet semantike mes gjymtyrëve brenda njërive frazeologjike dhe lidhjet e tyre kuptimore bashkërendimi i punës tonë bëhet më i plotë ;

u dogj 31-sh (i pafat, fatzi) – thuhet për një njeri që humbet një mundësi të mirë dhe nuk i jepet më kjo mundësi

pa çati mbi krye (i varfër) – thuhet për një njeri që është tepër i varfër

është veremli (i sëmurë, shëndetlig) – thuhet për një njeri që duket tepër i dobët, i sëmurë dhe shëndetlig

është ku rafsha mos u vrafsha (moskokëçarës) – thuhet për një njeri që nuk çan kokën për problemet dhe shqetësimet

është një njeri që nuk trazohet (i duruar, moskokëçarës) - thuhet për një njeri që nuk çan kokën për problemet dhe shqetësimet

5.5. Njësi frazeologjike nga bota bimërore

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë shpalosje e lidhjeve konceptuale ose ndijimore e një grupi a një bashkësie të caktuar për aspekte të rëndësishme të punës dhe të

aspekteve të veçanta të jetës njerëzore. Kështu në rrethinat tona janë shumë të përdorshme njësitë frazeologjike që kanë lidhje me botën bimore ose kanë të pranishme një bimë të njohur mirë duke nxjerrë në dukje veçanësinë e saj.

Frazeologjia e rrogozhinasve është mjaft e pasur dhe e larmishme, meqenëse qyteti ka një pozicion gjeografik të favorshëm që lidh lindjen me perëndimin dhe veiun me jugun e Shqipërisë. Kjo zonë është konsideruar nga studiuesit e dialektologjisë si zonë e ndërmjetme në hartën e dialekteve dhe të nëndialekteve të shqipes, kështu ajo ka tipare edhe të të folmes së zonave të mbi dhe nën lumin Shkumbin dhe tiparet më të dukshme janë ato të Shqipërisë së Mesme.

Frazeologjizmat e pasqyruara në shembujt e mëposhtëm kanë në themel një bimë të njohur nga të gjithë, kështu që edhe veçoritë e tyre njihen nga të gjithë, prandaj tërësia kuptimore e njësisë është e njohur. Një vend shumë interesant në këto frazeologjizma zënë ato me vlerë leksiko – gramatikore mbiemërore, të cilat transmetojnë mendime dhe këndvështime që lidhen me një element të bimës dhe këto njësi janë të shumëllojshme;

a) Njësi frazeologjike që janë të përbëra nga folje + emër + lidhëz krahasuese + mbiemër;

i bëjnë sytë(si) lule lini – i lodhur

Kaloi gjithë ditën duke qepur në makinë (qepëse) dhe tani i bëjnë sytë lule lini.

Vajza dukej çapkëne, e gjatë, hollake dhe me flokë si mustaqet e misrit.

me flokë si mustaqet e misrit – jo të bukur, të rrallë

b) Njësi frazeologjike që janë ndërtuar me folje + grup emëror

Aq i lodhur isha sa më bëjnë sytë tek a çift.

i bëjnë sytë tek a çift – i sflitur nga lodhja

c) Njësi frazeologjike të ndërtuara me folje + emra

E shikoni të urtë, por kur duhet e ve kufinin te thana.

e ve(vë) kufinin te thana - i drejtë, i paanshëm

Vërtetë duket simpatik, po është kungull pa farë.

është kungull pa farë - i papjekur, mendjelehtë

Sado që ka hedhur shtat, por është poç pa bërthamë.

është poç pa bërthamë - mendjelehtë

Djali mbushi të gjashtëmbëdhjetat, po ta shohësh është sa një macurr misri.

është sa një macurr (kalli) misri - i vogël, shtatshkurtër

Gjithnjë punon pa u lodhur, por në fund bën not me poça.

bën not me poça – i varfër dhe mendjelehtë

Megjithëse e ka mbaruar gjimnazin, është dy kokrra në majë e asnjë në degë.

është dy kokrra në majë e asnjë në degë – mendjelehtë

Këtë e dinin të gjithë ai nuk ka fije kallami.

nuk ka fije kallami – dredharak, mashtrues

Kjo nuk ishte e panjohur për të, ai kërcente degë më degë.

hidhet (kërcen) degë më degë – i lëvizshëm, i pabesë

Në varësi të kontekstit të përdorimit mjaft prej këtyre njësive marrin edhe vlera të tjera; foljore, ndajfoljore ose emërore.

5.6. Njësi frazeologjike nga bota shtazore

Ligjërimi ynë ka një formë të caktuar dhe si e tillë ka edhe një përmbajtje të caktuar, në varësi të mendimeve që duam të përcjellim, në varësi të gjendjes emotive që duam të shfaqim apo në varësi të kontekstit që përshfaq njësia frazeologjike. Në më të shumtat e rasteve njësitë frazeologjike janë ndërtuar në funksion të rrethanave të ligjërimeve,

familjare ose jashtëfamiljare, profesionale ose jashtëprofesionale. Kështu ato mbartin komponentë edhe të sociolinguistikës edhe të psikologjisë së grupeve nga të cilat përdoren, siç pohon Shkurtaj “*Edhe njësi të tilla, pak a shumë të vogla, si e folmja e një katundi apo e një qyteze, rezultojnë të jenë të përbëra nga shumë varietete më të imëta apo “gjuhë” të individëve*” (Shkurtaj, Gj. 1996 :104) si në rastet e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore të mëposhtme;

a) Njësi frazeologjike të përbëra nga folje + lidhëz krahasuese + emër + mbiemër;

Edhe kur merr pjesë në biseda, hidhet (kërcen) si gjeldeti.

hidhet si gjel deti - i rrëmbyer

Ashtu ishte natyra e tij hidhej si kërcente pleshti.

kërcente si pleshti – i lëvizshëm

Ai kishte ndryshuar, ishte bërë si cjamin me zile.

ishte bërë si cjamin me zile – budalla

b) Njësi frazeologjike të përbëra nga folje + emër

Megjithëse merr pjesë vazhdimisht në lojë ka qimen e derrit.

ka qimen e derrit - i pafat

Të marrim edhe mendimin e tij, se ka një barrë mend.

ka një barrë mend - shumë i mençur

Djali është dele Perëndie, nuk ndihet fare në shtëpi.

është dele Perëndie - i urtë

c) Njësi frazeologjike të përbëra nga pjesëz mohuese + folje + emër

Gjysha është zemërmirë, por s’ta kref bishtin kollaj.

s'ta kref bishtin kollaj - e sertë, e drejtë

Babai qëndron ulur në kanape dhe nuk duron mizën.

nuk duron mizën - i paduruar, i sertë

Nipi është aq i rritur sa nuk ia ha dhia tagjinë.

nuk ia ha dhia tagjinë- i rritur, i zgjuar

d) Njësi frazeologjike të përbëra nga sa + numëror + folje + emër

Xhunga në kokë i qe bërë sa një vezë pate.

Mollët ishin bërë sa një vezë pate.

sa një vezë pate – e vogël ose e madhe (varet nga konteksti)

Pjepri ishte rritur e ishte bërë sa një kokë lope.

sa një kokë lope – i madh

Megjithëse vitet kishin kaluar, djali kishte mbetur sa një çerr.

sa një çerr – i vogël

e) Emër + emër me parafjalë nga:

Pamja e tij të mahnit, po nga mendja është kërcu mizash.

kërcu mizash nga mendja – jo i mençur, budalla

U kuptua menjëherë që djali, dukej sikur sapo kishte dalë nga veza.

sapo ka dalë nga veza – i ri, i parrahur me jetën

5.7. Njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore nga fusha të ndryshme

Duke iu referuar Halliday-it i cili mbështet pikëpamjen se gjuha në kontekstin social mund të përshkruhet “si potencial i kuptimit ku të kuptuarit është formë e sjelljes gjuhësore³⁴”

³⁴ Halliday, M. “Exploration in the Functions of language”, pg.72 , Arnold, London, 1973 vep. e cituar në Varfi,N & Dibra,K. “Gjuhësi Teksti” fq 17. Albatros, Tiranë, 2007

Sipas kontekstit ligjërimor njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore mund të përforcojnë një cilësi, tipar, sjellje, ide apo mendim të ligjëruesve në bisedim e sipër duke vënë theksin tek një prej gjymtyrëve përbërëse të njësive. Jo gjithmonë vlera e njësive jepet drejtpërdrejt, por nga ana tjetër funksioni i saj mund të jetë që të shpalosë ngjyime emocionale duke shfrytëzuar krahinorizmat ose fjalë në dialekt të zonës së Rrogozhinës si në rastet e mëposhtme;

u dogj 31-sh (i pafat, fatzi)

është veremli (i sëmurë, shëndetlig)

është ku rafsha mos u vrafsha (moskokëçarës)

i bën lëmsh të gjitha (ngatërrestar)

i velur (velitur) nga e mira (i pasur, i ngopur)

është rob Zoti (i urtë)

hyn kot në pjesë të tjetrit (ngatërrestar)

është tra-la-la (mendjelehtë)

është copë-copë nga mendtë (mendjelehtë)

i bën fresk (veri) gjithë ditën (dembel,servil)

është nunarec(zevzek, i besdisur)

është hundëlesh (gjakxehtë,trim)

i mbeti goja çark (llafazan)

i kanë dalë sytë e ballit (i verbër)

i kanë humbur mendtë (budalla)

i kemi ngrënë flinë (i vogël krahasuar me ne)

i kemi thënë 'të të rrojë' (i vogël krahasuar me ne)

është thëngjill i mbuluar (tinëzar, dinak)

të qep me shtatë gjylpona (mashtrues)

të len në mes të katër rrugëve (i pabesë)

trazon edhe gurët e rrugëve (trazovaç)

të çon në det e të sjell pa u lagur (gënjeshhtar)

është lahu sot e rruhu mot (dembel, i paaftë)

është punë që bën adhap (të lodh) (e lodhshme)

Në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore nënteksti dhe konteksti mund të jenë në vlera mohuese, psh;

nuk i mehet(mbaron) pasuria e bollëku (i pasur)

nuk i bëjnë sytë dritë(i zemëruar keq)

pa strehë mbi krye (i varfër)

nuk i jep llogari njeriu (indiferent, moskokëçarës)

nuk i ka sytë në ballë (i pavëmendshëm)

nuk kursehet kurrë (është bujar)

a) Disa njësi të tjera frazeologjike nga arti i kuzhinës:

është + ...

brumë i paardhur = i papjekur, i parrahur me jetën

si bakllava me arra = shumë i mirë, cilësor

si pelte = e mirë, e trashë

mjaltë me hoje = shumë i mirë, cilësor

bërë që ta presësh me thikë, pikë gjaku s' i del = i hidhëruar shumë

që ta presësh me thikë (kosi nga qumështi i deles) = i trashë

5.8. Përdorimi i njësive frazeologjike në disa fusha si modele në ngjyrat.

Në disa shprehje frazeologjike do të analizojmë marrëdhëniet kuptimore mes fjalëve ose shembujt e shkëputur nga letërsia artistike, për të hedhur dritë sadopak në marrëdhëniet që krijon njeriu me natyrën që e rrethon dhe perceptimin e tij për botën, mjedisin, dukurinë a ndjesitë njerëzore, këto vëzhgime do të krahasohen edhe me gjuhën angleze.

Njësia frazeologjike mbiemërore ka përgjithësisht kuptimin e mbiemrit predikativ dhe si e tillë gjymtyrët e saj mund të shkrijnë kuptimet e tyre dhe të jenë të njëvlershme për nga funksioni me fjalën. Në shembujt e mëposhtëm do të vëmë re sesi gjejnë përdorim njësitë frazeologjike mbiemërore në zona të ndryshme dhe në grupe a bashkësi të ndryshme.

e bardhë si dëbora - white like a snow - lidhja kuptimore e njësisë vjen prej ngjyrës së bardhë të borës, bardhësia e saj identifikohet edhe me pastërtinë e sipërfaqes të mbuluar me borë, përndryshe e pashkelur, e pabërë pis)

i bardhë si mermeri – ka edhe mermer me ngjyrë të bardhë, prandaj edhe krahasimi i portretit të personazhit me objektin bëhet, në bazë të ngjashmërisë duke marrë si indikator ngjyrën, ndoshta merret si indikator edhe sipërfaqja e lëmuar, nëse portreti i personazhit është pa shprehje.

e bardhë si biluri (Shkodër) – krahasimi bëhet duke marrë si bazë ngjyrën e bilurit (porcelanit) që është shumë i bardhë.

e bardhë si pëlhura e kaurkave - krahasimi me pëlhurën e bardhë të kaurkave bëhet duke sjellë në imazhin tonë pastërtinë e pëlhurës dhe nikoqirllëkun e kaurkave, duket se kjo njësi frazeologjike përdoret nga ajo pjesë myslimane e popullsië, për të sjellë edhe vlerësimin e tyre pozitiv dhe bashkëjetesën dhe tolerancën fetare, në mos edhe një shembull pozitiv për pjesën tjetër jo myslimane.

e bardhë si niseshteja e turkave – kjo njësi frazeologjike me bazë krahasuese bëhet në bazë të ngjyrës ose kolorit të niseshtesë dhe nga ana tjetër na sjell në vëmendje edhe një tipar tjetër të fshehtë të turkave(myslimaneve) që dinë të jenë edhe amvisa të mira.

e bardhë si gëlqerja – like whitewash (qumësht gëlqereje) trajta krahasimore e kësaj njësie frazeologjike shfaq një kuptim të drejtpërdrejtë dhe lidhet me objektin në bazë të ngjashmërisë së ngjyrës

e bardhë si qumështi – as white milk (prodhime qumështi) megjithëse e bardha e qumështit nuk është tepër e bardhë, përsëri trajta krahasimore e saj të jep konceptin e të bardhës.

i sheh gjërat bardhë e zi – black and white (i njëanshëm), kjo pranëvënie në bazë të kontrastit bëhet për të treguar qëndrimin e një njeriu të pavendosur, ose të njëanshëm, ndërsa në mënyrë të drejtpërdrejtë kuptimi i kësaj njësie frazeologjike të bën të mendosh për ndonjë anomali të shqisave të të parit.

e ka shpirtin e bardhë (e ka zemrën e bardhë) zemërgjërë, bujar, dashamirës – duket se në gjuhën angleze nuk e ka gjegjësen, ngaqë në mentalitetin e tyre nuk përdoret një formulim i tillë konceptor, kjo shprehje identifikon një prej virtyeteve më të rëndësishme të shqiptarit, pjesë e traditës shumë shekullore të trashëguar brez pas brezi , bujarisë

një grusht me parë të bardha –njësia frazeologjike fsheh një kuptim që nuk lidhet aspak me ngjyrën e parave, po me mënyrën e drejtë dhe të ndershme me të cilën janë fituar ato para.

të qëron të bardhën e syrit (shumë trim,i shkathët) – dressed in white (e bardhë e syrit) kjo njësi frazeologjike nuk i largohet kuptimit të parmë, sepse drita e syve është gjëja më e shtrenjtë për njeriun dhe e vetmja përmes së cilës shohim dhe arrijmë të lidhemi me botën që na rrethon.

me faqe të bardhë - i ndershëm, vetëm një njohës i mirë i shqipes arrin ta kuptojë se kjo njësi frazeologjike nuk rrek të tregojë ngjyrën e faqes së personazhit po lidhet me një virtut si ndershmëria

është flokëbardhë (i thinjur), i ka rënë bora (në krye) (i thinjur, i plakur) – white haired njësi frazeologjike është e barazvlershme me fjalën dhe si e tillë ajo është përdorur për të identifikuar një njeri me moshë të thyer, me flokë të thinjur dhe që ka fituar mjaft përvojë në jetë.

Në gjuhën angleze ka disa përdorime të mbiemrit ‘white’ në raste veçanta të njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore në të cilat nuk i gjejmë në gjuhën shqipe. Pse?

Nga arsyetimi i thjeshtë mjaft prej këtyre koncepteve për jetën, mjedisin lidhen me mënyrën e perceptimit të një bashkësie a një grupi shoqëror të caktuar.

Psh white – crow (korb i bardhë),

white –elephant (punë e padobishme),

white – lie (gënjeshtër e vogël, e parëndësishme),

white – coal (qymyr i bardhë, hidroenergjia),

white – hot passion (pasion i zjarrtë),

white – blooded (i pagjak, anemik)

*Kjo më ngushëlloi pak. Po jo së gjithash , se kisha pasur natën **një grusht pare të bardha** nëpër duar e m’i kish tretur mëngjesi. Mora përsëri bukë e djathë e dola në Mburima, ku uji mburonte glu – glu – glu, me fluska të rrumbulla; ku ngriheshin e binin fije shuri. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 73)*

Ish kaq i tretur ky Kapllan aga sa mezi i ngjante agos tonë të parë, që e dinim sa një lis të plotë. **I bardhë si sheleg**: me flokë, me vetull, me mustaqe. Po i gëzuar, i gëzuar si s'kish tjetër në botë! (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 9)

Të nesërmen kur mori vesh fshati çudinë, erdhi, me qefalie në krye, t'i lutet që t'i shpëtojë të gjithë nga minjtë. Edhe djali, që **ish zemërbardhë**, i shpëtoi nga minjtë sa ment u çmend bota nga gëzimi.(Mitrush Kuteli,Tregime të zgjedhura, fq. 99)

Në qenka puna kaq trashë, haj! Edhe ne , dyfeqet mbi sup e oburra! Për në Kozicë, ku janë qypat rëngë me florinj. Kjo ka qënë , që thua ti , **një natë** me hënë po **e bardhë** , sikur të paskej rënë dëborë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 24)

U guros agai nga dhembja, kur e sollën të birë nga lëmi, në tirë. U guros më fort kur i pa fytyrën **si qiri i bardhë**, që s'i ngjante asfare njeriut të gjallë – po tjetër bote. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 53)

...Edhe si foli këto, burri ndër të bardha u ngrit përpjetë, lart e lart, edhe **u tret si një re e bardhë**. (Mitrush Kuteli, Tregime te zgjedhura, fq. 58)

Asohere në kohën e foshnjërisë sime, perëndia ish një plak i lashtë, i plotë nga shtati,që rrinte diku, atje lart këmbëkryq, e qepte **me gjilpërë e shajak të bardhë**, për të veshur botën. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 74)

Ne rrinim këtej, me të mëdhenjtë. Edhe Marina ish atje tej: **më e bardhë se niseshteja e turkave e se pëlhura e kaurkave**. Këtë ma panë sytë e mi! (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 173)

Në ka ndonjë hidhërim në shpirt ky Tërfili i vogël që e përkëdhelje me duart e tua të punuara, ky hidhërim është se s'gjendet në botë një qiri kaq i madh për t'u ndezur atij

shpirtit tënd të bardhë, që bënte qymyr të zi...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.185)

...Bridhte era nëpër qiell edhe çonte e përçonte larg **ret' e bardhëza si vela lundre**. Aq shumë e desh Kirolloi Katerinëzën, sa desh ta bënte mollë e ta mbante në gji. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura , fq. 208)

Edhe sa për verë, gjer aty sa e ktheu prapë, se butet ishin në dera edhe plloskat në goja: me trendelinë, me borzilok – e lehtë a e rëndë – **si të ta desh e bardha zemër**. E sa për të ngrënë s'ka si bëhet më mirë...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 227-228)

Shpirtrat e lumtur që silleshin mbi të **ishin të bardhë si argjendi** i larë, e gjithë të bardhë ishin edhe ata që shkuan nëpër ujë. Qëndruan që të dy anës e vështruan bukurinë që buronte atje ku zoti ka stisur fronë e tij. (Mitrush Kuteli,Tregime të zgjedhura, fq. 233)

Balli i Marinës sime rrihte të ngrysej e nuk ngrysej dot. Ishte i sheshtë, **i bardhë si mermeri**. Tamam si Mali ynë i Thatë kur vishet me dëborë, që e bën të shndritë dielli i janarit të mirë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 247)

i zi si sera – njësia frazeologjike është realizuar në bazë të ngjashmërisë dhe ngjyrës, sera është nënprodukt i naftës që shërben për të shtruar rrugët dhe ka ngjyrë të zezë.

i zi si korbi – (shumë i zi),baza krahasimore e kësaj njësie frazeologjike bëhet jo vetëm në bazë të ngjyrës, pra kolorit po ky krahasim vjen edhe nëpërmjet kuptimit të fshehur që ka një lidhje jo të drejtpërdrejtë kuptimore, sepse korbi është një shpend që ndjell zi ose në mentalitetin shqiptar është paralajmëruesi i së keqes. Kjo njësi frazeologjike bëhet për të identifikuar një të keqe të madhe, një kob.

i zi si qulli (Shkodër) – njësia frazeologjike përdoret në Shkodër dhe krahasimi duket se nuk është i drejtpërdrejtë, sepse qulli bëhet me kulaç dhe rrjedhimisht nuk ka ngjyrë të

zezë, prandaj lidhjen do ta kërkojmë gjetkë. Qulli është gatim tradicional në kohë të vështira ekonomike në mungesë të ushqimeve të tjera, prandaj ky krahasim lidhet me ditët e zeza të mjerimit ekonomik.

e zezë si nata – ky krahasim lidhet ngushtësisht me natën pa hënë e pa yje, me një natë shumë të errët dhe është një frazeologji që haset edhe në gjuhën angleze në trajtën *black night – white night*

e zezë si sorra – lidhet për nga kuptimi me ngjyrën e shpendit sorrë që është pjesërisht me ngjyrë të zezë dhe në tërësi është një shpend që jeton në vetmi, për të identifikuar një njeri që është shumë e vetmuar, prandaj konsiderohet e zezë.

i zi si blozë (si qymyr) - njësia frazeologjike është ndërtuar përmes ngjashmërisë së ngjyrës së zezë, bloza (dhe qymyri) ka ngjyrë të zezë

me zemër të zezë, shpirtzi - black heart njësia frazeologjike kuptimin e saj e përcjell përmes lidhjes me shpirtin e keq të një njeriu, koprracinë e tij

e bën të bardhën të zezë (gënjeshtar) – njeri që sajton të kundërtën e asaj që është në të vërtetë, ndërkohë që ndryshimet ose dallimet janë rrënjësore

është vetullzezë - (e bukur, simpatike) njësia frazeologjike lidhet me ngjyrën e vetullave të personazhit, duke i dalluar ato nga tiparet e tjera të fytyrës

është flokëzi – black hear (simpatik) tipari dallues i personazhit është ngjyra e flokëve, ka tregon se ka moshë të re

është lëkurëzi – black man (zezak) krahasimi bëhet duke patur si referencë ngjyrën e lëkurës, prejardhja

E që kur shkeli në fshat ky kapeziu e zhurmëmadhi Latin, pushuan gazet e nisën vreret.

Jo vetëm vreret, po edhe helmet e vdekjet. Se e kish të zi shpirtin ky pipingo. Më të zi se

këmisha që kish veshur. Desh të na marrë gjuhën e foshnjave , bukën e fëmijëve, nderë e kombit edhe besën e pleqve.(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 113)

*Maçoku nuk ish maçok i vërtetë, po djalë, me dy këmbë nga të fqinjërisë, si unë e ti (pastë hijen e tij!). I thosha Maçok, si gjithë fshati, se ish i lig **e kish një maçok të zi në shpirt**. Ja kaq të madh! Mbolla unë edhe të tjera degë, po as ato nuk i la Maçoku. Dhe pastaj hoqa dorë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 93)*

*I madhi i dreqit – shapatani vetë dora! –ish katallan **i zi si pisa**, me sy të kuq si kullumbria, me brirë të përdredhur, me buzë si dy petulla...Rrinte aty në shpellë rrethuar me maokë e me bufë - si dreq që ish – edhe ngrohej në tym.(Mitrush Kuteli,Tregime të zgjedhura, fq.222)*

*...U shikuan të dy sy në sy: Rrapua kokëthinjur,me mëngore të bardhë me ato mëngët si dy këmbana, të ngushta lart e sa vjen më të gjëra poshtë, në llërët, me çepkene shajaku, me fustane e tirq të bardhë, me opinga kau, ai tjetri **kokëzi si qymyr** gështenje, me rroba kadifeje nga ato të Frëngjisë, të ngushtë, me një lidhkë në qafë; ...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.138-139)*

është dyll i verdhë – krahasimi bëhet për një njeri që nuk është mirë me shëndet, është i sëmurë ose shëndetlig

është i verdhë si limon – krahasimi në këtë njësi frazeologjike mbiemërore bëhet mbi bazën e një fruti si limoni, që ka ngjyrë të verdhë dhe kërkon të identifikojë një njeri të sëmurë ose tëfrikësuar, të trembur

është i verdhë si meiti – to turn yellow (frikacak) njësia frazeologjike ka dy boshte kuptimore, i pari të sjell ndër mend fytyrën e pajetë të meitit (të vdekurit) me njëfjalë njeri

pa jetë ose i dobësuar së tepërmi prej sëmundje. Boshti i dytë kuptimor lidhet me fytyrën e dikujt që është frikësuar aq shumë sa po vdes prej frikës

është si verdhacuk (verdhacak) – yellow (lëkurëverdhë) krahasimi fsheh dy boshte kuptimore, së pari i referohet një njeriu me lëkurë të verdhë dhe së dyti identifikon një njeri që dridhet nga frika

është vajzë leshverdhë - girl with yellow hair kjo njësi frazeologjike veçon elementin dallues në identifikimin e vajzës, për treguar ngjyrën e flokëve të saj.

është si e verdha e vezës – yellow (e verdha e vezës) me anë të kësaj njësie frazeologjike mbiemërore sillet një kuptim i ri i vezës dhe të verdhës së saj për të treguar se njeriu për të cilin flasim është i shtrenjtë për bashkëfolësin dhe kuptimi tjetër identifikon bashkëfolësin si njeri të pasur, pasanik

ta jep vezën pa të verdhë (i shkathët) – njësia frazeologjike pasqyron një situatë që e zmadhon aftësinë e njeriut deri në hiperbolizim të veprimit (ndarjen e vezës) duke dashur ta veojë shkathtësinë si tipar të tij

është si vezë me dy të verdha (shumë i pasur) – duke qenë se veza me dy të kuqe është një rast tepër i rrallë edhe krahasimi me të, të një protagonistit është një fat dhe një vlerë që e kanë mundësinë ta kenë vetëm të pasurit

e verdhë si flori (ngjyrë floriri) – njësia frazeologjike ndërtohet mbi bazë të ngjashmërisë me ngjyrën e metalit të çmuar

...Po, po , i riu i mban mend të gjitha: ti ishe goxha djalë, sapo ishe shkruar zaptie turku, me manxer të ri, me rrypa kryq e tërthor, tërë sythe të ndritur, me setre të mbyllyr në grykë e plot kopsa të verdha si flori, me festen me xhufkë të vënë të vënë në kallëp, anuar

mbi sy. Apo jo? Fluturoje si zog me krahë. Të gjitha të kishin lezet... (Mitrush Kuteli, Tegime të zgjedhura , (bot. 1972. fq.274)

buzët e kuqe si burbuqe – në historinë e gjuhës ky krahasim është rrënjësor si pjesë e kulturës sonë duke i krahasuar buzët e vashës me burbuqen, sepse ajo ka ngjyrë të bukur të kuqe dhe është shumë e freskët, kjo kërkon të identifikojë moshën e re të vashës

e kuqe si lulëkuqe – edhe kjo trajtë krahasimore është realizuar dhe ka mbetur në kulturën tonë për të identifikuar një lloj ngjyre të kuqe që ngjan me lulëkuqen, lulen e bukur që del në verë në mes të arave me grurë

i kuq si gjaku – njësia frazeologjike me bazë krahasimin fsheh dy kuptime. I pari identifikon drejtpërsëdrejti ngjyrën e kuqe të gjakut dhe i dyti duket se fsheh një lidhje të tërthortë me trimërinë dhe heroizmin

të kuqe si mollë - njësia frazeologjike ka në bazë të krahasimit frutin e mollës që të sjell ndërmend frutin e ndaluar biblik, por njëkohësisht edhe një frut të shëndetshëm e të mbushur me aromë

i kuq si flamuri – kjo njësi frazeologjike lidhet ngushtësisht vetëm me mentalitetin dhe kulturën shqiptare sepse është i vetmi shtet që e ka ngjyrën e flamurit kombëtar të kuqe, në kuptimin e tij të figurshëm duket sikur është një krahasim që fsheh ndjesi të veçanta, pse jo edhe nacionaliste

është i kuq si prushi (e kuqe e zjarrtë) – në këtë njësi krahasimi nuk ka si element vetëm ngjyrën, por edhe nxehtësinë ose fazën e shpërbërjes së lëndës drusore dhe shndërrimit në hi’

është faqekuq – *redfaced* në këtë njësi që është një kompozitë shprehet me mbiemër elementi dallues është ngjyra e faqeve, që tregon një njeri me shëndet të plotë

- Nuk duam , aga, se na dhe rrush edhe ne do ta ruajmë ...

-Dum- dum- dum, bënë çape në udhë edhe pastaj djali më i madh – **i kuq si prushi** – me një shportë në dorë, kaloi shtegun. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 61)

...Ashtu më të gëzoftë zoti me një djalë. Nusja u skuq **si lulja e kuqe** edhe hyri brenda. Doli një nuse nga më të vjetrat që i dinte mirë punët e qeverinë e shtëpisë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 65)

Ore ti! Unë të kam vënë në sinor gardhin, që t'i vish rrotull ngadalë. Hap sytë mos ma gërryey kopshtin, se të ha xhuxhullima. More vesh? Thua se kur i tha këto fjalë Kozman Beu duhej të kish qenë i dehur? Jo: ish si ngahera – dua të them gjysmë kështu e gjysmë asht, me paguren në brez – po ashtu, ç'më e kish të folurit se, **ish** burrë me çallëm. Dhe i pashëm: i gjatë, **faqekuq** – gjer thellë në pleqëri. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq.196)

I madhi i dreqit – shapatani vetë dora! – **ish** katallan i zi si pisa, **me sy të kuq si kullumbria**, me brirë të përdredhur, me buzë si dy petulla...Rrinte aty në shpellë rrethuar me maçokë e me bufë - si dreq që ish – edhe ngrohej në tym.(Mitrush Kuteli ,Tregime të zgjedhura, fq.222)

U bë jeshil si bari në fytyrë (i trembur) – përdoret për të pasqyruar një ndjenjë frike të njeriut që është shumë i frikësuar deri në palcë

i/e kaltër si deti (si qielli) - është një njësi frazeologjike me bazë krahasimin dhe realizohet me ndihmën e lidhëzës si, sepse deti ka ngjyrë të kaltër dhe sytë pasqyrojnë iltërsinë ose thellësinë shpirtërore të individit,ashtu si deti shpalos thellësinë e tij në natyrë.

Në shembujt e mësipërm , kuptimi frazeologjik ndonjëherë lidhet me kuptimin fillestar edhe kur ky kuptim realizohet me shndërrimin e figurshëm të gjymtyrëve brenda njësisë

frazeologjike. Në njësitë frazeologjike e gjejmë kuptimin e figurshëm nisur nga kuptimi i drejtpërdrejtë.

Lidhja midis kuptimit të parë të fjalës me kuptimin e figurshëm janë ngulitur në gjuhë dhe në kulturë në kohë. Mjaft prej njësive frazeologjike mbështeten në metaforat konceptore të cilat ndikojnë në nivelin konceptor dhe jo në atë leksikor.

Ka njësi frazeologjike mbiemërore tek të cilat kuptimi i gjymtyrëve përbërëse të njësisë frazeologjike të analizuar në veçanti është i pavarur nga kuptimi i përgjithshëm i të gjithë njësisë. Kështu në shembujt e mësipërm emërtimet e ngjyrave përdoren për të pasqyruar këndvështrime në lidhje me situata të caktuara ekonomike e shoqërore ose për të cilësuar veprime dhe njerëz.

Në raste të caktuara për të kuptuar një shprehje frazeologjike mbiemërore ndërhyjnë mekanizma të tillë si metonimia dhe metafora të cilat kontribuojnë për të dhënë kuptimin e duhur gjithë njësisë. Përmes tyre mundësohet të kuptuarit e koncepteve abstrakte dhe i bën ato më të thjeshta, më konkrete.

Njësitë frazeologjike ndryshojnë sipas formave të përdorimit të tyre në ligjërim dhe mund të përdoren në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë ose në kuptimin e tyre të figurshëm.

*Psh: U guros agai nga dhembja, kur e sollën të birë nga lëmi, në tirë. U guros më fort kur i pa fytyrën **si qiri i bardhë**, që s'i ngjante asfare njeriut të gjallë – po tjetër bote.*

(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 53)

*Edhe sa për verë, gjer aty sa e ktheu prapë, se butet ishin në dera edhe plloskat në goja: me trendelinë, me borzilok – e lehtë a e rëndë – **si të ta desh e bardha zemër**. E sa për të ngrënë s'ka si bëhet më mirë...(Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 227-228)*

- Nuk duam , aga, se na dhe rrush edhe ne do ta ruajmë ...

-Dum- dum- dum, bënë çape në udhë edhe pastaj djali më i madh – **i kuq si prushi** – me një shportë në dorë, kaloi shtegun. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 61)

...Ashtu më të gëzoftë zoti me një djalë. Nusja u skuq **si lulja e kuqe** edhe hyri brenda. Doli një nuse nga më të vjetrat që i dinte mirë punët e qeverinë e shtëpisë. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 65)

Në shumë njësi frazeologjike mund të zëvendësojmë një gjymtyrë përbërëse ose të realizojmë zëvendësimin leksikor. Zakonisht këto zëvendësime bëhen të mundshme vetëm të imponuara nga natyra metaforike. Psh; *u skuq si prushi* dhe *u bë si lule e kuqe* ; etj

5.9. Rezultatet dhe diskutimi

Instrumentet e përdorura në këtë studim ndihmojnë në punën hulumtuese dhe në përgjigjen e pyetjeve të ngritura që në fillesa nga ana jonë. Lidhja mes instrumenteve dhe pyetjeve hulumtuese pasqyrohet në tabelë:

Nr.	Pyetjet kërkimore	Instrumentet e kërkimit
1	Sa dhe si pasqyrohen njësitë frazeologjike në tekstet e gjuhës shqipe?	Vëzhgime të dokumentacionit - teksteve shkollore / Analiza
2	Si përvetësohen ato nga nxënësit e klasave të 6-12-të?	Vëzhgime të dokumentacionit - fletoreve të nxënësve / Analiza
3	A përdorni njësi frazeologjike gjatë ligjërimit të përditshëm?	Anketime

Eksplorimi i pasqyrimi të njësive frazeologjike tregoi se niveli i përfaqësimit të tyre në tekstet gjuhë shqipe nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të është i ulët, ndërsa në tekstet e gjuhë shqipe të klasave 10-të e deri në klasën e 12-të nuk pasqyrohen njohuritë për to.

Nga vëzhgimi i dokumentacionit (Planet mësimore, tekstet shkollore dhe fletoret e punëve me shkrim) dhe anketimet e bëra janë dy gjetjet që lidhen me hipotezat e këtij studimi;

a-niveli i pasqyrimin të njësive frazeologjike në tekstet e gjuhës shqipe është në nivel të ulët

b-niveli i përvetësimit të njësive frazeologjike nga nxënësit është në nivel të ulët

Edhe rezultatet nga zbatimi i pyetësorëve dhe vëzhgimeve sollën përfundimet se

Hipoteza 1 u vërtetua dhe Hipoteza 2 u vërtetua. Këto rezultate nuk përgjithësohen për të gjitha shkollat, por vetëm për shkollat e Rrogozhinës.

PËRFUNDIME

Duke e konsideruar njësinë frazeologjike po kaq të rëndësishme sa edhe fjala kemi marrë në konsideratë konceptin e frazeologjisë në pikëpamjet e disa gjuhëtarëve të ndryshëm, si dhe njësinë frazeologjike në këndvështrime të ndryshme historike. Kemi pasqyruar pikëpamjet e ndryshme rreth konceptimit të disa gjuhëtarëve për frazeologjinë në konceptin e ngushtë dhe të gjerë të saj, emërtimet dhe termat përkatës (idiomë, togfjalësh i qëndrueshëm, shprehje, shprehje idiomatike, frazemë, frazë, frazë e qëndrueshme, kombinim fjalësh, frazeologjizëm, lokucion etj). Mbështetur në këto qëndrime realizuam një paraqitje të studimeve të bëra rreth frazeologjisë për gjuhë të ndryshme edhe lidhjeve të frazeologjisë me fusha të tjera ku gjejnë përdorim njësitë frazeologjike ose anasjelltas. Këtu u përqëndruam në studime të larmishme për gjuhësinë shqiptare që nga studimet më të largëta në kohë e deri tek këto të viteve të fundit.

Në vëmendjen tonë dallimet mes frazeologjisë gjuhësore dhe frazeologjisë leksikore janë shoqëruar me shembuj. Po kështu renditim pranë kriteteret që studiues të ndryshëm i sjellin në studimet e tyre si; kriterin e moskompozicionalitetit, kriterin i figurshmërisë dhe kriterin e barasvlershmërisë me fjalën. Trajtesa terminologjike të përdorura nga gjuhëtarë të ndryshëm përfshirë këtu edhe frazemën dhe qëndrimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për të. Kemi marrë në konsideratë edhe qëndrime rreth teorisë konjitiviste dhe asaj tradicionale dhe pikëpamje të ndryshme për fjalët e urta, citatet, njësitë frazeologjike etj. Gjithashtu kemi renditur dallimet mes njësive frazeologjike dhe proverbave dhe rolin e tyre për të pasuruar leksikun. Kemi trajtuar lidhjet mes figurshmërisë dhe idiomatikës. Shumë herë mbështetemi në klasifikimin e njësive frazeologjike për të arritur te thelbi i punimit tonë që

janë njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore, të cilat në vlerën e tyre leksikore janë mbiemra.

Duke qenë se njësitë frazeologjike kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve ato edhe pasqyrohen gjerësisht në fjalorët njëgjuesh dhe dygjuesh. Pikërisht shembuj shprehjesh sillen nga fjalorët, por edhe letërsia e shkruar shpeshherë shembuj për të kategorizuar llojet e togfjalëshave. Si të gjitha shprehjet frazeologjike, mjaft prej tyre e kanë pikënisjen nga togfjalëshi i lirë, por në dallim nga togfjalëshat e lirë, ku kuptimi është i drejtpërdrejtë, në togfjalëshat frazeologjikë kuptimi është i figurshëm. Në themel të këtij kalimi, pra nga togfjalësh i lirë në frazeologjik, qëndrojnë disa trope si metafora, krahasimi, hiperbola, eufemizmi, personifikimi, etj. Njësitë frazeologjike shqyrtohen edhe nga funksionimi i tyre si një njësi e vetme sintaksore, tipar ky që i bashkon me fjalën.

Studimi i tipareve të njësisë frazeologjike me vlerë mbiemërore pasqyron dallimet dhe ngjashmëritë me fjalët. Njësitë frazeologjike ashtu si fjalët përdoren si njësi të gatshme në ligjërim dhe shfaqin funksionin e tyre shënues. Tipari kryesor që e dallon njësinë frazeologjike me vlerë mbiemërore nga fjala është struktura dhe semantika e saj e veçantë, ndërsa togfjalëshi i lirë duhet patjetër të jetë i përbërë të paktën nga dy fjalë emërtuese, që të bëhet (frazeologjike) ose togfjalësh i qëndrueshëm. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore dhe togjet e lira kanë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre, ashtu si togjet e lira të fjalëve kanë lidhje të njëjta ose përbëhen nga dy a me shumë fjalë shënuese. Njësitë frazeologjike mbiemërore i klasifikuam sipas motivimit grupohen në njësi frazeologjike të motivueshme dhe të pa motivueshme. Në rastet kur njësia frazeologjike (togfjalëshi frazeologjik) krahas përdorimit të saj të figurshëm ka (ekziston) edhe togfjalëshin e lirë (kuptimin e parmë) atëherë themi se kemi të bëjmë me njësi frazeologjike

të motivueshme. Në përbërjen e strukturës së njësive frazeologjike mbiemërore janë të pranishëm mbiemrat e nyjshëm dhe ato të panyjshëm, të cilët pasqyrojnë gjendje emocionale të ndryshme të cilat pasqyrohen edhe në gjuhë.

Njësia frazeologjike me vlerë mbiemërore ka përgjithësisht kuptimin e mbiemrit predikativ dhe si e tillë gjymtyrët e saj mund të shkrijnë kuptimet e tyre dhe të jenë të njëvlershme për nga funksioni me fjalën. Gjithashtu u mbështetëm te idiomatika si tipar themelor i formësimit dhe te figurshmëria (tropet). Në njësitë frazeologjike veçuan edhe klasifikimin sipas vlerës leksikore dhe formave të lidhjes së gjymtyrëve të njësive frazeologjike. Njësitë frazeologjike i grupojmë edhe sipas strukturës së ndërtimit të tyre, nëse ato funksionojnë si folje janë foljore, nëse përdorimi i tyre luan funksionin e emrit janë emërore dhe nëse ato funksionojnë si ndajfolje janë ndajfoljore, nëse janë njësi me kuptime mbiemërore janë mbiemërore. Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë të ndërtuara sipas disa formave të lidhjes së gjymtyrëve, kemi sjellë shembuj edhe nga gjuha shqipe edhe nga gjuha angleze herë pas here.

Duke respektuar strukturën e ndërtimit të njësive frazeologjike të shqipes kemi dalluar disa organizime të njësive frazeologjike. Shumica e njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore kanë strukturë togfjalëshi, por disa prej tyre janë me strukturë fjalie. Gjithashtu njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore vijnë edhe prej tipit foljor dhe në vend të gjymtyrës foljore kanë një mbiemër prejppjesor, ose përbëhen nga dy gjymtyrë të shprehur me emra. Këto i kemi përpjekur të argumentuara me shembuj. Në përdorimin e tyre më të zakonshëm njësitë frazeologjike mbiemërore janë të organizuara me parafjalët; pa, me, si. Jo rrallë njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore janë dy folje, dy emra ose emër dhe mbiemër etj.

Disa veçori të formës në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore pasqyrohen në këtë studim edhe nga pikëpamja e formës. Në shumë gjymtyrë të gjuhës shqipe janë fjalët e përdorimit më të shpeshtë, prandaj edhe formimi i njësive frazeologjike lidhet me përdorimin e fjalëve të veçanta, me veçoritë emocionale dhe me veçoritë kuptimore. Në gjuhën shqipe ndeshen edhe njësitë frazeologjike që formohen nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi dhe shtjellohen edhe si njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore. Ndonjëherë njësitë frazeologjike varen edhe nga ndërfutja e elementeve në brendësi të një njësie frazeologjike mbiemërore që lejon edhe modifikimin nga ana semantike. Jo gjithmonë në njësitë frazeologjike mbiemërore është e pranishme gjymtyra e mbiemrit. Njësia frazeologjike me vlerë mbiemërore ka përgjithësisht kuptimin e mbiemrit predikativ dhe si e tillë gjymtyrët e saj mund të shkrijnë kuptimet e tyre dhe të jenë të njëvlershme për nga funksioni me fjalën.

Mbiemrat gjejnë përdorim gjerësisht në njësitë frazeologjike mbiemërore në zona të ndryshme dhe në grupe a bashkësi të ndryshme, në disa fusha leksiko-semantike dhe pasqyrime të elementeve të etnokulturorë në njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore. Në shembujt e punimit pasqyrohen shfrytëzimin me mjeshtëri të pasurisë leksiko – semantike përmes fjalëve të reja ose të vjetra, sinonimeve, antonimeve, krahinorizmave etj. Paraqesim pikëpamjet e veçanta të pjesëtarëve të një grupi të cilat janë pasqyruar në kulturë dhe sigurisht edhe në gjuhë (këtu sjellim edhe shembuj nga qyteti i Rrogozhinës). Duke u bazuar në përjasje dhe etnologjinë dhe përdorimit të frazeologjisë në varësi të grupeve shoqërore (të grave, të burrave), vumë re se këto shprehje mund të përdoren në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë ose në kuptimin e tyre të figurshëm, duke identifikuar, delikatesën dhe brishtësinë femërore edhe në ndërtimet e njësive frazeologjike. Në mendësinë popullore

ka gjithnjë fjalë dhe shprehje që përdoren vetëm nga burrat, adresuar atyre ose vetëm në ambiente të caktuara për ta, duke bërë të mundur që një pjesë e shprehjeve të përdoren vetëm nga meshkujt, kjo nuk është vetëm pjesë e vlerësimit, por edhe konceptimit të disa punëve që i bëjnë vetëm burrat (si lufta, pija dhe punët e rënda të bujqësisë).

Ligjërimi ynë ka një formë të caktuar dhe një përmbajtje të caktuar, në varësi të mendimeve që duam të përcjellim, në varësi të gjendjes emotive që duam të shfaqim apo në varësi të kontekstit që përshfaq njësia frazeologjike. Në më të shumtat e rasteve njësitë frazeologjike janë ndërtuar në funksion të rrethanave të ligjërimeve, familjare ose jashtëfamiljare, profesionale ose jashtëprofesionale. Disa njësi të tjera frazeologjike janë shkëputur nga arti i kuzhinës dhe shembuj të tjerë janë nxjerrë nga disa fusha ku merren si modele në ngjyrat, për të plotësuar dendurinë e përdorimit të njësive frazeologjike me vlerë mbiemërore. Po kështu kemi paraqitur disa njësi frazeologjike nga bota bimërore të mbledhura në zonat përreth qytetit ose njësi frazeologjike nga bota shtazore.

Njësia frazeologjike me vlerë mbiemërore përdoret duke marrë si elemente bazë të ndërtimit të tyre, emërtimet e ngjyrave. Ato përdoren për të pasqyruar këndvështrimet dhe mendimet në lidhje me situata të caktuara ekonomike e shoqërore ose për të cilësuar veprime dhe njerëz. Duke pasqyruar edhe disa modele ushtrimesh rreth frazeologjizmave kemi nxjerrë në pah aspekte të rëndësishme të njësive frazeologjike sidomos në orët mësimore në ciklin 9-vjeçar. Në to analizuam aspekte të metodologjisë si edhe do të reflektuam pasqyrimin e frazeologjisë në tekstet mësimore të ciklit parauniversitar. Përmes të dhënave renditëm se sa njohuri marrin nxënësit rreth njësive frazeologjike dhe fushave leksikore të veçanta të pasqyruara në tekstet mësimore Gjuhë shqipe. Përmes anketimeve dhe vëzhgimeve sugjeruam si të nevojshme pasqyrimin në tekstet mësimore

Gjuhë shqipe dhe letërsi të shkollës së mesme, të njohurive rreth frazeologjizmave të cilat mungojnë. Në këtë punim kam pasqyruar edhe disa njësi frazeologjike të përdorura si formula të urimeve dhe mallkimeve të mbledhura në zonat përreth qytetit. Po kështu disa gjetje janë sjellë edhe nga përdorime të zhargonit studentor, i cili është mjaft i pasur me njësi frazeologjike. Përgjatë anketave kam zgjedhur shprehje të ndryshme, që secila grup moshë përdor në komunikim me moshatarët e vet. Në këto përfundime të përgjithshme jemi përpjekur të sjellim vetëm një aspekt metodik që ka lidhje edhe me politikat arsimore në ciklin parauniversitar.

Rekomandime

Njësia frazeologjike gjykohet si barasvlerëse e fjalës dhe mbush boshllëqet e leksikut, ose jep vlera të tjera sup-segmentale, ka në një farë mënyre përligj edhe ekzistencën e tyre në gjuhë. Pasqyrimi i njësive frazeologjike në tekstet e gjuhës shqipe të jetë në nivele më të larta sidomos për t'u përcjellë brezave të rinj larminë dhe pasurinë leksikore të shqipes.

Mendoj se është e rëndësishme, që njohuritë për njësitë frazeologjike të pasqyrohen edhe në tekstet e shkollës së mesme, meqenëse ato janë element i domosdoshëm në pasurimin e gjuhës dhe kulturës së një populli.

Duke qenë se njësitë frazeologjike kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve ato edhe pasqyrohen gjerësisht në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh, pra janë me mjaft interes edhe për mësuesit e gjuhëve të huaja. Përpos këtyre njësive frazeologjike nga prejardhja dhe nga vlerat ligjërimore, përbëjnë një dukuri interesante, që lidhet me formën e brendshme të gjuhës, psikologjinë e një kombi a etniteti kombëtar me ngjyime ligjërimore. Këto dukuri të përqasura me gjuhë të tjera nxjerrin në pah veçantitë gjuhësore, mendësore dhe historike të një kombi dhe gjuhe.

BIBLIOGRAFIA

FJALORË:

Cowie, A.P./Mackin, R. (1975): *Oxford dictionary of current idiomatic English*. Oxford: Oxford University Press.

Jashari, Ali (2007): *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*”, Tiranë: Botimet “Dudaj”.

Qesku, P. (2002)*Fjalor Anglisht – Shqip*, Botime EDFA, Albania , Tiranë

Seidl, J./McMordie, W. (1978): *English idioms and how to use them*. Oxford: Oxford University Press.

Stefanllari, I. (1998): *Fjalor frazeologjik anglisht-shqip*. Tiranë: Botimet enciklopedike.

Stefanllari, I. /DHERI, V.(1975): *Fjalor idiomatik frazeologjik anglisht-shqip*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaja. Tiranë.

Thomai, J.(1999). *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë: Shtëpia botuese “Shkenca”.

7-th edition Oxford, Advanced Learner’s Dictionary (2005)

BURIME PARËSORE:

Abeille’, A.(1995): “*The flexibility of French idioms: A representation with lexicalized tree adjoining grammar*”, në M. Everaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “*Idioms: Structural and Psychological Perspectives*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 15-43. 226

Ballamaçi, J.(1994): “*Shprehje popullore nga rrethi i Korçës*”. Në: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë: Studime Filologjike. 1-4. Tiranë, 188-203.

Bally, Ch. (1909): *Traité de stylistique française*, Paris, Klincksieck

Ba'rdosi, V., «*Entre fild'Ariane et tonneau des Danaïdes. Problèmes de classification des phrasèmes français* », in : *Revue d'Études Françaises*, no 4, (1999)

Ba'rdosi, V., [www.tintakiado.hu/bardosivilmos/Entre fil d'Ariane et tonneau des Danaïdes, Problèmes de classification des phrasèmes français](http://www.tintakiado.hu/bardosivilmos/Entre_fil_d'Ariane_et_tonneau_des_Danaïdes_Problèmes_de_classification_des_phrasèmes_français).

Bilkova, I.(2000): *Czech and English Idioms of Body Parts*, Disertacion, www.bohemica.com

Botelho Da Silva, T. dhe Cutler, A. (1993): “*Ill-formedness and Transformability in Portuguese Idioms*”, në C. Cacciari & P. Tabossi, “*Idioms: Processing, structure and interpretation*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 129-144.

Cacciari, C.(1993): “*The place of idioms in a literal and metaphorical world*”, në C. Cacciari & P. Tabossi, “*Idioms: Processing, structure and interpretation*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 27-55.

Cacciari, C./Glucksberg, Sam (1995): “*Imagining idiomatic expressions: Literal or figurative meanings ?*”, në M. Evereaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “*Idioms: Structural and Psychological Perspectives*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 43-57.

Cacciari, C. /Tabossi, P.(1991): “*Idioms: Processing, Structure and Interpretation*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum

Catherine B. *Flou phraséologique, quasi-grammaticalisation et pseudo marqueurs de discours : un no man's land entre syntaxe et discours?*

http://www.uclouvain.be/cps/ucl/doc/valibel/documents/Bolly_LINX62_SyntaxeDiscours_PrePrintok.pdf, .

Çeta, A. “Disa frazeologji të Drenicës si rezultante të anekdotave popullore” 119-136.

Çeliku, M. (1962): “Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në gjuhën shqipe” 1962

Davidi, P.(1983): “Frazeologji dhe shprehje nga goja e popullit” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Gjuha jonë, 2, 1983.

Dedi, V.(1973): “Material leksikor nga krahinat” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 4, 1973, 187-195. 227

Demiraj, Sh.(1986): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Universiteti shtetëror i Tiranës/Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë: Shtëpia botuese «8 Nëntori».

Dibra, G./ Taipi, M./ Halluni, E. (2013): *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, Botime “Vllamasi”

Duro, A.(1982): “Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme” tek: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 4, 1982, 109-121.

Duro, A. 2009): *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*. Tiranë: Shtëpia botuese «Fan Noli».

Dhrimo, S.(2008): *Probleme të përkthimit të njësive frazeologjike nga gjermanishtja dhe anglishtja në gjuhën shqipe*. Punim për marrjen e gradës “Master”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Gibbs, R. W. (1995): “Idiomaticity and human cognition”, në M. Everaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “Idioms: Structural and Psychological Perspectives”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 97-116.

- Gibbs, R.W. Jr. (1993): “*Why idioms are not dead metaphors*”, në C. Cacciari & P. Tabossi, “*Idioms: Processing, structure and interpretation*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 57-78. 228
- Ginzburg, R.S./ Khiedel, S.S./Knyazeva, Sankin, A.A. (1999): *English Lexicology*, Moskë.
- Gjevori, M. (1968): *Frazeologji shqipe*. Prishtinë: Shtëpia botuese “Rilindja”.
- Gjinari, J. (1976): “*Struktura dialektore e shqipes në lidhje me historinë e popullit*” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 2, 1976, 131-147.
- Gjocaj, Z. (1998 a): “*Çështje të homonimisë e sinonimisë frazeologjike në gjuhën shqipe*” në: Instituti Albanologjik i Prishtinës: Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave filologjike. 27-1997. Prishtinë 1998. 115-130.
- Gjocaj, Z. (1998 b): “*Prirjet e zhvillimit të frazeologjisë shqipe*” në: Instituti Albanologjik i Prishtinës: Gjuha Shqipe 2. 1998, 32-34.
- Gjocaj, Z.(2005): “*Veçoritë e frazeologjisë poetike të Lasgush Poradecit*” në: Instituti Albanologjik i Prishtinës: Gjuha Shqipe 1, 2005. Viti XXIII Prishtinë, 45-54.
- Gjocaj, Z. (2006): “*Roli leksiko-frazeologjik në pasurimin e kulturës gjuhësore*” në: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. 25/1, Prishtinë 2006, 357-363.
- Gjokutaj, M. (2012): *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, Shblu
- Gramatika e gjuhës shqipe*, I, (1995). Akademia e shkencave e Shqipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave.

Gramatika e gjuhës shqipe, II, (2002). Akademia e shkencave e Shqipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave.

Jashari, A. (1975): “*Material frazeologjik nga krahina e Devollit*” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 4, 1975, 131-137.

Jashari, A. (2007): *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*. Tiranë: Botimet “Dudaj”.

Liu, D. (2008): *Idioms: Description, comprehension, Acquisition, and Pedagogy*. New York and London: Routledge, Taylor & Francis Group.

Lyons, John (2001): *Hyrje në gjuhësinë teorike*. Tiranë: Shtëpia botuese “Dituria”.

Makkai, A. (1993): “*Idiomaticity as a reaction to L'Arbitraire du Signe in the universal process of semeio-genesis*”, në C. Cacciari & P. Tabossi, “Idioms: Processing, structure and interpretation”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 297-323.

Mel’čuk, Igor A. (1995): “*Phrasemes in language and phraseology in linguistics*”, në M. Everaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “Idioms: Structural and Psychological Perspectives”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 167-232

Mel’čuk, Igor. Clas André dhe Polguère Alain,(1995): *Introduction à la lexicologie explicative et combinatoire*, Ed. Duculot.

Memisha, V.(2006): “*Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike.*” në: Studime Filologjike. Nr. 3-4, 113-131.

Miçoni, H. (2013) ; “*Rreth frazeologjisë së shqipes krahasuar me greqishten*” Punim për marrjen e gradës “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

- Moon, R.(1998): *Fixed expressions and idioms in English*, Oxford: Clarendon Press Oxford.
- Musai, B.(2008): *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë
- Musai, B.(2003): *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë, Shtypyr në Albgraf
- Nicolas, T.(1995): “*Semantics of idiom modification*”, në M. Everaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “*Idioms: Structural and Psychological Perspectives*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 233-252.
- Nushi, J.(1970): “*Material leksikor nga krahinat*” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 3, 1970, 179-193.
- Rrokaj, Sh.(2000): *Hyrje në Gjuhësinë e përgjithshme*. Tiranë: SHBLU. 230
- Shkurtaj, Gj.(2009): *Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*. Tiranë: Shtëpia botuese «Morava».
- Shkurtaj, Gj.(1996): “*Sociolinguistika*”, SHBLU . Tiranë
- Skandera, P. (2007): *Phraseology and Culture*. Berlin/New York: Walter de Gruyter GmbH & Co.
- Spahiu, A,. “*Vrojtime leksikologjike, Frazologjizmat në FGJSSH të vitit 1980*”
- Stefanllari, I. (2011) *A course in english lexicology*, Geer, 2011.
- Szymanski, M. (2007): “*Përthimi i frazeologjizmave nga shqipja në polonishten*” në: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. 26/1, Prishtinë 2007, 111-115.
- Tabossi, P. /ZARDON, Francesco (1993): “*The activation of idiomatic meaning in spoken language comprehension*”, në C. Cacciari & P. Tabossi, “*Idioms: Processing, structure and interpretation*”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 145-162.

- Tabossi, P./ZARDON, Francesco (1995): “*The activation of idiomatic meaning*”, në M. Everaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, “Idioms: Structural and Psychological Perspectives”, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 273-282.
- Tase, P./ TATI, Vlash/BAJO, Luan (1972): “*Material leksikor nga krahinat*” në: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike, 1, 1972, 177-183.
- Toska,T. (2012): “*Përfaqësimi i përvojës së shqipfolësve në gjuhë,te njësitë frazeologjike*”
